


Majlinda Ziu

LIBËR PËR MËSUESIN GJEOGRAFIA

6



Majlinda Ziu

LIBËR PËR MËSUESIN GJEOGRAFIA

6



BOTIME

pegi

Dr. Majlinda Ziu

Libër për mësuesin

GJEOGRAFIA 6

BOTIME



Prishtinë, 2019

BOTIME



Drejtoi botimin: Valmira MUSHI
Recensentë të MASHT-së: Msc. Sami RESTELICA
Dr. Tomor QELA, Msc. Atdhe KRASNIQI, Fikrie ROBAJ
Redaktor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elivis BEJTJA
Kopertina: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-04-1

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, shtator 2019

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohej çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Mësues të dashur!

Ky libër mësuesi, ju vjen në ndihmë në punën tuaj të përditshme, me anë të planifikimeve dhe udhëzimeve që ofron. Udhëzimet e tij bazohen në programin mësimor të miratuar nga MASHT. Libri i mësuesit, ashtu si edhe vetë teksti mësimor dhe fletorja e punës së nxënësit janë hartuar në frymën e të nxënës me kompetenca. Ju do t'ju orientoni nxënësit tuaj drejt krijimit të kompetencave, drejt punës kërkimore, gjetjes dhe zgjidhjes së situatave problemore.

Përveç udhëzimeve që të ofron dhe të detyron programi mësimor, në këtë libër sugjerohen planifikimet vjetore, 2-mujore, 3-mujore dhe ditore. Ju mund t'ju përmbaheni atyre planifikimeve, por jeni të lirë të bëni planifikimet tuaja, në përputhje me kërkesat dhe nivelin e nxënësve tuaj.

Mirëpresim çdo këshillë dhe mendim nga ju.

Ju urojmë punë të mbarë!

Autorët

Kujtesë!

1. **Rubrika** e cila jep udhëzime të shkurtra ose ngre çështje për diskutim, është vendosur për të përfshirë nxënësit në mënyrë interaktive gjatë procesit mësimor. Ju mund të shtoni edhe të tjera, sipas specifikave të klasës/nxënësve.
2. **Lidhur me orët e përsëritjeve:**
 - a) Përsëritjet janë modele të ofruara për të thjeshtuar punën e mësuesit/es. Ata janë të lirë të zgjedhin/mendojnë si më të përshtatshëm, pyetje ose ushtrime të tjera, përveç tyre.
 - b) Mësuesi/ja është i/e lirë të realizojnë përsëritjen sipas nevojave. Ai/Ajo mund ta zhvendosë atë në varësi të kërkesave dhe të nivelit të nxënësve.
3. **Lidhur me testimet:**
 - a) Ndërtimi i testit duhet të masë shkallën në të cilën janë arritur nga nxënësit: njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre. Sugjerohet që në ndërtimin e testit, mësuesit të mbështeten kryesisht në rubrikat dhe në tipat ushtrimeve që ofrojnë përsëritjet model (por kujtojmë se nuk janë të detyruar ta bëjnë).
4. **Në orën e përsëritjes dhe të testimit**, në lidhje me trajtimin e një çështjeje/koncepti, nxënësi/ja duhet të vlerësohet me anë të situatave që sjell/përdor, të ngjashme me ato të trajtuara gjatë temave mësimore. Nxënësi duhet të vlerësohet për shkallën e perceptimit dhe lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme. Në përgjigjet e tij, nxënësi/ja mund të përdorë burime të ndryshme. Kontrolli mbi të kuptuarit e koncepteve duhet të mbështetet në kontrollin e mundësisë së nxënësit/es për t'i shpjeguar ato me fjalët e tij/saj, por sidomos në aftësinë për t'i zbatuar ato. Pra i gjithë kontrolli i njohurive duhet të mbështetet mbi zhvillimin e shprehive të analizës, të mendimit kritik dhe krijues të nxënësit.



I. Çfarë duhet të kemi parasysh për realizimin e kompetencave në lëndën e Gjeografisë?

I.1. Qëllimet e fushës: Shoqëria dhe mjedisi

Lënda e Gjeografisë 6 bën pjesë në shkallën e tretë kurrikulare dhe përfshihet në fushën: *Shoqëria dhe mjedisi*. Kjo fushë, në shkallën e tretë kurrikulare, ka për qëllim zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve, për të qenë qytetar i përgjegjshëm, për të zhvilluar identitetin personal dhe për të njohur më mirë atë kolektiv (social, kombëtar, shtetëror, etnik, fetar, racor, gjinor, kulturor, regjional). Kjo fushë ndihmon zhvillimin e aftësive për të gjykuar drejt dhe për të marrë vendime të përgjegjshme në jetën e përditshme, kultivimin e shprehive dhe marrjen e nismave për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Fusha *Shoqëria dhe mjedisi* në këtë nivel ndihmon nxënësit për të zhvilluar e për të përforcuar më tej njohuritë e tyre duke siguruar një bazë fillestare për orientim akademik dhe orientim në karrierë (shih skemën në figurën 1).

Programi i gjeografisë për shkallën e 3-të synon që nxënësi/ja:

- Të zhvillojë kuriozitetin për vendet, njerëzit, kulturat dhe mjediset në botë.
- Të zhvillojë dijet për dukuritë dhe proceset fiziko-gjeografike mbi bazën e një përgatitjeje të përshkallëzuar dhe ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues.
- Të zhvillojë kuptimin, interesin dhe respektin për vendin ku jeton, vendet e tjera, njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë.
- Të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik.
- Të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.
- Të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit.

Korniza konceptuale e fushës: Shoqëria dhe mjedisi




Figura 1

I.2 Konceptet e përgjithshme të fushës *Shoqëria dhe mjedisi*

1. *Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore*

Ky koncept përfshin njohuritë për rolin e individit si dhe për strukturat dhe marrëdhëniet e grupeve shoqërore. Gjithashtu përfshin edhe zhvillimin e aftësive dhe shprehive të nxënësit për rol aktiv në ndërtimin e raporteve të qëndrueshme shoqërore, si në familje, në grup shoqëror, ashtu edhe në bashkësi dhe në shoqëri në përgjithësi.

2. *Proceset shoqërore dhe natyrore*

Ky koncept përfshin njohuritë për proceset, fenomenet e dukuritë shoqërore e natyrore, zhvillimet dhe ndryshimet në të kaluarën dhe në të tashmen në vend, në rajon dhe në botë. Koncepti përfshin edhe njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet lidhur me ecuritë e popullsisë, vendbanimeve, migrameve, proceset socio-ekonomike, si dhe diversitetit kulturor dhe natyror, komunikimit kulturor, teknologjisë dhe çështjeve të globalizmit.

3. *Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë*

Në kuadër të kësaj tërësie përfshihen njohuritë për normat dhe rregullat shoqërore në mjedisin jetësor si dhe bashkëveprimet njeri mjedis. Gjithashtu ky koncept, në këtë nivel, përfshinë edhe njohuritë për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e tyre, përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj familjes, ndaj shkollës, ndaj rrethit ku jeton dhe më gjerë. Kjo nënkupton edhe vetëdijësimin për barazinë gjinore, tolerancën, mirëkuptimin, solidaritetin, reagimin ndaj dukurive negative (diskriminimi, paragjykim, etj.) nevojën për bashkëpunim dhe komunikim me të tjerët.

4. *Vendimmarrja dhe institucionet*

Ky koncept, në këtë nivel, përfshin njohuritë: për kompleksitetin e vendimmarrjes personale, në grup, si dhe të asaj institucionale; kultivimin e vetëbesimit, përgjegjshmërisë dhe të qëndrimit kritik në vendimmarrje, si dhe në rastet e caktuara duke u mbështetur në informacionin e duhur, në ide e argumente të qëndrueshme. Në këtë kuadër hyjnë dhe njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet për rëndësinë e vendimmarrjes së drejtë e të argumentuar, të dobishme për individin dhe për mjedisin shoqëror e natyror, duke mundësuar kultivimin e bashkëveprimit për proceset shoqërore dhe mjedisore.

5. *Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm*

Kjo tërësi përfshin njohuritë më të thelluara për raportin e njeriut dhe mjedisit jetësor, lidhjet dhe ndikimet e tyre reciproke, faktorët që ndikojnë në dëmtimin e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij. Gjithashtu, përfshin edhe njohjen dhe vetëdijësimin lidhur me gjeosferat, resurset, ekosistemet, biodiversitetin, nevojën e ruajtjes së mjedisit, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm (sociale, ekonomike dhe mjedisore). Ky koncept përfshin edhe njohuritë mbi hapësirën (Tokën dhe Sistemin Diellor), dukuritë dhe proceset natyrore dhe socio-gjeografike, të regjioneve, si dhe njohuritë për monumentet e trashëgimisë natyrore e kulturore dhe kujdesin për to.

I.3 Rezultatet e të nxënit të fushës

Shoqëria dhe mjedisi Shkalla 3	
I.	Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë përmes të cilave nxënësi/ja:
1.	<p>Njeh strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes apo të përfshirjes në to.</p> <p>1.1. Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.</p> <p>1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.</p>
2.	<p>Hulumton objektet, dukuritë, proceset historike, shoqërore, natyrore e mjedisore si dhe lidhjet dhe ndikimet ndërmjet tyre.</p> <p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>
3.	<p>Kupton dhe mëson të zbatojë normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet.</p> <p>3.1. Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p> <p>3.2. Kupton dhe vlerëson shumëllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p>
4.	<p>Përfshihet në dhënien e ideve, propozimeve dhe merr vendime në mënyrë vetëdijshme dhe të përgjegjshme.</p> <p>4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, në grupe institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme.</p> <p>4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p>
5.	<p>Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</p> <p>5.1. Inicion aktivitete konkrete në grup me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.</p> <p>5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</p>
6.	<p>Shfrytëzon në mënyrë efektive Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) dhe teknologjitë tjera bashkëkohore.</p> <p>6.1. Përzgjedh dhe përdor lloje të ndryshme të burimeve digjitale që kanë të bëjnë me raportet shoqërore dhe dukuritë natyrore e mjedisore.</p> <p>6.2. Përdor teknologjinë adekuate për moshën për të prezantuar idetë e tij para të tjerëve.</p>
II.	Qëndrimet dhe vlerat e strukturuar nga arsimimi përmes fushës: Shoqëria dhe mjedisi
	<p>II.1 Respekti për të tjerët</p> <p>II.2 Vetërespekti</p> <p>II.3 Bashkëndjenja - empatia</p> <p>II.4 Barazia</p> <p>II.5 Toleranca</p> <p>II.6 Gjykimi i drejtë</p> <p>II.7 Bashkëpunimi</p> <p>II.8 Mirëkuptimi</p>

Shoqëria dhe mjedisi Shkalla 3	
I.	Njohuritë, të kuptuarit dhe shkathtësitë përmes të cilave nxënësi/ja:
III.	Aftësitë dhe shkathtësitë e ftuara nga fusha: Shoqëria dhe mjedisi
	III.1 Përdorimi i informacioneve III.2 Hulumtimi i thjeshtë III.3 Shfrytëzimi i burimeve të thjeshta III.4 Përdorimi i skicës, planit, hartës, globit dhe busullës III.5 Grumbullimi dhe dokumentimi informacioneve III.6 Zbatimi i fjalorit të mësuar III.7 Ndërtimi dhe leximi i grafikëve, diagrameve, tabelave dhe hartave III.8 Përcaktimi i vendndodhjes në hapësirë, harta, atlase dhe glob i vendeve dhe rajoneve III.9 Formulimi i pyetësorëve të thjeshtë për të marrë informacion III.10 Evidentimi i ngjashmërive dhe ndryshimeve III.11 Realizimi i matjeve të elementeve klimatike dhe elementeve në harta III.12 Analiza e të dhënave numerike, tekstuale dhe grafike

I.4 Rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore

Kompetencat kryesore të të nxënit, përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të njohurive shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat i dëshmojnë se nxënësit janë aftësuar të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura.

Kompetencat burojnë nga qëllimi i përgjithshëm i arsimit parauniversitar, të cilat janë rezultat i të nxënit të njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme përgjatë niveleve të caktuara të sistemit arsimor. Ato duhet të dëshmojnë se për çka janë të aftë nxënësit pas një periudhe të caktuar të të nxënit.

Këto kompetenca janë: 1. Kompetenca komunikimi dhe të shprehurit. 2. Kompetenca të menduarit 3. Kompetenca të mësuarit për të nxënë. 4. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis. 5. Kompetenca personale. 6. Kompetenca qytetare. Ato reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit të detyrueshëm. Kompetencat *komunikimi dhe të shprehurit, kompetenca të menduarit dhe kompetencat për të mësuar* janë të natyrës instrumentale: ato janë bazë për kompetencat e tjera, të cilat më tepër janë të lidhura me rrethanat dhe me përmbajtjen e caktuar, siç janë kompetencat e nevojshme në jetën private, publike dhe profesionale.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit (Komunikues efektiv)

Me qëllim që nxënësit dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t'i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehen në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ/krijues dhe kritik)

Përveç aftësisë për të identifikuar dhe për t'iu qasur informatës/burimit të njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë të zhvillojnë edhe kapacitete për t'iu qasur njohurive dhe për t'i përpunuar dhe gjykuar në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese.

Kompetenca e të mësuarit (për të nxënë) tërë jetën (Nxënës i suksesshëm)

Për një nxënës të suksesshëm, shkolla angazhohet të kultivojë vazhdimisht kërshërinë e nxënësve dhe interesimin për të nxënë si dhe të zhvillojë kompetencat për të mësuar. Shkolla po ashtu duhet të vetëdijësohet për stilet dhe strategjitë efektive mësimore.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribuues produktiv)

Shkolla angazhohet që nxënësi/ja të përgatitet të punojë në mënyrë të pavarur dhe të vetëdijësohet për rolin dhe përgjegjësinë e tij në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Për të zhvilluar këtë kompetencë, nxënësi/ja përkrahen që të kuptojë në mënyrë të plotë ndërvlerësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore. Njëkohësisht, duke e pasur parasysh arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, ai/ajo përgatitet që të ballafaqohet me preokupime mjedisore, ekonomike dhe sociale.

Kompetenca personale (Individ i shëndoshë)

Shkolla përgatit nxënësit që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësit përkrahen që të vetëdijësohen për veten dhe të kenë vetëbesim, por njëkohësisht të jenë të hapur dhe të kenë besim te të tjerët.

Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm)

Shkolla përgatit nxënësin/en për të jetuar së bashku me të tjerët dhe për të tejkaluar sfida kryesore me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Kjo kompetencë siguron që nxënësi/ja të jetë në gjendje të veprojë si qytetar i përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë të zhvillimeve në shoqëri.

I.5 Rezultatet e të nxënit për shkallën 3 dhe kompetencat kryesore

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËN 3 DHE KOMPETENCAT KRYESORE	
I.	Kompetenca komunikim dhe të shprehur -- komunikues efektiv
1.	Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkruar, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
2.	Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
3.	Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
4.	Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në formë të tjera të komunikimit.
5.	Shkruan tekst deri në 500 fjalë, sipas detyrës së dhënë, si: letër, kërkesë, ese etj., duke respektuar rregullat e organizimit/strukturimit të shkrimit dhe standardin gjuhësor.
6.	Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.
7.	Përdor programet softuerike për komunikim në distancë në formë të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta në jetën e përditshme apo si detyrë shkollore.
8.	Shpreh drejt mendimin apo kërkesën, me gojë ose me shkrim, në gjuhën joamtare ose të huaj, për një situatë të caktuar të supozuar, në rast nevoje (për shërbim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËN 3 DHE KOMPETENCAT KRYESORE	
II.	Kompetenca të menduarit -- mendimtar kreativ dhe kritik
1.	Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në media.
2.	Shpreh mendimin/gjykimin e vet për një punim letrar apo artistik duke veçuar analogjitë dhe dallimet me krijime të tjera të ngjashme.
3.	Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrar, shkencor, artistik).
4.	Zgjidh një problem (aritmetik, gjeometrik, gjuhësor, shoqëror, shkencor... etj.) të dhënë në formë tekstuale ose tekstuale e numerike, eksperimentale dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
5.	Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematik, gjuhësor, shkencor, artistik a shoqëror) duke dëshmuar arritjen e përfundimit, gjegjësisht rezultatin e njëjtë.
6.	Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.
7.	Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/ dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.
8.	Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.
III.	Kompetenca të mësuarit për të nxënë- nxënës i suksesshëm
1.	Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
2.	Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, në matematikë ose arte duke i sqaruar në forma të ndryshme të të shprehurit.
3.	Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
4.	Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.
5.	Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
6.	Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe jo-shkollore në fusha të ndryshme të dijes.
7.	I parashtrohet pyetje vetes (pse, çka, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën apo problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet derisa të gjejë zgjidhjen e duhur për problemin e caktuar.
8.	Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, veprë arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).
IV.	Kompetenca për jetë, punë dhe mjedis - kontribuues produktiv
1.	Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.
2.	Zhvillon një projekt individual ose në bashkëpunim me anëtarët e grupit, për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
3.	Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËN 3 DHE KOMPETENCAT KRYESORE	
4.	Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.
5.	Përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme (si: grafikë, ilustrime të nevojshme, dizajn-im të ftesave, pamfleteve, njoftimeve apo publikimeve të tjera) për nevoja të klasës dhe të shkollës.
6.	Ndihmon në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve vullnetare apo humanitare në shkollë dhe në komunitet dhe shpreh pastaj përvojat dhe ndjenjat e veta me shkrim dhe forma të tjera të të shprehurit.
7.	Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).
8.	Merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik etj., duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.
V. Kompetenca personale - individ i shëndoshë	
1.	Prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi a specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqim të shëndetshëm.
2.	Vlerëson përmbajtjen e vlerave pozitive dhe negative të paktën të tri llojeve të ushqimeve të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose në rrethinë.
3.	Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.
4.	Përkujdeset për shëndetin fizik dhe mendor gjatë aktivitetit fizik dhe sportiv me karakter rekreativ dhe garues, por edhe duke respektuar të tjerët gjatë garës apo lojës.
5.	Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.
6.	Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme të konfliktit midis moshatarëve ose midis anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin e rrezikut dhe zgjidhjen më të mirë për ta, duke ndarë përvojat dhe mendimet për kohezionin e grupit.
7.	Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor.
8.	Shpjegon, gjatë një debati, prezantimi, me gojë ose me shkrim, pasojat e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogës dhe substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit.
9.	Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.
10.	Merr pjesë ose udhëheq një grup punues që bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., raporton më pas me gojë ose me shkrim për përvojat personale të ftuara.
VI. Kompetenca qytetare – qytetar i përgjegjshëm	
1.	Zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, në shkollë etj., dhe merr qëndrim aktiv ndaj personave që nuk i përfillin ato duke ua shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bëjnë pjesë.
2.	Shpreh mendimin për rregullat të cilat dëshiron që t'i ndryshojë në shkollë dhe jashtë saj dhe arsyeton nevojën dhe përfitimet që sjell ndryshimi i tyre.
3.	Reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndër-personale, analizojnë shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre.
4.	Shfaq mirëkuptim për personat të cilëve u është shkelur ndonjë e drejtë, duke ilustruar me shembuj nga jeta e përditshme nga mediat, të dhënat historike, personazhet nga romanet që ka lexuar apo nga filmat që ka parë në mënyrë që të mos përsëriten më.
5.	Shpjegon, në formë të ndryshme të të shprehurit, domosdoshmërinë e respektimit dhe të zbatimit të rregullave dhe ligjeve për raportet e shëndosha në bashkësi të ndryshme shoqërore apo në grupe të interesit.

REZULTATET E TË NXËNIT PËR SHKALLËN 3 DHE KOMPETENCAT KRYESORE

6.	Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.
7.	Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.
8.	Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancën dhe diversitetin kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, në të cilat janë përfshirë moshatarët e të gjitha përkatësive të përmendura që jetojnë në atë mjedis dhe në bashkësinë e gjerë.

I.6 Rolet që ndërmarrin nxënësi dhe mësuesi gjatë procesit të të nxënit:

Nxënësi - aktiv dhe i interesuar. Në gjeografi, nxënësi/ja studion dukuritë dhe proceset gjeografike, ndërton kuptimin për vendin e tij. Ai/ajo inkurajohet të kërkojë përgjigje për pyetjet që ngre, duke hulumtuar në burime të ndryshme dhe, duke përdorur teknika specifike të gjeografisë. Nxënësi/ja angazhohet të vendosë lidhje ndërmjet asaj që di dhe asaj që zbulon dhe mbi këtë bazë ndërton dijen e tij; bashkëvepron me shokët/shoqet dhe mësuesin/en, ndan me ta vëzhgimet dhe përvojat e tij/saj. Ai/ajo punon individualisht ose në grup, dhe mbështetet nga mësuesi/ja.

Mësuesi - udhëheqës dhe lehtësues. Mësuesi/ja i gjeografisë ndihmon nxënësit të zbulojnë kënaqësitë e të nxënit. Roli i mësuesit/es konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai/ajo moderon kërkimin dhe eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesit veprojnë si moderatorë midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes. Ato krijojnë kontekste të nxëni të cilat i aftësojnë nxënësit të përftojnë mjetet e gjeografit. Zbatimi i programit kërkon që mësuesi/ja të përdorë strategji mësimdhënieje duke respektuar stilet e të nxënit të nxënësve. Ai/ajo i angazhon nxënësit në ndërtimin e mendimit, duke nxitur diskutimet dhe ballafaqimin e këndvështrimeve të ndryshme.


I.7 Çfarë situata duhet të përdoren në funksion të të nxënit

- *Situatat e të nxënit* në gjeografi duhet të jenë të larmishme dhe komplekse. Nxënësi duhet të perceptojë lidhjen ndërmjet përvojave të tij të të nxënit dhe zbatimeve të ardhshme.
- *Situatat duhet të jenë të hapura*, që do të thotë që nxënësi/ja aftësohet të kërkojë zgjidhje të ndryshme për një çështje apo problem, dhe jo një zgjidhje të vetme apo një përgjigje të vetme. Situata të tilla përfshijnë detyra të ndryshme, favorizojnë përdorimin e mediave të ndryshme dhe rezultojnë me punime të llojeve të ndryshme.
- *Situatat e të nxënit duhet të jenë komplekse*, që do të thotë të përdoren burime të ndryshme të të nxënit dhe nxënësit të punojnë së bashku. Kërkimi, analiza dhe përzgjedhja e të dhënave duhet të jenë gjithmonë pjesë e situatave të të nxënit. Ato duhet të mbështeten në kërkimin gjeografik, i cili përfshin analizën krahasuese të dukurive gjeografike në shkallë të ndryshme. Këto lloj situatash kërkojnë zhvillimin e shprehive të të pyeturit, analizës, mendimit kritik dhe krijues.

I.8 Në sa mënyra vlerëson mësuesi/ja?

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara.

Përdorimi i portofolit, si një koleksion sistematik i punës së nxënësve, siguron një tablo të plotë të zhvillimit e të progresit të nxënësve në përvetësimin e njohurive, të kuptuarit e koncepteve, zbatimin e shkathtësive dhe zhvillimin e qëndrimeve. Ai/ajo u afron nxënësve gjithashtu mundësi për vetëvlerësim dhe reflektim përmes rishikimit të portofolave të tyre.





II. Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor

Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor përmban:

- Planin vjetor
- Planin dymujor
- Planin e orës mësimore

II.1 Modeli i planifikimit vjetor

PLANI VJETOR - 2018/2019

FUSHA E KURRIKULËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI

KLASA: 6 (E GJASHTË)

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës
PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
Shtator – Tetor (17 orë)	Nëntor – Dhjetor (17 orë)	Janar – Shkurt (12 orë)	Mars – Prill (11 orë)	Prill – Maj (10 orë)	Qershor (7 orë)	<ul style="list-style-type: none">I.1; I.2; I.3; I.4; I.5; I.6; I.7; I.8. II.1; II.3; II.4; II.6; II.7; II.8. III.1; III.2; III.3; III.4; III.5; III.7; III.8.IV.2; IV.3; IV.5; IV.6; IV.7; IV.8. V.5; V.6; V.7.VI.1; VI.3; VI.4; VI.5; VI.6; VI.8.
Tema I - Vendi dhe hapësira	Tema I - Vendi dhe hapësira vazhdim	Tema II - Sistemet fizike (Gjeosferat) vazhdim	Tema II - Sistemet fizike (Gjeosferat) vazhdim	Tema III - Sistemet humane	Tema III - Sistemet humane vazhdim	
1- Gjeografia dhe roli i saj	18- Shkalla e hartës	1- Atmosfera dhe përbërja e saj	13- Rrymat oqeanike	1- Dinamika e popullsisë së botës	11- Sektori tretësor (vazhdim)	
2- Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik	19- Punë Praktike Nr. 1.5: Si të orientohe mi me shkallën e hartave të ndryshme	2- Rrezatimi diellor dhe shpërndarja e nxehtësisë në Tokë	14- Lumenjtë dhe elementet përbërëse të tyre	2- Shpërndarja e popullsisë në botë	Tema IV - Bashkëveprimi njeri-natyre	
3- Pesë temat bazë të gjeografisë	20- Punë praktike Nr. 1.6 Ndërtimi i një harte topografike dhe orientimi me anë të saj	3- Moti	15- Liqenet dhe llojet e tyre	3- Strukturat kryesore të popullsisë në botë	1- Mjedisi gjeografik dhe veprimtaria njerëzore	
4- Lëvizja dhe bashkëveprimi njeri-natyre	Tema II - Sistemet fizike (Gjeosferat)	4- Punë Praktike 2.1 -Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin	16- Ujërat nëntokësorë dhe burimet	4- Migrimet e popullsisë	2- Njeriu dhe ndryshimet klimatike	

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
Shtator – Tetor (17 orë)	Nëntor – Dhjetor (17 orë)	Janar – Shkurt (12 orë)	Mars – Prill (11 orë)	Prill – Maj (10 orë)	Qershor (7 orë)	
5- Toka në sistemin diellor	21- Ndërtimi brendshëm i Tokës	5- Punë praktike Nr. 2.2 - Parashikimi i motit përmes leximit të hartave sinoptike dhe përdorimit të instrumenteve të thjeshta.	17- Bora dhe akujt	5- Vendbanimet. Elementet e shtetit dhe roli i organizatave ndërkombëtare	3- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i burimeve natyrore	
6- Forma dhe përmasat e Tokës	22- Format e relievit	6- Klima	18- Biosfera	6- Veçoritë e zhvillimit ekonomik në botë dhe faktorët kryesorë që ndikojnë	4- Përsëritje 5 (Sistemet humane dhe bashkëveprimi njeri-natyrë)	
7- Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet dhe pasojat gjeografike	23- Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike	7- Zonat klimatike	19- Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës së gjallë	7- Sektori parësor i ekonomisë	5- Testim 3 (periudha e tretë)	
8- Rrotullimi i Tokës rreth Diellit	24- Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre	8- Punë praktike Nr. 2.3 - Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas zonave të nxehtësisë. Ndërtimi dhe interpretimi i grafikëve klimatikë për vende të ndryshme në to.	20- Punë praktike Nr. 2.4 - Shpërndarja e botës së gjallë sipas zonave të nxehtësisë	8- Sektori dytësor i ekonomisë	6- Projekt - Ora e tretë - Çështjet mjedisore në/pranë vendbanimit tim	

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
PERIUDDHA (I)		PERIUDDHA (II)		PERIUDDHA (III)		
Shtator – Tetor (17 orë)	Nëntor – Dhjetor (17 orë)	Janar – Shkurt (12 orë)	Mars – Prill (11 orë)	Prill – Maj (10 orë)	Qershor (7 orë)	
9- Punë Praktike Nr. 1.1: Toka në sistemin Diellor	25- Tërmetet	9- Përsëritje 3 Atmosfera	21- Përsëritje 4 Hidrosfera	9- Sektori dytësor i ekonomisë (vazhdim)		
10- Përsëritje 1: Toka në sistemin Diellor	26- Vullkanet	10- Cikli i ujit. Veçoritë e ujit të deteve dhe të oqeaneve	22- Testim 2 (periudha e dytë)	10- Sektori tretësor		
11- Koordinatat gjeografike	27- Projekt - Ora e parë- Çështjet mjedisore pranë vendbanimit tim	11- Lëvizjet e ujërave oqeanikë. Valët detare.	23- Projekt - Ora e dytë - Çështjet mjedisore pranë vendbanimit tim			
12- Punë praktike Nr. 1.2 - Përcaktimi i vendndodhjes absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike	28- Tjetërsimi	12- Baticat dhe zbaticat				
13- Koha lokale dhe koha zonale. Orientimi në terren	29- Veprimtaria e erës					

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE							Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)			
Shtator – Tetor (17 orë)	Nëntor – Dhjetor (17 orë)	Janar – Shkurt (12 orë)	Mars – Prill (11 orë)	Prill – Maj (10 orë)	Qershor (7 orë)		
14- Punë Praktike Nr. 1.3: - Përcaktimi i kohës zonale të vendeve me gjatësi të ndryshme ndryshme gjeografike	30- Veprimtaria e gravitetit						
15- Paraqitja grafike e Tokës	31- Veprimtaria e lumenjve. Veprimtaria e akullnajave						
16- Punë praktike Nr. 1.4 - Ndryshimet midis globit, hartës dhe planit	32- Veprimtaria e bregdetare. Llojet e bregdeteve						
17- Përmbytja e hartës. Llojet e hartave	33- Përsëritje 2 -Litosfera 34- Testim 1 (periudha e parë)						

II.2 Modeli i planifikimit 2/3 mujor

PLANI DYMUJOR Shtator-Tetor

FUSHA E KURRIKULËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA MËSIMORE: GJEOGRAFI KLASA: 6 (E GJASHTË)

Tema mësimore: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shpjegimit të temës/ve: I.1; I.2; I.6; I.7; I.8; II.1; II.5; II.6; II.7; II.8; III.2; III.4; III.5; III.7; III.8; IV.3; IV.5; IV.7; IV.8; V.6; V.10; VI.5; VI.8

Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shpjegimit të temës/ave: I.2; I.4; I.5; I.6; II; III.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Tema I Vendi dhe Hapësira	- Përshkruan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja, vendi, mjedisi, rajoni dhe ndërveprimi. - Përshkruan formën e tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre. - Identifikon veçoritë kryesore të Tokës e sistemit diellor, të planetëve, asteroideve, kometave, satelitëve dhe hënës si trup qiellor e satelit natyror i Tokës. - Vlerëson rëndësinë e diellit për dukuritë gjeografike. - Identifikon provat dhe pasojat e lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vetë. - Shpjegon rrjedhojat e lëvizjes së tokës rreth diellit.	1 - Gjeografia dhe roli i saj 2 - Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik 3 - Pesë temat bazë të gjeografisë 4 - Lëvizja dhe bashkëveprimi njeri-natyre 5 - Toka në sistemin diellor 6 - Forma dhe përmasat e Tokës 7 - Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet dhe pasojat gjeografike 8 - Rrotullimi i Tokës rreth Diellit 9 - Punë Praktike Nr. 1.1: Toka në sistemin Diellor 10 - Përsëritje 1: Toka në sistemin Diellor 11 - Koordinatat gjeografike	1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë 1 orë	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale; Bashkëbisedim; Përdorimi TIK; Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Lojë me role. Ose e shprehur edhe si: - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt). - Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve). - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).	- Vlerësim me gojë; - Vlerësim i punës në grup; - Vlerësim i punës praktike; - Vlerësim i detyrës së shtrëpisë; - Vlerësim i ese-ve; - Vlerësim me shkrim; - Vlerësim i lojës me role; - Vlerësim i projekte/detyra tematike; - Vlerësim me dosje; - Vetëvlerësim etj.	Lidhje me fushën e: Shkencave të Natyrës (Fizika, Biologjia dhe Kimia); Gjuhës dhe Komunikimit (Gjuhën Amtare); TIK; Matematikës etj. Lidhje me temat ndërkurrikulare: 1) Globalizimi dhe ndërvlerësia 2) Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti i gjeografisë; Harta të ndryshme; glob; materiale nga interneti, libra, enciklopedi; muzeum; plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, pjesëmarrje në ngjarje kulturore apo historike, teknologji e informacionit.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<p>- Përcakton kohën vendore dhe zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike.</p> <p>- Përshkruan mënyrat e orientimit në natyrë (me anë të diellit, orës, myshqeve, yllit polar, busullës, objekteve fetare, etj.).</p> <p>- Krahason hartën dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre (elementet matematike dhe gjeografike të hartës).</p> <p>- Mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme.</p> <p>- Shpjegon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (trjetin e paraleleve dhe meridianëve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike).</p> <p>- Përshkruan përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës.</p>	<p>12- Punë praktike Nr. 1.2</p> <p>- Përcaktimi i vendndodhjes absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike</p> <p>13- Koha lokale dhe koha zonale. Orientimi në terren</p> <p>14- Punë Praktike Nr. 1.3: - Përcaktimi i kohës zonale të vendeve me gjatësi të ndryshme gjeografike</p> <p>15- Paraqitja grafike e Tokës</p> <p>16- Punë praktike Nr. 1.4 - Ndryshimet midis globit, hartës dhe planit</p> <p>17- Përmbajtja e hartës. Llojet e hartave</p>	<p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p> <p>1 orë</p>	<p>- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit).</p> <p>- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.</p> <p>- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit.</p> <p>- Mësimdhënie që nxit hulumtimin.</p> <p>- Të mësuarit në natyrë (sa herë që është e mundur).</p>			

PLANI DËMYJOR NËNTOR-DHJETOR

**FUSHA E KURRIKULËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI
LËNDA MËSIMORE: GJEOGRAFI KLASA: 6 (E GJASHTË)**

Tema mësimore 1: Vendi dhe hapësira

Tema mësimore 2: Sistemet fizike (Gjeosferat)

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: I.1; I.2; I.6; I.7; I.8; II.1; II.5; II.6; II.7; II.8; III.2; III.4; III.5; III.7; III.8; IV.3; IV.5; IV.7; IV.8; V.6; V.10; VI.5; VI.8.

Rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare të shkollës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.2; I.4; I.5; I.6; II; III.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Tema I - Vendi dhe Hapësira	- Përshkruan përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë. - Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.	18- Shkalla e hartës	1 orë	Punë në grupe; Punë në dyshe;	- Vlerësim me gojë;	Lidhje me fushën e: Shkencave të Natyrës (Fizika, Biologjia dhe Kimia); Gjuhës dhe Komunikimit (Gjuhën Amtare); TIK; Matematikës etj. Lidhje me temat ndërkurrikulare: 1) Globalizimi dhe ndërvatësia 2) Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti i gjeografisë; Harta të ndryshme; glob; materiale nga interneti, libra, enciklopedi; muzeum; plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive; pjesëmarje në ngjarje kulturore apo historike, teknologji e informacionit
		19- Punë Praktike Nr. 1.5: Si të orientohe mi me shkallën e hartave të ndryshme.	1 orë	Punë individuale; Bashkëbisedim; Përdorimi TIK;	- Vlerësim i punës në grup;		
		20- Punë praktike Nr. 1.6 Ndërtimi i një harte topografike dhe orientimi me anë të saj.	1 orë	Hulumtim dhe zbulim; <i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat;	- Vlerësim i detyrës së shtrëpisë;		
		21- Ndërtimi i brendshëm i Tokës	1 orë	Lojë me role.	- Vlerësim i ese-ve;		
Tema II - Sistemet fizike (Gjeosferat)	- Diferencon shtresat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre. - Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene) dhe krijimin e tyre. - Përshkruan format e relievit, llojet dhe shkaktarët e krijimit (format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme). - Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, tërmeteve dhe zonat	22- Format e relievit	1 orë	Ose e shprehur edhe si: - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt).	- Vlerësim me shkrim;	1) Globalizimi dhe ndërvatësia 2) Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	Teksti i gjeografisë; Harta të ndryshme; glob; materiale nga interneti, libra, enciklopedi; muzeum; plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive; pjesëmarje në ngjarje kulturore apo historike, teknologji e informacionit
		23- Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike	1 orë		- Vlerësim i lojës me role;		
		24- Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre	1 orë		- Vlerësim i projekte/detyra tematike;		
		25- Tërmetet	1 orë		- Vlerësim me dosje;		
		26- Vullkanet	1 orë		- Vetëvlerësim etj.		
		27- Projekt - Ora e parë - Çështjet mjedisore pranë vendbanimit tim	1 orë				
		28- Tjetërsimi	1 orë				
		29- Veprimtaria e erës	1 orë				
		30- Veprimtaria e gravitetit	1 orë				
			1 orë				

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<p>kryesore të paraqitjes së tyre.</p> <p>- Përshkruan shkaqet e tjetërsimit (alterimit), kushtet në cilat zhvillohet procesi i kastit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike.</p> <p>- Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, eolik dhe abraziv.</p>	<p>31- Veprimtaria e lumenjve. Veprimtaria e akullnajave</p>	1 orë	- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit).			
		<p>32- Veprimtaria e bregdetare. Llojet e bregdeteve</p>	1 orë	- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.			
		<p>33- Përsëritje 2 -Litosfera</p>	1 orë	- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit.			
		<p>34- Testim 1 (periudha e parë)</p>	1 orë	- Mësimdhënie që nxit hulumtimin. - Të mësuarit në natyrë (sa herë që është e mundur).			

PERIUDHA E DYTË JANAR-MARS

FUSHA E KURRIKULËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA MËSIMORE: GJEOGRAFI KLASA: 6 (E GJASHTË)

Tema mësimore: Sistemet fizike (Gjeosferat)

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: I.3; I.4; I.5; I.6; I.7; II.3; II.5; II.7; II.8; III.1; III.5; III.6; III.7; III.8; IV.1; IV.5; IV.7; IV.8; V.1; V.3; VI.5; VI.6; VI.7.

Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ave: I.2; I.4; I.5; I.6; II; III.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për temën mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Tema II - Sistemet fizike (Gjeosferat)	- Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat kryesore të tyre.	1- Atmosfera dhe përbërja e saj	1 orë	Punë në grup;	- Vlerësim me gojë;	Lidhje me fushën e: Shkencave të Natyrës (Fizika, Biologjia dhe Kimia); Gjuhës dhe Komunikimit (Gjuhën Amtare); TIK; Matematikës etj.	Teksti i gjeografisë; Harta të ndryshme; glob; materiale nga interneti, libra, enciklopedi; muzeum; plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë; pjesëmarje në ngjarje kulturore apo historike, teknologji e informacionit
	- Përshkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndryshimet në planin horizontal dhe vertikal.	2- Rrezatimi diellor dhe shpërndarja e nxehtësisë në Tokë	1 orë	Punë individuale; Bashkëbisedim; Përdorimi TIK; Huluntim dhe zbulim;	- Vlerësim i punës në grup; - Vlerësim i punës praktike; - Vlerësim i detyrës së shtrëpisë;		
	- Gjen temperaturën mesatare ditore, mujore e vjetore të ajrit dhe amplitudat ditore dhe vjetore të temperaturës së ajrit.	3- Moti	1 orë	<i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat;	- Vlerësim me shkrim;	Lidhje me temat ndërkurrikulare: 1) Globalizimi dhe ndërvlerësia 2) Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	
	- Shpjegon shrypjen atmosferike, ndryshimin e saj, rolin e saj në erëra dhe në vetë jetën e njeriut.	4- Punë Praktike 2.1 - Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin.	1 orë	Lojë me role.	- Vlerësim i lojës me role;		
	- Përshkruan konceptin lagështi e ajrit dhe kushtet e formimit të reshjeve atmosferike.	5- Punë praktike Nr. 2.2 - Parashikimi i motit përmes leximit të hartave sinoptike dhe përdorimit të instrumenteve të thjeshta.	1 orë	Ose e shprehur edhe si: - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt).	- Vlerësim i projekte/detyra tematike; - Vlerësim me dosje; - Vetëvlerësim etj.		
	- Punon dhe interpreton grafkë të shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve.	6- Klima	1 orë	- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt).			
		7- Zonat klimatike	1 orë	- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve).			
		8- Punë praktike Nr. 2.3 - Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas zonave të nxehtësisë. Ndërtimi dhe interpretimi i grafkëve klimatike për vende të ndryshme në to.	1 orë	- Mësimdhënia me anë të pyetjeve			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	Formulon konceptet mot dhe klimë, dhe të bënë dallimin midis tyre. - Identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës dhe zonat klimatike nga ekuatori në pole. - Përkthruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetit fizike e kimike të ujit të Detit botëror. - Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të Detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën). - Identifikon format kryesore të zhvillimit horizontal të bregdetit duke veçuar veçoritë kryesore të tyre. - Identifikon llojet e ujërave nëntokësore,	9- Përsëritje 3 Atmosfera	1 orë	(teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). - Diskutimi dhe të nxënësve bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit). - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. - Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit. - Mësimdhënie që nxit hulumtimin. - Të mësuarit në natyrë (sa herë që është e mundur).			
		10- Cikli i ujit. Veçoritë e ujit të deteve dhe të oqeanëve	1 orë				
		11- Lëvizjet e ujërave oqeanikë. Valët detare.	1 orë				
		12- Baticat dhe zbaticat	1 orë				
		13- Rrymat oqeanike	1 orë				
		14- Lumenjtë dhe elementet përbërëse të tyre	1 orë				
		15- Liqenet dhe llojet e tyre	1 orë				
		16- Ujërat nëntokësorë dhe burimet	1 orë				
		17- Bora dhe akujt	1 orë				
		18- Biosfera	1 orë				
		19- Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës së gjallë	1 orë				
20- Punë praktike Nr. 2.4 - Shpërndarja e botës së gjallë sipas zonave të nxehtësisë	1 orë						
21- Përsëritje 4 Hidrosfera	1 orë						

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënësve për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit. - Diferencon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre. - Përshkruan veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën). - Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.	22- Testim 2 (periudha e dytë) 23- Projekt - Ora e dytë - Çështjet mjedisore pranë vendbanimit tim	1 orë 1 orë				

PERIUDHA E TRETË PRILL-QERSHOR

FUSHA E KURRIKULËS: SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA MËSIMORE: GJEOGRAFI KLASA: 6 (E GJASHTË)

Tema mësimore 1: Sistemet Humane

Tema mësimore 2: Bashkëveprimi njeri-natyrë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.2; I.6; I.7; I.8; II.1; II.3; II.4; II.5; III.1; III.3; III.5; III.7; IV.5; IV.7; IV.8; V.6; V.10; VI.5; VI.7; VI.8.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënës për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)		Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Nërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Tema II - Sistemet Humane	Përkshuan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë (lëvizja numerike, dendësia, lëvizjen natyrore).	1- Dinamika e popullsisë së botës	1 orë	Punë në grup; Punë në dyshe; Punë individuale;	- Vlerësim me gojë; - Vlerësim i punës në grup;	- Vlerësim me gojë; - Vlerësim i punës në grup;	Lidhje me fushën e: Shkencave të Natyrës (Fizika, Biologjia dhe Kimia); Gjuhës dhe Komunikimit (Gjuhën Amtare); TIK; Matematikës etj.	Teksti i gjeografisë; Harta të ndryshme; glob; materiale nga interneti, libra, enciklopedi; muzeum;
	- Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë.	2- Shpërndarja e popullsisë në botë	1 orë	Bashkëbisedim; Përdorimi TIK; Hulumtim dhe zbulim;	- Vlerësim i punës praktike;	- Vlerësim i punës praktike;		
	- Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve.	3- Strukturat kryesore të popullsisë në botë	1 orë	<i>Brainstorming</i> ; Diskutime; Debat; Lojë me role.	- Vlerësim i detyrës së shtëpisë;	- Vlerësim i detyrës së shtëpisë;		
	- Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksionet dhe kriterit kryesore të tyre.	4- Migrimet e popullsisë	1 orë		- Vlerësim i ese-ve;	- Vlerësim i ese-ve;		
	- Identifikon elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare.	5- Vendbanimet. Elementet e shtetit dhe roli i organizatave ndërkombëtare	1 orë		- Vlerësim me shkrim;	- Vlerësim me shkrim;	Lidhje me temat ndërkurrikulare: 1) Globalizimi dhe ndërvlerësia 2) Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm	plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë; pjesëmarrje në ngjarje kulturore apo historike, teknologji e informacionit.
	- Përkshuan veçoritë themelore ekonomike- gjeografike në botë si faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.	6- Veçoritë e zhvillimit ekonomik në botë dhe faktorët kryesorë që ndikojnë	1 orë	Ose e shprehur edhe si: - Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt).	- Vlerësim i lojës me role;	- Vlerësim i lojës me role;		
		7- Sektori parësor i ekonomisë	1 orë		- Vlerësim i projektet/detyra tematike;	- Vlerësim i projektet/detyra tematike;		
		8- Sektori dytësor i ekonomisë	1 orë		- Vlerësim me dosje;	- Vlerësim me dosje;		
		9- Sektori dytësor i ekonomisë (vazhdim)	1 orë		- Vetëvlerësim etj.	- Vetëvlerësim etj.		
		10- Sektori tretësor	1 orë					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënitor për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor). - Shpjegon llojet dhe rëndësinë e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë, etj.) - Identifikon degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj. - Përshkruan procesin e industrializimit. - Identifikon degët kryesore të industrisë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj. - Shpjegon veçoritë e transportit (automobilistik, hekurudhor, ujor, ajror) dhe rolin e tij në zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe vet ekonomisë. - Përshkruan rëndësinë e tregtisë për zhvillimin ekonomik. 	11- Sektori tretësor (vazhdim)	1 orë	(shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve). - Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve). - Diskutimi dhe të nxënitor në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit). - Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. - Të mësuarit dhe të nxënitor përmes mjeteve			

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënës për temë mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)			Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Tema IV - Bashkëveprimi njeri-natyrë	- Shpjegon rolin e turizmit dhe veprimtarive tjera (të sipër përmendura) në zhvillimin ekonomik. - Vlerëson rolin e turizmit në shoqërinë bashkëkohore.					multimediale e në veçanti përmes kompjuterit. - Mësimdhënie që nxit hulumtimin.			
	Përkthejnë ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas.	12- Mjedi si gjeografik dhe veprimtaria njerëzore	1 orë			- Të mësuarit në natyrë (sa herë që është e mundur).			
	- Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.	13- Njeriu dhe ndryshimet klimatike 14- Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i burimeve natyrore	1 orë						
	- Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore.	15- Përsëritje V (Sistemet humane dhe bashkëveprimi njeri-natyrë)	1 orë						
	- Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre.	16- Testim 3 (periudha e tretë) 17- Projekt - Ora e tretë - Çështjet mjedisore në/pranë vendbanimit tim	1 orë 1 orë						

II.3 Modeli i planifikimi të orës mësimore (modele skematike)

Njësia mësimore I.1: Gjeografia dhe roli i saj

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/vendi, mjedisi, regjion, ndërveprimi dhe zhvillimi.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3; I. 4; I. 6; I. 8; II. 6; III. 7; III. 8; IV. 5; VI. 6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. 2; I. 4; I. 5; I. 6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.1: Gjeografia dhe roli i saj__			
Fjalët kyçe: gjeografia, roli i gjeografisë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Demonstron interes për gjeografinë, degët e saj dhe karrierat që lidhen me të.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjeografia kl. 6, informacione të hulumtuara në internet, tekste/burime të tjera informacioni të sugjeruara nga mësuesi/ja, mjete të tjera ndihmëse.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat natyrore, TIK, jeta dhe puna			
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në kuriozitetin e vazhdueshëm që i karakterizon nxënësit, në të përditshmen e tyre dhe në dëshirën e vazhdueshme të tyre për të mësuar rreth botës që i rrethon. Përdor pyetje të cilat ata mund t'i kenë bërë në jetën e përditshme... Për këtë, mësuesi/ja përdor edhe situatën e vendosur në fillim të mësimi I.1, në rubrikën “Diskutojmë”: “Në pamjet e paraqitura në figurat 1 dhe 2, dallohet një mjedis natyror dhe një mjedis i transformuar prej njeriut. Duke i vrojtuar, lindin pyetje të tilla si: Ku ndodhen këto vende? Si janë krijuar? Si dhe pse kanë ndryshuar? Si mendoni, cila lëndë mësimore mund të na ndihmojë për të marrë përgjigjet e këtyre pyetjeve apo të shumë të tjerave rreth mjedisit që na rrethon?”			
Hapi I: Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë... Mësuesi/ja vazhdon: Në jetën tonë të përditshme, mund të na lindin edhe pyetje të tjera që kanë lidhje me shumë dukuri dhe vende që gjenden rreth nesh. P.sh.: Pse ndodhin tërmetet? Pse shpërthejnë vullkanet? etj. Mësuesi/ja pret prej nxënësve të tregojnë pyetje të ndryshme që ata kanë mbi botën që i rrethon...			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto b) Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja vazhdon: Sa më shumë rritemi, aq më shumë duam të dimë mbi hapësirën që na rrethon. Për të marrë përgjigje rreth pyetjeve të mësipërme, si dhe për t'u njohur me tiparet e gjithë hapësirës së planetit tonë, na ndihmon <i>gjeografia</i> (shih figurën 3). Gjeografia është shkenca që studion tiparet fizike e humane të Tokës,			

si dhe bashkëveprimin midis tyre. Ajo ndahet në disa degë, midis të cilave dallojnë: *gjeografia fizike*, *gjeografia humane* dhe *gjeografia mjedisore*. Gjeografia fizike studion tiparet fizike të Tokës, formimin e ditë-natës dhe të stinëve, si dhe të gjitha dukuritë natyrore e ndryshimet që ndodhin në mënyrë të vazhdueshme në Tokë (në sipërfaqe dhe në brendësi të saj). Gjeografia humane studion veçoritë që merr çdo mjedis në Tokë si rezultat i veprimtarisë njerëzore. Gjeografia mjedisore studion marrëdhënien e ndërsjellë midis mjedisit fizik dhe veprimtarisë së njeriut. Ajo studion gjithashtu shkallën dhe mënyrën si ndikojnë ata te njëri-tjetri. Ky ndikim mund të jetë pozitiv ose negativ.

Mësuesi/ja drejton edhe njëherë pyetjen: Atëherë, si ndihmon gjeografia në jetën e përditshme?

Për këtë, ajo orienton nxënësit të lexojnë shembujt në tekst dhe më pas ftohen të sjellin shembuj se si ndihmon gjeografia në jetën e tyre të përditshme...

Shënim: nxënësi/ja orientohet me tej: si të ndihmon gjeografia në orientimin me terrenin, kushtet e motit, me anët e horizontit, llojin e bimësisë që rritet në klimën e zonës ku banon... etj.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhjet/rezultatet/gjetjet e tyre.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet e dhëna në tekst, në rubrikën “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore I.2: Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore

Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Përkthyer përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/vendi, mjedisi, regjion, ndërveprimi dhe zhvillimi.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I. 3; I. 4; I. 6; I. 8; II. 6; III. 7; III. 8; IV. 5; VI. 6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I. 2; I. 4; I. 5; I. 6; II; III			

Aspektet specifike të planit të orës mësimore**Njësia mësimore I.2:** Burimet dhe metodat e kërkimit gjeografik**Fjalët kyçe:** gjeograf, burimet e gjeografit, metodat e kërkimit gjeografik**Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore:** Nxënësi/ja diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë.**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:** Gjeografia kl. 6, informacione të hulumtuara në internet, tekste/burime të tjera informacioni të sugjeruara nga mësuesi/ja, mjete të tjera ndihmëse.**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:** Fusha:

Gjuhët dhe komunikimi, shkencat natyrore, TIK, jeta dhe puna

Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore****a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve****Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin I.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Veprimet në situatë**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin I.2 në tekst dhe fton nxënësit të shohin figurën 2. Diskutojmë: “Një urbanist mund ta shohë, mjedisin e paraqitur në figurën 1, si një zonë ideale për të ndërtuar një zonë turistike. Një fermer mund ta mendojë atë si një zonë të përshtatshme për të mbjellë vreshta ose ullinj. Një gjeograf ka një mënyrë unike të të vështruarit të saj. Pasi studion të gjitha mundësitë dhe kufizimet që ajo ka, ai sugjeron zgjidhjet më të mira. Si i gjykon ti qëndrimet e secilit prej tyre ndaj mjedisit?”

Mësuesi/ja edhe mund të zgjerojë informacionin për të plotësuar të dhëna të tjera mbi situatën, p.sh. mund të detajojë qëndrimin e secilit individ mbi mjedisin natyror të paraqitur në figurë (shih shembullin përmbri). Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë..., vlerësojnë rolin e gjeografit.

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon: Në studimet e tyre, gjeografët përdorin mjete dhe burime të ndryshme, si për shembull: burime parësore... dytësore... Gjatë trajtimit të saj, mësuesi/ja fton nxënësit të shohin dhe të diskutojnë së bashku mbi skemën e librit (fig. 2) dhe figurat (3a dhe 3b).

Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë burimet, mjetet dhe metodat e gjeografit.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1 dhe 2. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/ rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimin. Përdoret:

- Vlerësim me gojë

- Vlerësim i punës në grup

Përgjigjet supozuara të një gjeografi mbi situatën në figurën 1.

Pasi studion mjedisin natyror të paraqitur në figurën nr. 1, gjeografi ofron përgjigje për urbanistin dhe për fermerin. Për shkak të klimës dhe të relievit, ai e quan të përshtatshme idenë e fermerit për vreshtari. Për urbanistin, ai sugjeron: nëse do të jetë një zonë turistike, për shkak të shtresave të paqëndrueshme dhe të rrëshqitshme të tokës në të, nuk mund të ketë ndërtime shumëkatëshe, por vetëm disa ndërtime të ulëta. Përveç kësaj, për të mbrojtur bregdetin dhe ujërat nga ndotjet, gjeografi kërkon që urbanisti të planifikojë drejt se ku do të derdhen ujërat e zeza dhe të bardha.

- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 2 te rubrika “Radha jote”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore: I.3. Pesë temat bazë të gjeografisë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/vendi, mjedisi, regjion, ndërveprimi dhe zhvillimi.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.3: Pesë temat bazë të gjeografisë			
Fjalët kyçe: pesë temat bazë të gjeografisë, vendndodhja, vendi, rajoni dhe llojet e tij			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja demonstroi përmes shembujve kuptimin mbi vendndodhjen gjeografike (absolute, relative të vendit), vendin (tiparet fizike dhe humane) dhe rajonin.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjeografia kl. 6, informacione të hulumtuara në internet, tekste/burime të tjera informacioni të sugjeruara nga mësuesi/ja, mjete të tjera ndihmëse.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat natyrore, TIK, jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
Situata e të vepruarit			
Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Veprimet në situatë			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit			
Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.3 në tekst - Diskutojmë: “Nëse për pushimet e verës fton në shtëpinë tënde një shok apo shoqe që jeton jashtë Kosovës, si do ta orientoje për të ardhur deri aty? Si do t’ia përshkruaje vendbanimin tënd?”.			
Nxënësit diskutojnë, tregojnë...			

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon: Vendi që përshkruat, është objekt i studimit të gjeografisë. Ai është një nga “pesë temat bazë të gjeografisë”. Po çfarë janë “pesë temat bazë të gjeografisë?”. Shihni figurën 1 dhe jep kuptimin e tyre. Mësuesi/ja vazhdon të sqarojë për nxënësit konceptet vendndodhje absolute dhe relative: Vendi që përshkrove ka një vendndodhje gjeografike. Ajo është absolute dhe relative...

Gjatë trajtimit, fton nxënësit të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi shembujt e përdorur në tekst (shembujt 1, 2).

Mësuesi/ja vazhdon: Cilat janë tiparet që ka një vend? Vendi ka tipare... Në vazhdim, fton nxënësit (të ndarë në grupe) të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi shembullin e përdorur në tekst (shembulli 3).

Nxënësit diskutojnë mbi to. Përveç këtyre modeleve, nxënësit sjellin të tjerë shembuj ilustrues... ata tregojnë, përshkruajnë vendndodhjen absolute, relative të vendit të tyre si dhe tiparet fizike dhe humane të tij.

Mësuesi/ja vazhdon: Çfarë është rajoni? Sa lloje rajonesh njihni?... Në vazhdim, fton nxënësit (të ndarë në grupe) të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi shembujt e përdorur në tekst (shembulli 4 dhe 5).

Nxënësit diskutojnë mbi to. Përveç këtyre modeleve, nxënësit sjellin të tjerë shembuj ilustrues... Ata tregojnë, përshkruajnë tiparet fizike apo humane të rajoneve.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1 dhe 2. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/ rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 3 dhe 4 të rubrika “Radha jote”

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore: I.4. Lëvizja dhe bashkëveprimi njeri-mjedis

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore				
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis		Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira			Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan përmes shembujve kuptimin e koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre: vendndodhja/vendi, mjedisi, regjion, ndërveprimi dhe zhvillimi.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV. 2; IV.4; IV.5; VI.6				
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III				
Aspektet specifike të planit të orës mësimore				
Njësia mësimore I.4: Lëvizja dhe bashkëveprimi njeri-mjedis				
Fjalët kyçe: lëvizje; bashkëveprimi njeri-mjedis				
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja demonstroi kuptimin mbi lëvizjen; demonstroi konceptin bashkëveprim dhe përmes shembujve analizon dhe vlerëson format e bashkëveprimit midis njeriut dhe natyrës.				
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjeografia kl. 6, informacione të hulumtuara në internet, tekste/burime të tjera informacioni të sugjeruara nga mësuesi/ja, mjete të tjera ndihmëse.				
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat natyrore, TIK, jeta dhe puna				
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm				
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore				
b) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve				
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).				
Veprimet në situatë Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.4 në tekst - Diskutojmë: “Shpesh udhëtojmë nga njëri vend në tjetrin. Komunikojmë me njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme, duke shkëmbyer jo vetëm informacione dhe ide, por edhe produkte të shumëllojshme. Në të njëjtën kohë, ne bashkëveprojmë edhe me mjedisin ku jetojmë. Të gjitha këto lidhje dhe bashkëveprime janë objekt studimi për gjeografët. Përmendni disa forma të komunikimit dhe të bashkëveprimit që ndeshni në jetën e përditshme .” Nxënësit diskutojnë, tregojnë...				
b. Ndërtimi i njohurive të reja				
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Lëvizja është një tjetër temë bazë e gjeografisë që përfshin: lëvizjen e njerëzve, të mallrave, të informacionit dhe të ideve... Më tej vazhdon: lëvizja e njerëzve (migrimi): mund të bëhet për një jetë më të mirë, për më tepër liri, për arsye katastrofash natyrore etj. Për ta kuptuar konceptin, mësuesi/ja fton nxënësit të krahasojnë figurat 1, 2 në tekst dhe të diskutojnë mbi shkaqet që kanë sjellë lëvizjet e popullsisë.				

Nxënësit diskutojnë...

Mësuesi/ja vazhdon: Lëvizja e mallrave përfshin...

Fton nxënësit të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi figurën 3.

Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...

Mësuesi/ja vazhdon: Lëvizja e ideve përfshin...

Fton nxënësit të vërejnë, të kuptojnë dhe të diskutojnë mbi figurën 5.

Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...

Mësuesi/ja vazhdon: Njeriu dhe mjedisi bashkëveprojnë midis tyre dhe si rezultat, për të dy rrjedhin pasoja e përfitime... Më tej vazhdon: si ndikojmë ne te mjedisi e si ndikon ai mbi ne.

Për ta kuptuar konceptin bashkëveprim, mësuesi/ja në çdo moment fton nxënësit të përshkruajnë figurën 6 në tekst dhe të diskutojnë mbi format e bashkëveprimit.

Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup mbi: figurën 7 në tekst dhe ushtrimet 1-6 te rubrika “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimin. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 7 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore: I.5 Toka në sistemit diellor

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI (gjashtë)
Tema 1: Vendi dhe hapësira		Rezultati i të nxëniet të temës: Identifikon veçoritë kryesore të Tokës e sistemit diellor, të planetëve, asteroideve, kometave, satelitëve dhe hënës si trup qiellor e satelit natyror i Tokës. Vlerëson rëndësinë e Diellit për dukuritë gjeografike.	
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4; I.6; I.7; II 6; II.7; II.8; III.2; III.5; III.7; IV.2; IV.5; VI.6; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: I.5 Toka në sistemit diellor			
Fjalët kyçe: univers, galaktikë, sistem diellor, Toka në sistemin diellor, planet			

Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore:

- përshkruan se ku ndodhet Toka në raport me Diellin dhe me planetët e tjerë të sistemit diellor;
- krahason përmasat e Tokës me ato të Diellit dhe të planetëve të tjerë të sistemit diellor;
- përcakton se çfarë vendi zë sistemi ynë diellor në galaktikën “Rruga e Qumështit”.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Gjeografia kl. 6, informacione të hulumtuara në internet, tekste/burime të tjera informacioni të sugjeruara nga mësuesi/ja, mjete të tjera ndihmëse.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat natyrore, TIK, jeta dhe puna

Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:**a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme- Organizohet Brainstorming-u**

Për të realizuar këtë, mësuesi/ja bazohet në kuriozitetin e vazhdueshëm që karakterizon nxënësit, në të përditshmen e tyre dhe në dëshirën e vazhdueshme të tyre për të mësuar rreth botës që i rrethon. Përdor pyetje të cilat ata mund t'i kenë bërë në jetën e përditshme... P.sh. mësimi fillon me pyetjen: Çfarë vendi zë Toka jonë në hapësirën që na rrethon?

b) Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim**Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.5.

Veprimet në situatë**Hapi I: Rrjeti i diskutimit**

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.5 në tekst: *Diskutojmë: “Hapësira që na rrethon, është e pafundme. Njeriu kërkon vazhdimisht ta njohë sa më shumë atë. Por, çfarë vendi zë Toka jonë në këtë hapësirë?”*

Nxënësit diskutojnë, tregojnë, përshkruajnë...

Mësuesi/ja vazhdon: E gjithë hapësira e pafundme rreth nesh quhet *univers* ose *gjithësi*. Ajo është krijuar si rezultat i një shpërthimi të madh (Big-Beng), gjatë të cilit, lënda dhe energjia u shpërndanë në drejtime të ndryshme... I orienton nxënësit të përqendrohen te figura 1 dhe të diskutojnë mbi Big- Beng-un. Mësuesi/ja u drejtohet përsëri nxënësve me pyetjen që nxit *brainstorming*-un: Po Toka dhe sistemi diellor si u formuan?

Mësuesi/ja pret përgjigjet prej nxënësve...

Mësuesi/ja vazhdon: Rreth 4.6 miliardë vjet më parë, rreth Diellit u formua sistemi ynë diellor. Sistemi diellor përbëhet nga Dielli (që ndodhet në qendër) dhe nga planetët, satelitët, asteroidet, kometat dhe meteorët, të cilët rrotullohen rreth tij. Toka ku ne jetojmë, është një nga tetë planetët e sistemit diellor. Ajo ndodhet rreth 150 milionë km larg nga Dielli dhe ka vetëm një satelit natyror, Hënën, e cila qarkullon rreth Tokës dhe së bashku me Tokën, edhe rreth Diellit...

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja orienton nxënësit të vëzhgojnë tekstin dhe drejton pyetjet Bazuar në figurat 2 dhe 3: a) përshkruaj se ku ndodhet Toka në raport me Diellin dhe me planetët e tjerë të sistemit diellor; b) krahaso përmasat e Tokës me ato të Diellit dhe të planetëve të tjerë të sistemit diellor; c) përcakto se çfarë vendi zë sistemi ynë diellor në galaktikën “Rruga e Qumështit”.

Pasi lexojnë tekstin dhe analizojnë figurat 2 dhe 3 të tekstit, nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Në vazhdim, nxënësit punojnë dhe diskutojnë ushtrimet e dhëna në tekst, në rubrikën “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve
Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimimit. Përdoret: - Vlerësim me gojë - Vlerësim i punës në grup - Vlerësim i detyrës së shtëpisë - Vlerësim i lojës me role - Vetëvlerësim
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit për zgjidhjen e detyrave të shtëpisë në rubrikën: “Radha jote”.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Njësia mësimore: I.6: Forma dhe përmasat e Tokës

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: III	Klasa: VI (gjashtë)
Tema 1: Vendi dhe hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.4; I.6; I.7; II 6; II.7; II.8; III.2; III.5; III.7; IV.2; IV.5; VI.6; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Forma dhe përmasat e tokës			
Fjalët kyçe: forma e Tokës, përmasa e Tokës			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: - evidenton format me të cilat paraqitet grafikisht Toka; - analizon rëndësinë e formës dhe të masës së Tokës; - analizon pozicionin e Tokës në sistemin diellor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjeografia kl. 6, fletore pune, informacione të hulumtuara në internet, tekste/burime të tjera informacioni të sugjeruara nga mësuesi/ja, mjete të tjera ndihmëse			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Brainstorming Mësuesi/ja fton nxënësit të punojnë me tekstin duke u fokusuar si fillim në rubrikën “Diskutojmë”. Njeriu është përpjekur të zbulojë pamjen e vërtetë të Tokës shumë kohë më përpara se të dërgoheshin kamerat në hapësirë. Qe Aristoteli, dijetari grek, i cili në shekullin III p.e.s. dha i pari idenë e rumbullakësisë së Tokës, me anë të llogaritjeve që bëri. Kohë më vonë, formën reale të këtij planeti e sollën imazhet e dërguara nga satelitët artificialë. • Ju mund të keni lexuar kuriozitete të ndryshme dhe mund të keni parë fotografi të pamjes së Tokës. Si e përfytyroni formën e saj.			

Ndër kohë, mësuesi/ja u tregon nxënësve globin, duke i ftuar që me ndihmën e imagjinatës të përfytyrojnë rrotullimin e tokës rreth vetes, për t'i dhënë përgjigje pyetjeve rreth formës së saj. Nxënësit nxiten të thellohen në imagjinatën e tyre dhe gjithçka imagjinojnë t'ia përshkruajnë shokut/shoqes së bankës.

b) Ndërtimi i njohurive të reja: Bashkëbisedim

Në bashkëbisedim me nxënësit, trajtohen çështjet:

1. Cila është forma e Tokës?

Duke i orientuar nxënësit të përqendrohen te figura 1, mësuesi/ja vazhdon: Për qëllime studimi, forma e Tokës është konsideruar gjithmonë *sferike*, si një top me sipërfaqe të lëmuar, por, *forma reale* e saj është paksa më e ndërlikuar. Rrezja polare është më e shkurtër se ajo ekuatoriale, pra Toka është më e fryrë në Ekuator dhe pak e shtypur në pole, si një *elipsoid* ...

Nxënësit krahasojnë formën sferike, elipsoidin dhe gjeoidin me formën reale të Tokës.

2. Cilat janë provat mbi formën e Tokës?

Mësuesi/ja ndalet te provat mbi formën e Tokës: “I pari që vërtetoi se Toka ka formë sferike, ishte dijetari grek Pitagora (shek. IV p.e.s.). Ai dha provat e para mbi formën sferike të planetit tonë. Këto prova u plotësuan më vonë edhe nga Ptolemeu (shek. II e.s.), si dhe nga dijetarë të tjerë e lundërtarë të ndryshëm. Disa prej këtyre provave janë: 1. Përpara se Dielli të ngrihet në horizont, rrezet e tij ndriçojnë në fillim majat e maleve dhe ndërtesat e larta e më pas pjesët e ulëta. Kjo gjë shpjegohet vetëm me formën e mysët të Tokës...

3. Çfarë rëndësie ka forma e Tokës?

Për këtë, mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 4 dhe informacionin teorik mbi të dhe më pas të përshkruajnë rëndësinë e formës së Tokës.

4. Cilat janë përmasat e Tokës?

Për këtë, mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 5 dhe informacionin teorik mbi të dhe më pas të përshkruajnë rëndësinë e përmasave të Tokës, si dhe rëndësinë e madhësisë së saj.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritur: Punë në grupe dyshe

Nxënësit të punojnë në dyshe ushtrimet e rubrikës “Ushtrohem duke zbatuar” dhe “Zbatohet në praktikë”.

Në fletore ndërtohet në tabelë, një skemë përmbledhëse (hamer) të njohurive që u trajtuan së bashku me mësuesin/en.

Toka				
Vendi i saj në sistemin diellor (kur renditja fillon nga Dielli)	Rrezet e Tokës	Sipërfaqja	Vëllimi	Dendësia

Përfaqësues të dysheve të nxënësve prezantojnë zgjidhjen. Gjatë prezantimit të zgjidhjes kërkohet argumentimi i përgjigjes së ushtrimit. Nxënësit udhëzohen të kontrollojnë dhe vlerësojnë mënyrën dhe saktësinë e zgjidhjes së detyrave të shokut, duke i vendosur në fund të fletës simbole:

- * - plotësisht saktë
- + - pjesërisht saktë
- ? - pasaktë

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për zgjidhjen e detyrave të shtëpisë në rubrikën: “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**Njësia mësimore 1.7: Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet**

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon provat dhe pasojat e lëvizjes së Tokës rreth boshtit të vet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.6; I.8; II 6; III.5; III.7; IV.5; IV.7; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.7: Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet			
Fjalët kyçe: rrotullimi i Tokës rreth vetes, formimi i ditë-natës, shtypja në pole, shmangia e erërave, e masave ajrore dhe e rrymave oqeanike			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja identifikon provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj, përshkruan rrotullimin e Tokës rreth vetes, diferencon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna			
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për median, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit			
Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.7 në tekst.			
Diskutojmë: Përgjatë 24 orëve, vëmë re se dita dhe nata ia lënë vendin njëra-tjetrës në mënyrë të përsëritur. Dielli shfaqet në agim, në vazhdim e shohim që lëviz nëpër qiell derisa perëndon, dhe më pas vjen nata. Mëngjesin tjetër, dielli rishfaqet dhe çdo gjë përsëritet nga e para. Për rrjedhojë, duke iu përshtatur këtij ndryshimi të përhershëm, e gjithë bota e gjallë në planetin tonë krijon një regjim ditor të caktuar. Por, a e dini si formohet ditë-nata?”			
Nxënësit japin përgjigjet e tyre...			
Hapi II: Ndërtimi i njohurive të reja			
Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin figurën 1 dhe vazhdon të trajtojë informacionin e tekstit: Toka rrotullohet rreth boshtit të saj për 24 orë (ose saktësisht 23 orë e 56 minuta), nga perëndimi në lindje, në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të orës. Gjatë rrotullimit rreth vetes, Toka i ekspozon Diellit çdo pjesë të sipërfaqes së saj. Gjithmonë na duket sikur Dielli lëviz në raport me ne, ndërkohë që jemi ne që lëvizim bashkë me Tokën, rreth boshtit të saj...			
Mësuesi/ja nxit një <i>brainstorming</i> me pyetjen: Përshkruaj si ndryshon vendndodhja e Diellit (ose rruga që përshkon Dielli nga momenti i lindjes deri në perëndim) gjatë 24 orëve, në vendbanimin tënd.			
Nxënësit përshkruajnë figurën.			
Hapi III: Vëzhgo – Analizo – Diskuto			
Mësuesi/ja vazhdon: shihni figurën 2 të tekstit. A e dini se cilat janë pasojat që rrjedhin prej rrotullimit të Tokës rreth vetes?			

Pas përgjigjeve të tyre, ajo vazhdon: Provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth vetes, janë vetë pasojat që rrjedhin prej këtij rrotullimi...

Më pas, mësuesi/ja nxit një tjetër *brainstorming* me anë të situatës: Bazuar në figurën 2, përshkruaj drejtimet e shmangies së erërave/masave ajrore/rrymave oqeanike, gjatë lëvizjes së tyre nga një gjerësi gjeografike në tjetrën, në secilën hemisferë.

Nxënësit përshkruajnë.



Hapi IV: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1 dhe 2. Vlerësohen pasojat që rrjedhin nga rrotullimi i Tokës rreth vetes. Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1 dhe 2.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 3 dhe 4 te rubrika “Radha jote”. Në orën pasardhëse, nxënësit demonstrojnë zgjidhjet e tyre.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 1.8: Rrotullimi i Tokës rreth Diellit

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon rrjedhojat e lëvizjes së Tokës rreth Diellit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.8: Rrotullimi i Tokës rreth Diellit			
Fjalët kyçe: rrotullimi i Tokës rreth Diellit, formimi i stinëve, solstic, ekuinoks			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja përshkruan rrotullimin e Tokës rreth Diellit, diferencon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.8 në tekst - Diskutojmë: “Gjatë vitit, stinët i lënë vendin njëra-tjetrës. Duke qenë se i njohim karakteristikat e secilës stinë, planifikojmë edhe punët, pushimet apo mënyrën e të veshurit, për t’u përshtatur me to. Por, a e dini si formohen stinët?”

Nxënësit japin përgjigjet e tyre.

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja orienton nxënësit të shohin figurën 1 dhe i fton ta përshkruajnë atë.

Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e tekstit: Në 22 dhjetor, Toka i ekspozon Diellit më tepër Hemisferën Jugore, ndaj kjo datë për këtë hemisferë shënon ditën e solsticit veror, ndërsa për Hemisferën Veriore, ditën e solsticit dimëror. Për shkak të këtij pozicioni kundrejt Diellit, Hemisfera Jugore merr më tepër energji diellore dhe në të fillon vera astronomike. Dielli lind në juglindje dhe perëndon në jugperëndim... Ndërkohë, ai/ajo fton nxënësit ta përshkruajnë këtë me fjalët e tyre duke iu referuar figurës 2, për datën 22 dhjetor.

Mësuesi/ja vazhdon: Më 22 qershor, Toka i ekspozon Diellit më tepër Hemisferën Veriore. Për Hemisferën Veriore, kjo datë shënon ditën e solsticit veror, ndërsa për Hemisferën Jugore shënon ditën e solsticit dimëror. Hemisfera Veriore merr më tepër energji diellore dhe në të fillon vera astronomike. Dielli lind në verilindje dhe perëndon në veriperëndim. Rrezet diellore bien pingul në tropikun e Veriut...

Ndërkohë ajo fton nxënësit ta përshkruajnë këtë me fjalët e tyre duke iu referuar figurës 12, për datën 22 qershor.

Mësuesi/ja vazhdon: Më 21 mars dhe 23 shtator (data ekuinoksi), rrezet diellore bien pingul në Ekuator, kështu që kufiri ndarës midis ditës e natës kalon nëpër të dyja polet...

Ndërkohë, ai/ajo fton nxënësit ta përshkruajnë këtë me fjalët e tyre duke iu referuar figurës 2, për datën 21 mars dhe 23 shtator.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit demonstrojnë ushtrimin 3: Me anë të një topi (që përfaqëson Tokën) dhe të një elektriku dore (që përfaqëson Diellin), vepro si në figurën përbri. Trego se si ndriçohet Toka në stinë të ndryshme. Analizo se çfarë ndodh në secilën prej hemisferave të Tokës më: 22 Qershor, 22 Dhjetor 21 Mars dhe 23 Shtator.

Nxënësit diskutojnë rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë praktike 1.1 Toka në sistemin diellor

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- ndërtton dhe përdor modele që tregojnë: a) vendin e Tokës në sistemin diellor; b) pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes;
- c) pozicionin e Tokës kundrejt Diellit në ditët e ekuinokseve dhe të solsticeve;
- kërkon me objektivitet të dhëna dhe informacion për të qenë më i/e saktë në shpjegimet e tij/saj mbi formën dhe përmasat e Tokës;
- paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e veta;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale;
- demonstroi bashkëpunim gjatë punës në grup për përgatitjen e modeleve.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45 minuta për paraqitjen e punës në klasë.

Materialet burimore: Të dhëna të siguruar nga teksti mësimor, interneti a enciklopedi të ndryshme, si dhe materiale të tjera të rekomanduara nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: Skeda me informacione të shkruara, fotografi, plastelinë/topa llastiku/ tullumbace/topa letre, karton/kuti kartoni/dërrasë/kuti druri, tela/spango, lapsa me ngjyra, gjilpëra me kokë.

Metodologjia që do të përdoret: Punë në grupe (ndërtim maketi, paraqitje, diskutim)

Puna përgatitore: Rikujto njohuritë e marra mbi: a) sistemin diellor dhe vendin e Tokës në hapësirë; b) rrotullimin e Tokës

rreth vetes dhe rreth Diellit.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

- Me objektet e përgatitura në shtëpi (Dielli, Hëna, planetë, asteroide etj.) ndërtohet në klasë maketi që paraqet sistemin diellor. Orbitat dhe boshtet e rrotullimit mund të jenë prej teli.
- Gjatë ndërtimit të maketit jepen të dhënat e duhura mbi: a) përmasat, formën e Tokës dhe rëndësinë që kanë ato për planetin tonë; b) mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe pasojat që rrjedhin prej tij;
- c) mënyrën e rrotullimit të Tokës rreth Diellit dhe pasojat që vijnë prej tij (në ditët e ekuinokseve dhe solsticeve). Është mirë që disa prej këtyre të dhënave të jenë të shkruara edhe në etiketa me ngjyra (të përgatitura më parë), të cilat gjatë paraqitjes mund të vendosen dhe të ngjiten në platformën e maketit ose mbi trupat e sistemit diellor.
- Diskutohet midis grupeve (vlerësohen punët e njëri-tjetrit).
- Bëhet vlerësimi i nxënësve.

Përsëritje 1 Toka në sistemin diellor

1. E vërtetë apo e gabuar?

- Toka bën pjesë në grupin e planetëve të jashtëm, që kanë përmasa të mëdha. VG
- Shtypja e Tokës në pole shkaktohet prej rrotullimit të Tokës rreth Diellit. VG
- 23 shtatori shënon ditën e ekuinoksit vjeshtor për Hemisferën Veriore. VG
- Toka është një nga tetë planetët e sistemit diellor. VG
- Toka rrotullohet një herë në vit rreth Diellit. VG
- Dielli është qendra e gjithësisë. VG
- Toka ka disa satelitë natyrorë. VG

2. a. Në tabelën e figurës 1, **plotëso** emërtimin e secilit planet sipas numrave përkatës.



b. **Përshkruaj** vendin që zë Toka në sistemin diellor, në gjithësi, si dhe në galaktikën “Rruga e Qumështit”.

3. Diskuto mbi pyetjet:

- a. Cila është forma e Tokës?
- b. Çfarë pasojash rrjedhin nga forma që ka planeti ynë?
- c. Cilat janë përmasat e planetit tonë?
- d. Përse kanë rëndësi përmasat e Tokës?
- e. Si bëhet rrotullimi i Tokës rreth vetes dhe çfarë pasojash rrjedhin ?
- f. Si bëhet rrotullimi i Tokës rreth Diellit?
- g. Cilat janë pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit?

4. **Përcakto** se në cilën periudhë të vitit ndodhet Toka në figurën 2 (a, b dhe c).

Analizo se çfarë ndodh në secilën prej hemisferave të Tokës, për shkak të ndryshimit të pozicionit të saj kundrejt Diellit.



Njësia mësimore 1.9: Koordinatat gjeografike

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon ndërtimin e sistemit të koordinatave gjeografike (rrjetin e paraleleve dhe meridianëve, gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike). Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.6; I.8; II 6; III.5; III.7; IV.5; IV.7; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.9: Koordinatat gjeografike			
Fjalët kyçe: paralele, meridianë, gjatësi gjeografike, gjerësi gjeografike			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja dallon dhe gjen në glob dhe në hartë: gjerësinë dhe gjatësinë gjeografike të vendeve. Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.9 në tekst - Diskutojmë: “Risjellim në vëmendje njohuritë që kemi marrë mbi vendndodhjen absolute të vendeve. Çfarë kuptoni me vendndodhje absolute? Cila është vendndodhja absolute e Prishtinës?” Nxënësit japin përgjigjet e tyre.			
b. <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i> Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Duke marrë edhe si shembull figurën 1 të tekstit, mësuesi/ja të trajton së bashku me nxënësit: kuptimin mbi paralelet dhe meridianët: Të gjitha vijat horizontale që qëndrojnë paralel me Ekuatorin, quhen <i>paralele</i> . Paraleli më i gjatë është Ekuatori, ndërsa gjatësia e gjithë paraleleve të tjera vjen duke u zvogëluar sa më shumë u afrohemi poleve... Vijat imagjinare që kalojnë nëpër të dyja polet dhe qëndrojnë pingul me paralelet quhen <i>meridiane</i> . Të gjitha meridianet kanë gjatësi të njëjtë... Duke marrë edhe si shembull figurën 2 të tekstit, mësuesi/ja të trajton së bashku me nxënësit: kuptimin mbi koordinatat gjeografike të çdo vendi: Çdo vend ka një gjerësi dhe gjatësi gjeografike të përcaktuara që është e pandryshuar në çdo hartë e glob. Gjerësia gjeografike është... Gjatësia gjeografike është... Fton nxënësit të provojnë gjetjen e koordinatave gjeografike sipas modelit të paraqitur te shembulli i tekstit. Nxënësit japin përgjigjet e tyre.			
Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Bazuar në rubrikën “Radha jote” ftohen nxënësit të ushtrimet 1, 2, 3, 5 të rubrikës dhe të diskutojnë mbi to. Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup rezultatet/gjetjet e tyre...			

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 dhe 6 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë praktike 1.2 Përcaktimi i vendndodhjes absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike

Rezultatet e të nxënës

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë duke përdorur koordinatat gjeografike të tij;
- dëgjon me vëmendje komentet dhe zgjidhjet e shokëve dhe shoqeve e diskuton meta;
- shpjegon qartë dhe saktë, me gojë dhe me shkrim, kuptimin e termave: paralele, meridiane, gjatësi e gjerësi gjeografike dhe hemisferë.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45'

Materialet burimore: Të dhëna të siguruar nga teksti mësimor, interneti a enciklopedi të ndryshme, si dhe materiale të tjera të rekomanduara nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: glob, harta e botës, harta e Evropës, harta e Kosovës, teksti i *Gjeografisë 6*, laps, fletore e punës praktike.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe, punë individuale.

Puna përgatitore:

Risill në kujtesë kuptimin: paralel, meridian, gjatësi dhe gjerësi gjeografike.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike

- Shpjegohet kuptimi i koncepteve të mëposhtme dhe përcaktohet përse shërbejnë ato.

Paralele _____

Meridiane _____

Gjerësi gjeografike _____

Gjatësi gjeografike _____

- Zgjidhen ushtrimet emëposhtme.

a) Në globin e figurës 1 dhe në hartën e figurës 2, gjej dhe emërto Ekuatorin, Meridianin e Grinuit, Meridianin 180° dhe polet e Tokës.

b) Bazuar në hartën e botës, të ekspozuar në klasë, përcakto koordinatat gjeografike dhe se në cilën hemisferë ndodhen ShBA-ja, Kanada, Argjentina, Norvegjia, Australia, Algjeria, India dhe Malajzia.

c) Në hartën e figurës 2, gjenden dhe plotësohen vendet bosh me koordinatat gjeografike të Britanisë së Madhe, të Gjermanisë, të Polonisë, të Ukrainës, të Spanjës, të Finlandës, të Shqipërisë, të Francës, të Portugalisë dhe të Irlandës. Shpjegohet çfarë tregon secila prej koordinatave gjeografike të gjetura.

Britania e Madhe _____ Finlanda _____

Gjermania _____ Shqipëria _____

Polonia _____ Franca _____

Ukraina _____ Portugalia _____

Spanja _____ Irlanda _____

Njësia mësimore 1.10: Koha lokale dhe koha zonale. Orientimi në terren

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Përcakton kohën lokale dhe zonale në vende të ndryshme në bazë të gjatësisë së tyre gjeografike. Përshkruan mënyrat e orientimit në natyrë (me anë të diellit, orës, myshqeve, yllit polar, busullës, objekteve fetare, etj.).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.6; I.8; II 6; III.5; III.7; IV.5; IV.7; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.10: Koha lokale dhe koha zonale. Orientimi në terren			
Fjalët kyçe: koha lokale, koha zonale, metodat e orientimit në natyrë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja orientohe dhe përcakton: kohën lokale dhe zonale të vendeve të ndryshme në glob. Orientohet me mënyra të ndryshme në terren.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit I.10 në tekst - Diskutojmë: “Nëse do t’i telefonojmë një të afërmi që ndodhet në një shtet tjetër, apo nëse duam të udhëtojmë jashtë vendit, një nga gjërat që duhet të dimë është edhe ndryshimi i orës midis dy vendeve. Si mund ta llogaritim atë?” Nxënësit japin përgjigjet e tyre.			
<i>b. Ndërtimi i njohurive të reja</i> Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Në vazhdim, mësuesi/ja të trajton së bashku me nxënësit: kuptimin mbi kohën lokale dhe zonale. Ai u kujton nxënësve të rikujtojnë se çfarë kanë mësuar më parë: Në vendet që ndodhen përgjatë një meridiani, ku rrezatimi diellor bie në mënyrë të drejtpërdrejtë, është mesditë (ora 12:00), ndërsa në ato që ndodhen 180 gradë larg tij është mesnatë (ora 24:00) Ndërkohë, në vendet që ndodhen në perëndim të këtij meridiani është paradite, ndërsa në ato që gjenden në lindje të tij është pasdite. Kështu mësuesi vazhdon: Gjatësia gjeografike shërben për të përcaktuar jo vetëm vendndodhjen absolute të vendeve në Tokë, por edhe kohën zonale të tyre. Vendet me gjatësi të ndryshme gjeografike kanë edhe kohë lokale të ndryshme. Kjo lidhet me ndryshimin e pozicionit të Tokës kundrejt Diellit gjatë rrotullimit të saj të plotë (24-orësh) rreth vetes (nga perëndimi në lindje). Vendet që ndodhen në të njëjtin meridian kanë kohë lokale të njëjtë, ndërsa në raport me vendet që gjenden në meridianë të tjera, kohë lokale është e ndryshme. Mësuesi/ja pyet: A mund të bashkëveprojnë vendet midis tyre nëse zbatojnë kohën lokale të tyre? Fton nxënësit të argumentojnë mendimin e tyre. Nxënësit japin përgjigjet e tyre. Duke nxitur nxënësit të mbështeten në figurën 1, trajton së bashku me ta kohën zonale. Mësuesi/ja vazhdon: Për zbutur ndryshimet e mëdha midis vendeve lidhur me kohën lokale, hartografët kanë ndërtuar kohën			

zonale ose kohën e brezit prej 15°. Toka, në mënyrë imagjinare, është ndarë në 24 breza. Secili brez ka si kohë zonale kohën lokale të meridianit që kalon në mesin e tij...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë në tekst mënyrat e orientimit në terren dhe të diskutojnë mbi to. Nxënësit diskutojnë, japin shembuj të ndryshëm...

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup rezultatet/gjetjet e tyre...

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 1-3 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë praktike 1.3 Përcaktimi i kohës zonale të vendeve me gjatësi të ndryshme gjeografike

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përshkruan rëndësinë që ka gjetja e koordinatave gjeografike të një vendi në përcaktimin e kohës zonale të tij;
- gjen dhe shpjegon përmes përllogaritjeve, ndryshimin e kohës zonale në vende me gjatësi të ndryshme gjeografike;
- tregon bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45 minuta, në klasë.

Materialet burimore: Të dhëna të siguruar nga teksti mësimor, interneti a enciklopedi të ndryshme, si dhe materiale të tjera të rekomanduara nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: glob, harta e botës, harta e Evropës, teksti i *Gjeografisë* 6, laps, fletore e punës praktike.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe, punë individuale.

Puna përgatitore

- Bazuar në njohuritë e marra më parë, përcaktohet kuptimi i termave: kohë lokale, kohë zonale, gjatësi gjeografike, gjerësi gjeografike.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike

• **Mësuesi/ja punon së bashku me nxënësit/et shembujt e mëposhtëm (të zgjidhur).**

Shembulli 1

Sa është gjatësia gjeografike e Alepos (Siri) me kohë lokale 13h 30', kur në Prishtinë me gjatësi gjeografike lindore $21^{\circ}10'$, koha lokale është 12h 30'?

Zgjidhje

Hapi i parë

Përcaktohet si qëndrojnë kundrejt njëri-tjetrit të dyja vendet. Në hartë shihet se Alepoja ndodhet më në lindje të Prishtinës dhe se ka gjatësi gjeografike lindore (sepse ndodhet në lindje të Grinuiçit).

Hapi i dytë

Gjendet diferenca në kohë ndërmjet dy vendeve:
 $13h\ 30' - 12h\ 30' = 1h$ është distanca në kohë ndërmjet dy vendeve.

Hapi i tretë

Diferenca në kohë midis dy vendeve kthehet në distancë në gradë, duke ndjekur arsyetimin e mëposhtëm:

Gjatë 24 orëve Toka përshkon 360° , ose gjatë 1 ore ($60'$) Toka përshkon 15° , ose:

1° Toka e përshkon për $4'$.

Po gjatë 1h (1 ore) sa gradë përshkon ajo?

Atëherë: $\frac{1h\ (ose\ 60') \times 1^{\circ}}{4'} = 15^{\circ}$ është distanca në

gradë ndërmjet dy vendeve.

Pra, Alepoja ndodhet $16^{\circ}25'$ më në lindje të Tiranës.

Hapi i katërt

Gjendet gjatësia gjeografike e Alepos (duke i shtuar gjatësisë gjeografike të Prishtinës, distancën ndërmjet saj dhe Alepos):

$21^{\circ}10' + 15^{\circ} = 36^{\circ}10'$ është gjatësia gjeografike lindore e Alepos.

Shembulli 2

Sa është koha lokale në Karakas (Venezuelë) me gjatësi gjeografike perëndimore $66^{\circ}54'$, kur në Prishtinë me gjatësi gjeografike lindore $21^{\circ}10'$, koha lokale është 8h 30'?

Hapi i parë

Përcaktohet si qëndrojnë kundrejt njëri-tjetrit të dyja vendet. Në hartë shihet se Karakasi ndodhet më në perëndim të Prishtinës dhe se ka gjatësi gjeografike perëndimore (sepse ndodhet në perëndim të Grinuiçit).

Hapi i dytë

Gjendet distanca në gradë ndërmjet dy vendeve:

$66^{\circ}54' + 21^{\circ}10' = 87^{\circ}64'$ ose $88^{\circ}4'$. Kjo është distanca në gradë ndërmjet dy vendeve (veprimi në këtë rast është mbledhje, sepse Karakasi ndodhet $66^{\circ}54'$ në perëndim të Grinuiçit, ndërsa Prishtina $21^{\circ}10'$ në lindje të Grinuiçit, pra $88^{\circ}4'$ larg njëri-tjetrit.

Hapi i tretë

Distanca në gradë ndërmjet dy vendeve kthehet në ndryshim në

kohë ndërmjet tyre, duke ndjekur arsyetimin e mëposhtëm:

Gjatë 24 orëve Toka përshkon 360° , ose gjatë 1 ore ($60'$) Toka përshkon 15° , ose:

1° Toka e përshkon për $4'$.

Po $88^{\circ}4'$ për sa kohë i përshkon ajo?

$$\frac{88^{\circ}4' \times 4'}{1^{\circ}} = \frac{88,07^{\circ} \times 4'}{1^{\circ}} = 352,28' \text{ ose } 5\text{h } 52'$$
 është ndryshimi në kohë ndërmjet dy vendeve.

Pra, Karakasi ndodhet 5h 52' larg, në perëndim të Prishtinës (ose më mbrapa në kohë se Prishtina).

Hapi i katërt

Gjendet koha lokale e Karakasit (duke i zbritur kohës lokale të Prishtinës ndryshimin në kohë ndërmjet saj dhe

Karakasit):

$8\text{h } 30' - 5\text{h } 52' = 2\text{h } 38'$ është koha lokale në Karakas.

• Nxënësit/et zgjidhin në klasë ushtrimet e mëposhtme.

1. Sa është gjatësia gjeografike e Athinës (Greqi) me kohë lokale 18h 30', kur në Prishtinë me gjatësi gjeografike lindore $21^{\circ}10'$, koha lokale është 17h 20'?
2. Sa është gjatësia gjeografike e Helsinkit (Finlandë) me kohë lokale 4h 20', kur në Prishtinë me gjatësi gjeografike lindore $21^{\circ}10'$, koha lokale është 3h 10'?
3. Sa është koha lokale në Bruksel (Belgjikë) me gjatësi gjeografike 05° , kur në Prishtinë me gjatësi gjeografike lindore $21^{\circ}10'$, koha lokale është 14h?
4. Sa është koha lokale në Kiev (Ukrainë) me gjatësi gjeografike lindore $30^{\circ} 31'$, kur në Prishtinë me gjatësi gjeografike lindore $21^{\circ}10'$, koha lokale është 9h 40'?

• Bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimi i nxënësve.

Njësia mësimore 1.11: Paraqitja grafike e Tokës

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Krahason hartën dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre (elementet matematike dhe gjeografike të hartës).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.11: Paraqitja grafike e Tokës			
Fjalët kyçe: globi, harta, plani			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja krahason globin, hartën dhe planin, duke treguar të përbashkëtat dhe dallimet midis tyre.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartën politike të Evropës, hartën politiko-administrative të Italisë, të Romës, planin e Universitetit La Sapienza (të printuar nga interneti). Në mungesë të ndonjëres prej tyre, i orienton nxënësit të shohin figurat 1, 2, 3, 4, 5 në tekst, dhe përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi I.11 në tekst - Diskutojmë: “Vëllai ose motra jote, student/e në degën e Drejtësisë, do të marrë pjesë në një seminar të organizuar në Universitetin La Sapienza, Romë. Për këtë, i duhet informacion: për vendndodhjen e universitetit, për distancën e universitetit nga objekte të njohura, për rrugët që të çojnë në këtë universitet, për planimetrinë e tij etj. Për të marrë informacionin e nevojshëm, fillimisht motra ose vëllai duhet t’i drejtohet globit, hartës së Italisë e të Romës dhe planit të zonës ku ndodhet universiteti, që janë tri format e paraqitjes grafike të sipërfaqes së Tokës. Si mendoni, çfarë të dhënash mund të gjejë në secilën prej tyre?” Në vazhdim, mësuesi/ja, fton nxënësit të diskutojnë se çfarë informacioni i ofron secila prej tyre. Nxënësit japin përgjigjet e tyre.			
b. <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja thekson edhe njëherë një detaj të paraqitur në situatën e vendosur në fillim të mësimi: Pse duhet ti drejtohesh këtyre të triave? Sepse globi, harta dhe plani janë tre format e paraqitjes grafike të sipërfaqes së Tokës. Më tej vazhdon dhe sqaron konceptin mbi secilën prej tyre (ç’është globi, harta dhe plani), duke i orientuar vazhdimisht nxënësit që atë që trajtohet ta shohë konkretisht në globin dhe në hartat e ekspozuara (ose në figurat e tekstit): Globi është paraqitja në sferë e sipërfaqes së Tokës me përmasa të zvogëluara... Hartë quhet paraqitja në sipërfaqe të rrafshët e gjithë sipërfaqes së Tokës ose e një pjese të saj, me përmasa të zvogëluara... Plan quhet paraqitja në rrafsh pa shformime e një sipërfaqeje të vogël të Tokës me përmasa të zvogëluara... Ftohen nxënësit të gjejnë situata të ngjashme. I lihet si detyrë të gjejnë se çfarë të përbashkëta dhe çfarë ndryshime vunë re midis globit, hartës dhe planit. Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup rezultatet/gjetjet e tyre...			

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 1-3 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë praktike 1.4 Ndryshimi midis globit, hartës dhe planit

Rezultatet e të nxënës

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përzgjedh informacionin nga harta të ndryshme (harta dhe plane të gjetura në Internet), të cilat i përdor për realizimin e detyrave;
- ndërton një “glob” që përshkohet nga rrjeta gjeografike dhe përmes tij, argumenton shkakun pse në harta ndodhin deformime të formave të sipërfaqes së Tokës;
- analizon, vlerëson dhe menaxhon informacionin e marrë përmes përdorimit të TIK-ut;
- krahason dhe diskuton në lidhje me ngjashmëritë dhe ndryshimet midis hartës, planit dhe globit.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45', në klasë.

Materialet burimore: Të dhëna të siguruar nga teksti mësimor, interneti a enciklopedi të ndryshme, si dhe materiale të tjera të rekomanduara nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: globi, harta e botës, harta fizike dhe politike të shteteve të ndryshme, plane të qyteteve që i përkasin shteteve që keni përzgjedhur sipas dëshirës, një top llastiku, një lapustil dhe gërshërë.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe, punë individuale.

Puna përgatitore

- Bazuar në njohuritë e marra më parë, përcaktohet kuptimi i termave: glob, hartë dhe plan.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike

Veprimtaria 1

- Hulumto në internet, gjej, printo dhe sill në klasë: harta fizike ose politike të vendeve të ndryshme dhe plane të kryeqyteteve (ose të qyteteve që dëshiron të njohësh apo vizitosh). Përveç tyre, paraqit në klasë globin, hartën e botës dhe harta të kontinenteve.
- Përzgjedh shtetin/kryeqytetin/qytetin për të cilin do të grumbullosh informacionin që të nevojitet dhe përshkruaj se çfarë të ofroi globi, harta dhe plani.
- Diskuto se çfarë të përbashkëtash dhe ndryshimesh dallon midis globit, hartës dhe planit.

Veprimtaria 2

- Mbi një top të vogël llastiku, cakto dy pika që ndodhen 180° larg nga njëra-tjetra.
- Vertikalisht, vizato disa rrathë që kalojnë (priten) në të dyja pikat e përcaktuara në fillim.
- Bëj disa vija të tjera pingul me ato që vizatove (do të formohet një rreth i madh dhe shumë të tjerë paralel me atë, të cilët zvogëlohen duke iu afruar dy pikave të përcaktuara në fillim). Prite topin në disa pjesë përgjatë vijave vertikale, që të kesh mundësi ta “shtrish” sipërfaqen e tij mbi tavolinë.
- Diskuto në klasë: A është e mundur që e gjithë sipërfaqja e topit të shtrihet në sipërfaqen e sheshtë të tavolinës, pa pësuar deformime? Pse?
- Përshkruaj se çfarë drejtimesh morën vijat horizontale dhe ato vertikale që vizatove. Argumento pse është e vështirë ta paraqesim të gjithë sipërfaqen sferike të Tokës në një sipërfaqe të rrafshët.

Njësia mësimore 1.12: Përmbajtja e hartës. Llojet e hartave

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënësve të temës: Përshkruan përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.6; I.8; II 6; III.5; III.7; IV.5; IV.7; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.12: Përmbajtja e hartës. Llojet e hartave			
Fjalët kyçe: elementet e hartës, llojet e hartave			
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: Nxënësi/ja dallon elementet që përmbajnë hartat e ndryshme gjeografike dhe vlerëson përdorimin e hartave në jetën e përditshme. Dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike dhe përdorimet e tyre. Përdor TIK-un për gjetjen e hartave të ndryshme në rrugë elektronike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
b)			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit			
Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartat politike të botës/Evropës/Kosovës, hartat fiziko-gjeografike të botës/Evropës/Kosovës. Fton nxënësit të shohin figurat 1a, 1b në tekst dhe shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 1.12 në tekst – Diskutojmë: “Në hartën fiziko-gjeografike (figura 1/a) dhe në hartën politike të botës (figura 1/b) paraqiten disa prej karakteristikave të planetit tonë. Po të krahasojmë përmbajtjen e të dyjave, shohim se mes tyre ka ngjashmëri dhe ndryshime. Kjo sepse përmbajtja e secilës hartë varet nga qëllimi për të cilin është përgatitur. Çfarë dallimesh e ngjashmërisht vërejmë?” Nxënësit të diskutojnë se çfarë informacioni i ofron secila prej tyre...			
b. Ndërtimi i njohurive të reja			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto			
Mësuesi/ja vazhdon: gjithë informacioni që përmbajnë hartat e mësipërme, apo çdo lloj harte tjetër, paraqitet me anë të elementeve të saj. Gjatë trajtimit të tyre, mësuesi/ja fton nxënësit të shohin dhe të përshkruajnë përmbajtjen e figurës 2 në tekst për të kuptuar se çfarë janë elementet matematikore dhe ato gjeografike të hartave. Ftohen nxënësit në situata të ngjashme përmes hartave të ekspozuara në klasë. Gjejnë dhe përshkruajnë përmbajtjen e tyre (elementet matematikore dhe gjeografike) dhe vlerësojnë përdorimin e hartave. Së bashku me nxënësit, mësuesi/ja vlerëson se për çfarë shërbejnë hartat. Duke përdorur hartat e ekspozuara në klasë dhe skemën e figurës 3, mësuesi/ja vazhdon të evidentojë së bashku me nxënësit, llojet e hartave sipas përmbajtjes. Bazuar në to, nxënësit diskutojnë... krahasojnë... Orientohen përsëri nxënësit të krahasojnë midis tyre elementet që përdoren për të paraqitur relievin në hartat 1a e 1b dhe të përcaktojnë ndryshimin midis tyre. Bazuar në to, nxënësit diskutojnë... krahasojnë...			

<p>Mësuesi/ja vazhdon: Çfarë elementesh përmbajnë hartat e ekspozuara? Me çfarë simbolesh paraqiten? A e dini ju se çfarë janë simbolet? Vazhdon të përfshijë në diskutim nxënësit, duke i orientuar ata të përshkruajnë përmbajtjen e hartave dhe legjendën e tyre... Në vazhdim orientohen nxënësit të veçojnë shenjat konvencionale të hartës topografike dhe të ndërtojnë një skemë përmbledhëse (hamer) me llojet e hartave.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup</p> <p>Lihet detyrë ushtrimi 1. Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup...</p>
<p>Vlerësimi i nxënësve</p> <p>Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë - Vlerësim i punës në grup - Vlerësim i detyrës së shtëpisë - Vlerësim i lojës me role - Vetëvlerësim
<p>Detyrat dhe puna e pavarur</p> <p>Ushtrimi 2 të rubrika “Radha jote”.</p>
<p>Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore</p> <p>Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.</p>

Njësia mësimore 1.13: Shkalla e hartës

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Vendi dhe Hapësira		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan përmbajtjen e hartës-elementet gjeografike të hartës, metodat e paraqitjes së relievit në hartë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.2; I.6; I.8; II 6; III.5; III.7; IV.5; IV.7; VI.6;			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore I.13: Shkalla e hartës			
Fjalët kyçe: shkallë numerike, shkallë grafike, legjenda e hartës, simbole			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja gjen në hartë dhe përdor shkallën numerike dhe grafike (lineare) të saj për t'u orientuar në terren me distancat reale.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimit për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja ekspozon në klasë globin, hartat e ndryshme të botës/Evropës/Shqipërisë/Kosovës. Fton nxënësit të shohin figurën 1 në tekst dhe shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimi 2.13 (në tekst) – “Diskutojmë: Në hartat e figurës 1/a deri në atë 1/d, informacioni për objektet e ndodhura në bllokun			

numër 2 të banesave rritet. Përshkruaj se çfarë objektesh dallon në bllokun numër 2 të banesave në secilën prej hartave të figurës 1. Cila mund të jetë arsyeja e rritjes së informacionit mbi objektet e ndodhura në bllokun numër 2”.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Duke përdorur hartat e ekspozuara në klasë dhe hartën e figurës 2, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë së bashku me nxënësit: kuptimin mbi shkallën e hartës dhe mënyrën e paraqitjes së saj në hartë.

Orientohen nxënësit se si të punojnë me shkallën e zvogëlimit në hartë, kjo edhe duke u bazuar tek figurat 1 dhe 2. Bazuar në to, nxënësit diskutojnë... krahasojnë...

Mësuesi/ja vazhdon: Çfarë elementesh përmbajnë hartat e ekspozuara? Me çfarë simbole paraqiten? Dini ju ç’janë simbolet? Orienton nxënësit në lexim të strukturuar të përmbajtjes së tekstit. Në vazhdim përfshin nxënësit në diskutim, duke i orientuar ata të përshkruajnë përmbajtjen e hartave dhe legjendën e tyre... Për këtë bazohen edhe në figurën 3.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Bazuar në rubrikën “Radha jote” nxënësit ftohen të ushtrohen me ushtrimet 1-3 të saj dhe të diskutojnë mbi to.

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup...

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë praktike 1.5: Si të orientohe mi me shkallën e hartave të ndryshme

Rezultatet e të nxën it

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- llogarit dhe orientohe me shkallën e zvogëlimit në harta të ndryshme;
- mat distanca në vijë ajrore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme dhe orientohe me distancat reale midis zonave të ndryshme në terren;
- përcakton vetë një itinerar udhëtimi, mat distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme dhe orientohe me distancat reale midis vendeve të cilat mund t'i vizitojë gjatë udhëtimeve;
- diskuton me shokët dhe shoqet për gjetjet e tij.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45 minuta, në klasë.

Materialet burimore: Të dhëna të siguruara nga teksti mësimor, interneti a enciklopedi të ndryshme, si dhe materiale të tjera të rekomanduara nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: harta të ndryshme fiziko-gjeografike, topografike, laps, kompas, vizore, fije peri, fletë formati A4.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe (ndërtim maketi, paraqitje, diskutim).

Puna përgatitore:

Rikujto njohuritë e marra: a) Çfarë është shkalla numerike? Po shkalla grafike? b) Si veprohet me shkallën e zvogëlimit në hartë?

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike

Modeli 1 Paraqitja në hartë e distancave reale të matura në terren

Ushtrimi 1/1 Gjatësia e rrugës nga shkolla për në qendrën sinoptike është 6 km. Si do të paraqitet kjo distancë në hartën me shkallë zvogëlimi 1:10 000?

Zgjidhje

Meqenëse shkalla e hartës është 1:10 000, kjo do të thotë se 1 cm në hartë është i barabartë me 10 000 cm në terren (njësia e përdorur në hartën numerike është centimetri). Kthejmë distancën e terrenit në të njëjtën njësi me njësinë e përdorur në hartë (në cm).

Arsyetojmë: 1 km = 100 000 cm, kjo sjell që 6 km = 600 000 cm.

Për të përcaktuar se sa cm do të paraqitet kjo distancë në hartën me shkallë 1:10 000, nisemi nga ky arsyetim: 1 cm në hartë është 10 000 cm në terren. Po 600 000 cm në terren, sa cm paraqiten në hartë?

Bëjmë veprimin $\frac{600\,000\text{ cm}}{10\,000} = 60\text{ cm}$

10 000 cm Pra, distanca e rrugës nga shkolla për në qendrën sinoptike (e cila e matur në terren ishte 600 000 cm) në hartën me shkallë 1 : 10 000, do të paraqitet me një gjatësi 60 cm.

Radha jote: Gjatësia e rrugës nga shkolla për në qendrën sinoptike është 6 km. Sa cm do të paraqitet në hartë kjo gjatësi, nëse shkalla e zvogëlimit është 1:30 000?

Modeli 2 Kthimi i distancave të matura në hartë në distanca reale në terren

Ushtrimi 2/1 Distanca në vijë ajrore midis dy qyteteve, e matur në hartën me shkallë 1:100 000, është 8 cm. Sa do të jetë kjo distancë në terren?

Llogaritjet në harta bëhen në dy mënyra: maten distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore. Kur matim në hartë, distanca në vijë ajrore (p.sh.: distanca midis kryeqyteteve të shteteve të ndryshme, midis qyteteve, vendbanimit tonë dhe bregdetit etj.), përdorim kompasin dhe vizoren (shih figurat përbri). Në mungesë të tyre mund të përdorim pjesën anësore të një fletë të bardhë.

Zgjidhje

Meqenëse shkalla e hartës është 1:100 000, kjo do të thotë se 1 cm në hartë është i barabartë me 100 000 cm në terren (njësia e përdorur në hartë është centimetri).

Arsyetojmë: 1 cm në hartë është 100 000 cm në terren. Po 8 cm në hartë sa mund të jenë në terren?

Bëjmë veprimin: $8 \text{ cm} \times 100\,000 \text{ cm} = 800\,000 \text{ cm}$.

Kthejmë distancën që gjetëm në njësinë që përdorim në terren. Kemi $1 \text{ km} = 100\,000 \text{ cm}$. Kjo sjell që $800\,000 \text{ cm} = 8 \text{ km}$ (pra, distanca prej 8 cm e matur në hartën me shkallë 1:100 000, në terren është 8 km).

Radha jote

Sa do të jetë në terren distanca prej 8 cm, e matur në hartën me shkallë zvogëlimi 1:50 000?

Ushtrimi 2/2 Distanca e rrugës midis qyteteve, e matur në hartën me shkallë 1:250 000, është 20 cm. Sa do të jetë kjo distancë në terren? Rruga e zgjidhjes është e njëjtë si në ushtrimin 2/1.

Në rastin kur matim në hartë *distanca në vijë rrugore* (gjatësinë e rrugëve të ndryshme, gjatësinë e lumenjve etj.), përdorim fijen e perit, me anë të së cilës ndjekim gjithë gjatësinë e rrugës që duam të llogarisim (shih figurën ilustruese). Pas matjes, shtrijmë fijen e perit mbi vizore dhe gjejmë gjatësinë e saj.

Radha jote

Sa do të jetë në terren, distanca prej 12 cm e matur në hartën me shkallë zvogëlimi 1:200 000?

Ushtrimi 2/3 Kur distancat e matura në vijë ajrore dhe rrugore, llogariten me anë të shkallës grafike, hapja e kompasit apo fija e perit,

me të cilat kemi bërë matjet në hartë, vendosen mbi shkallën grafike të hartës, mbi të cilën bëhen edhe llogaritjet (shih figurën përbri).

Për shembull, nëse gjatësia e segmentit të shkallës grafike të hartës përfaqëson gjatësinë prej 2,75 km dhe nëse gjatësia e fijos së perit

është dy herë më e madhe se ajo, atëherë kemi: $2 \times 2,75 = 5,5 \text{ km}$ (pra gjetëm gjatësinë reale të rrugës).

Punë praktike 1.5: Ndërtimi i një harte topografike dhe orientimi me anë të saj

Rezultatet e të nxënës

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- ndërton vetë modelin e një harte topografike;
- lexon dhe orientohet në terren me hartën topografike të vendbanimit të tij/saj;
- krahason dhe dallon ndryshimet që ka një hartë topografike nga llojet e tjera të hartave që paraqitin vendbanimin;
- diskuton dhe jep mendimin e vet në favor të gjetjes së zgjidhjeve të duhura për organizimin sa më të mirë të territorit.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45 minuta, në klasë.

Materialet burimore: Të dhëna të siguruar nga teksti mësimor, interneti a enciklopedi të ndryshme, si dhe materiale të tjera të rekomanduara nga mësuesi/ja.

Mjetet e punës: harta topografike e zonës tënde, fletë letre e bardhë në formatin (A4), plastelinë, vizore, laps, dy kunja dhëmbësh, objekte/lodra të vogla të improvizuara në formë shtëpie, shkolle, spitali, fije dentare/fije peri e zakonshme.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe, punë individuale.

Puna përgatitore:

Rikujto njohuritë e marra mbi: a) përmbajtjen e hartave topografike; b) rëndësinë e përdorimit të tyre.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike

- Mbi një karton/dërrasë, krijo me copën e plastelinës një formë të ngjashme me një kodër (shih figurën 1).
- Duke filluar që nga maja e kodrës prej plasteline dhe duke shkuar drejt bazamentit, bëj dy vrima me majën e lapsit (shih figurën 2).
- Mat me vizore lartësinë e kodrës që krijove, nga maja deri në rrëzën e saj. Ndaje lartësinë/distancën e matur në disa pjesë të barabarta dhe vendos shenja dalluese (shih figurën 3).
- Tendose fijen dentare ose fijen e perit dhe përdore për të prerë kodrën në shenjat e vendosura. Prit fillimisht copën e parë nga sipër, afër majës së malit (shih figurën 4).
- Merre copën e prerë të plastelinës dhe vendose mbi fletën e bardhë dhe skico me laps konturet e copës së prerë. Në këtë mënyrë, ti ke skicuar në letër *izohipsin* e parë (shih figurën 5).
- Pasi e skicove, hiqe këtë copë mënjane dhe vepro në të njëjtën mënyrë me copën e dytë dhe me të gjitha copat e tjera që kanë mbetur. Si përfundim, do të kesh skicuar disa izohipse (shih figurën 6). Ndërkohë do të shohësh se, pavarësisht se copat i preve me të njëjtën trashësi, format e harkuara të mbyllura (izohipset) kanë valëzime të çrregullta dhe largesa të ndryshme midis tyre (diku më afër, diku më larg).
- Vendos mbi njëra-tjetrën, sipas radhës, copat e prera dhe ndërto përsëri kodrën (shih figurën 7). Vendos mbi të figurat/lodrat e vogla, në mënyrë që të përfaqësojnë në mënyrë të përafërt disa prej objekteve kryesore që dallojmë në një vendbanim. Paraqiti këto “objekte” në fletën e skicuar me izohipse (sipas vendit që u takon), me anë të simboleve. Ti ndërtove një hartë topografike, të përafërt me një hartë topografike të ndërtuar nga hartografët. Në hartën tënde është paraqitur forma e relievit dhe çdo objekt që ndodhet në të.

Radha jote

Për të lexuar dhe për t'u orientuar me hartën topografike të zonës tënde, vepro si më poshtë:

- Me ndihmën e mësuesit/es, gjej hartën topografike (reale) të vendbanimit tënd.
- Identifiko shkallën e zvogëlimit dhe legjendën e hartës. Lexo në kornizën e hartës topografike, koordinatat gjeografike të vendbanimit tënd.
- Evidento objektet kryesore që përmban harta dhe përcakto me mendje vendndodhjen e tyre në terren. Shiko largësitë e izohipseve dhe trego se çfarë relievi përfaqësojnë.
- Për çfarë shërbejnë izohipset? Pse vijat e skicuara në hartën topografike diku janë më afër me njëra-tjetrën dhe diku më larg? Argumento përgjigjen.
- Përshkruaj relievin e vendbanimit tënd dhe analizo shpërndarjen e rrugëve, përqendrimin e ndërtesave të banimit e të aktiviteteve prodhuese, vendosjen e shkollave, të spitalit, të farmacive etj.
- Jep mendimin tënd rreth mundësive që ekzistojnë për një organizim sa më të mirë të territorit ku jeton.
- Diskuto me shokët e shoqet mbi përfundimet që arrite.

TEMA 2 SISTEMET FIZIKE (GJEOSISTEMET)

Njësia mësimore 2.1: Ndërtimi i brendshëm i Tokës


Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Diferencon shtresat e brendshme të Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.6; I.7; II.5; II.8; III.5; III.7; III.8; IV.1; IV.2; VI.6; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.1: Ndërtimi i brendshëm i Tokës			
Fjalët kyçe: korja (kontinentale, oqeanike), manteli, bërthama, litosfera, astenosfera, shkëmbinjtë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.1 (në tekst) – “Diskutojmë: Dimë që Toka jonë, si pjesë e grupit të planetëve të brendshëm, është një trup shkëmbor që përbëhet prej elementeve të rënda (alumin, silic, nikel, hekur, krom etj.). Në sipërfaqe, atë e shohim si një trup të ngurtë. Sipas informacioneve dhe përfytyrimeve tuaja, a mendoni se ajo është njësoj e gurtë deri në qendrën e saj?” Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...			
b) <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Duke marrë si shembull figurën 1, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë informacionin e ri: Njohuritë tona mbi strukturën e brendshme të Tokës bazohen kryesisht në të dhëna jo të drejtpërdrejta, sepse njeriu, deri më sot ka arritur të gërmojë jo më shumë se 12-15 km në thellësi të saj. Për ta njohur Tokën deri në brendësi të saj, na vijnë në ndihmë valët sizmike, të cilat në momentet kur ndodhin tërmetet, shpërndahen në drejtime dhe mënyra të ndryshme, në varësi të përbërjes së lëndës ku kalojnë... Në vazhdim trajton ndërtimin shtresor të Tokës: Shtresa e parë, në të cilën ndodhet edhe bota e gjallë, është korja e Tokës. Ajo përbën vetëm 2% të vëllimit të përgjithshëm të këtij planeti dhe është e formuar nga shkëmbinj me përbërje të ndryshme, ku mbizotërojnë elemente të tilla si, silici dhe alumini. Kjo shtresë gjendet në formën e kores kontinentale dhe kores oqeanike . Trashësia e kores kontinentale ndryshon nga 30 km deri në 70 km, ndërsa ajo e kores oqeanike shkon 5 deri në 8 km...			

Fton nxënësit që bazuar në figurën 1, të dallojnë dhe përshkruajnë shtresat e Tokës nga sipërfaqja në brendësi... duke diskutuar mbi veçoritë kryesore të secilës shtrese të Tokës.

Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë figurën 2.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihen detyrë klase ushtrimet 1, 3, 4, të rubrikës “Radha jote”.



Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 2 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.2: Format e relievit

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene) dhe krijimin e tyre. Përshkruan format relievore, llojet dhe shkaktarët e krijimit (format e krijuara nga forcat e brendshme dhe nga forcat e jashtme).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.6; I.7; II 5; II.8; III.5; III.7; III.8; IV.1; IV.2; VI.6; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.2: Format e relievit			
Fjalët kyçe: korja (kontinentale, oqeanike), manteli, bërthama, litosfera, atmosfera, shkëmbinjtë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi, modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna

Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.2 (në tekst) – Diskutojmë: Krahasonjmë mjediset natyrore të paraqitura në figurat e mëposhtme (a, b, c) dhe përshkruajmë se cilat elemente natyrore mbizotërojnë te secili prej tyre.

Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj të ngjashëm...

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja trajton faktorët që ndikojnë në formimin e relievit të Tokës: Format e ulura dhe të ngritura të kores tokësore përbëjnë relievin e Tokës. Relievi është produkt i veprimit të faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm. Si faktorë të brendshëm dallohen përbërja shkëmbore dhe lëvizjet e ndryshme tektonike. Format që krijohen prej faktorëve të brendshëm, modelohen nga veprimi i faktorëve të jashtëm. Në këta faktorë bëjnë pjesë: veprimi i elementeve klimatike, veprimtaria e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore e nëntokësore, veprimtaria detare, karstike, akullnajore, si dhe veprimtaria e njeriut.

Në vazhdim, mësuesi/ja fton nxënësit që pas një leximi të strukturuar të analizojnë format kryesore të relievit të Tokës.

Format e relievit: Malet janë format më të larta në reliev. Disa male janë formuar gjatë ngurtësimit të magmës në sipërfaqe, disa të tjera prej rrudhosjes dhe ngritjes së shtresave të kores tokësore (kryesisht përgjatë kufijve shkatërrues). Ato mund të gjenden si male të veçuara, vargje malore dhe malësi. Malet kanë shpate dhe kreshta (të mprehta ose të latuara) me forma të larmishme, të krijuara gjatë periudhave të...

Nxënësit përshkruajnë duke ilustruar përgjigjen edhe me figurat 1, 2, 3 dhe 4.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Punohen si detyrë klase ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimit. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur


Të sillen shembuj të ngjashëm si në ushtrimin 2 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.3: Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene) dhe krijimin e tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.6; I.7; II 5; II.8; III.5; III.7; III.8; IV.1; IV.2; VI.6; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.3: Pangea dhe kufijtë e pllakave tektonike			
Fjalët kyçe: Pangea, pllaka tektonike, kufij pllakash (ruajtëse, shkatërruese, ndërtuese)			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja modelon ndërtimin e brendshëm të Tokës duke përshkruar veçoritë kryesore për secilën shtresë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.3 (në tekst) – Diskutojmë: “Kujtojmë ndërtimin e brendshëm të Tokës dhe përshkruajmë veçoritë kryesore të secilës shtresë të saj.” Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...			
b) <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 1 dhe trajton ndryshimet që ka pësuar Pangea: Rreth 250 milionë vite më parë, kontinentet kanë qenë të bashkuara të gjitha, duke formuar një superkontinent të quajtur Pangea (fig. 1/a). Ky superkontinent filloi të copëtohej rreth 200 milionë vite më parë. Të njëjtët shkëmbinj dhe fosile të kësaj periudhe janë gjetur si në Afrikën Perëndimore, ashtu edhe në pjesën lindore të Amerikës së Jugut (fig. 2). Kjo tregon se këto kontinente kanë qenë të bashkuara më parë. Që atëherë, lëvizja e pllakave tektonike ka bërë që kontinentet të zhvendosen në pozicionet që janë sot (si në figurën 1/d)...			
Në vazhdim, mësuesi/ja fton nxënësit që të përshkruajnë ata figurën 1 me ndryshimet që ka pësuar Pangea... Nxënësit përshkruajnë...			
Në vazhdim, bazuar në edhe në figurën 3, mësuesja trajton llojet e pllakave dhe të kufijve të tyre: Ndryshimi i madh midis superkontinentit të 250 milionë vjetëve më parë dhe pamjes që ka sot sipërfaqja e Tokës, shpjegohet me lëvizjen e pllakave tektonike. Litosfera e sotme e planetit tonë është e ndarë në 15 pllaka të mëdha tektonike dhe në mbi 20 të vogla. Koha gjeologjike e Tokës (në miliona vite)...			
Në vazhdim mësuesi/ja, fton nxënësit që të përshkruajnë ata figurën 3, për të paraqitur llojet e pllakave dhe të kufijve të tyre.			



Nxënësit përshkruajnë duke ilustruar përgjigjen me figurën 3. Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Punohen si detyrë klase ushtrimet 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.
Vlerësimi i nxënësve
Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimimit. Përdoret: - Vlerësim me gojë - Vlerësim i punës në grup - Vlerësim i detyrës së shtëpisë - Vlerësim i lojës me role - Vetëvlerësim
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 2. Përveç tij, këshillohen nxënësit që të sjellin shembuj të ngjashëm si në ushtrimin 2 të rubrika “Radha jote”.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.4: Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënësve të temës: Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene) dhe krijimin e tyre.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.4: Pllakat tektonike dhe dinamika e tyre			
Fjalët kyçe: dinamika e kores së Tokës, dukuritë tektonike që ndodhin në secilin lloj të kufijve të pllakave.			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore: Nxënësi/ja krahason dukuritë që ndodhin në kufijtë e pllakave tektonike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimimit 2.4 (në tekst) – Diskutojmë: Kujtojmë sërish njohuritë që kemi marrë për ndërtimin e kores së Tokës, për pllakat tektonike dhe kufijtë midis tyre.			

Përshkruajmë çfarë janë korja kontinentale dhe ajo oqeanike, pllakat tektonike dhe kufijtë midis tyre. Mësuam që pllakat tektonike lëvizin, por a e dini pse? Çfarë ndodh në kufijtë e pllakave tektonike? Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo–Analizo–Diskuto

Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 1 dhe trajton së bashku me ta dinamikën e kores tokësore:

Pas formimit të Tokës si planet, korja e saj nisi të ngurtësohej. Pjesa më e madhe e kores kontinentale ka një vjetërsi 3-4 miliardë vjeçare, ndërsa korja oqeanike më e vjetër daton 180 milionë vjet më parë. Siç shihet, ndërmjet moshave të tyre ka një diferencë të madhe. Kjo shpjegohet me dinamikën e secilës prej tyre. Korja kontinentale, duke qenë më pak e dendur se ajo oqeanike, nuk mund të zhytet dhe të shkatërrohet. Pjesa më e madhe e saj mbetet e pandryshuar, si ajo e formuar miliarda vite më parë. Ndërkohë, korja oqeanike e re formohet vazhdimisht në kufijtë e pllakave ndërtuese...

Fton nxënësit të përshkruajnë dinamikën e planetit duke përshkruar figurën 1.

Nxënësit përshkruajnë...

Në vazhdim, mësuesi/ja trajton dukuritë që ndodhin në kufijtë e pllakave tektonike:

Në kufijtë e pllakave ruajtëse pllakat i rrëshqasin horizontalisht njëra-tjetrës, pra këtu nuk ka as zhytje të tyre dhe as del material nga manteli (fig. 2/a). Ndërkohë që pllakat i rrëshqasin njëra-tjetrës në kufijtë e tyre, fërkimi që krijohet shkakton tërmete. Këto tërmete janë të rralla, por kanë forcë të madhe shkatërruese, sepse janë të cekëta (afër sipërfaqes). Kufijtë e pllakave ruajtëse dallohen p.sh. në çarjen e madhe të San Andreas, Kaliforni...

Fton nxënësit të përshkruajnë se çfarë ndodh në kufijtë e pllakave tektonike duke ilustruar përgjigjen me anë të figurës 2. Nxënësit përshkruajnë dhe diskutojnë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/ Punë në grup

Diskutohen përgjigjet për ushtrimet 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”, si detyrë klase.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Në një hartë bote të printuar, vizato kufijtë e pllakave më të mëdha tektonike të planetit dhe përshkruaj se çfarë dukurish tektonike formohen në secilin lloj të kufijve të pllakave.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.5: Tërmetet

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon rolin dhe llojet e fuqive të brendshme (endogjene) dhe të jashtme (ekzogjene) dhe krijimin e tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.6; I.7; II 5; II.8; III.5; III.7; III.8; IV.1; IV.2; VI.6; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.5: Tërmetet			
Fjalët kyçe: tektonike, vullkanike, vatër, hipoqendër, epiqendër, magnitudë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (tërmetet). Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.5 (në tekst) – Diskutojmë: Le të shohim në tabelën e mëposhtme pasojat e tërmetit të rënë në Porto Princ të Haitit, në vitin 2010. Nga informacionet që mund të keni për tërmetet që kanë rënë në vendin tonë, sillni shembuj rreth pasojave të tyre. Nxënësit përshkruajnë dhe sjellin shembuj të tjerë...			
b) <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i> Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 1 dhe trajton konceptin mbi tërmetet: Lëkundjet e shpejta të kores së Tokës si rezultat i veprimit të faktorëve të brendshëm, quhen tërmete. Ato formohen si pasojë e lëkundjeve dhe shpërndarjeve të shkëmbinjve në brendësi të kores tokësore, për shkak të fërkimit që krijohet gjatë lëvizjeve të pllakave tektonike. Tërmetet ndodhin kryesisht në zonat ku riaktivizohen thyerjet e vjetra tektonike. Këto quhen tërmete tektonike . Tërmetet shkaktohen edhe nga lëvizja e fuqishme e magmës nëpër korridoret e saj. Këto lloje tërmetesh quhen vullkanike dhe ndodhin më shpesh përgjatë “Unazës së Zjarrit të Paqësorit”. Në varësi të thellësisë ku formohen, tërmetet mund të jenë: të cekëta, të ndërmjetme dhe të thella... Në vazhdim fton nxënësit të përkufizojnë se ç’janë tërmetet dhe të përshkruajnë figurën 1. Nxënësit përshkruajnë...			
Në vazhdim, mësuesi/ja trajton elementët e tërmetit: Zona e kores së Tokës ku lind tërmeti, quhet vatër e tij ose hipoqendër. Ajo ndodhet në një thellësi nga disa dhjetëra kilometra (15-20 km) deri në 700 km.			

Zona që gjendet në sipërfaqen e Tokës, në drejtim vertikal me vatrën e tërmetit, quhet epiqendër. Valët sizmike që dalin nga vatra, përhapen në të gjitha drejtimet në formë rrethore, duke shkaktuar lëvizjen e shtresave shkëmbore. Disa valë përhapen në brendësi të Tokës, ndërsa disa të tjera përhapen vetëm në sipërfaqe. Fuqia e një tërmeti (forca me të cilën tundet toka) quhet magnitudë e tij. Në ditët e sotme, një sizmograf e mat magnitudën nëpërmjet shkallës Rihter (dikur përdorej shkalla Merkal).

Fton nxënësit të përshkruajnë hartën e figurës 2 dhe së bashku me ta përcakton shpërndarjen gjeografike të tërmeteve në botë...

Nxënësit përshkruajnë...

Në vazhdim, bazuar në hartën e figurës 2, nxënësit tregojnë se në cilët kufij pllakash është përqendruar pjesa më e madhe e tërmeteve në botë.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 dhe 5 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.6: Vullkanet

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan shkaqet dhe rrjedhojat e vullkaneve, tërmeteve dhe zonat kryesore të paraqitjes së tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.1; I.2; I.6; I.7; II.5; II.8; III.5; III.7; III.8; IV.1; IV.2; VI.6; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.5: Tërmetet			
Fjalët kyçe: vullkani, vatra, oxhaku, krateri, produktet vullkanike, zonat vullkanike			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja krahason ndryshimet e sipërfaqes së Tokës që ndodhin si pasojë e proceseve të shpejta (vullkanet). Demonstron në hartë lidhjen e brezave vullkanikë me zonat e tërmeteve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna

Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.6 (në tekst) – Diskutojmë:

Rikujtojmë njohuritë që kemi marrë mbi shkëmbinjtë magmatikë dhe përshkruajmë se si formohen ata. Po magma dhe llava, çfarë janë? Pse ndryshojnë midis tyre?

Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja trajton konceptin *vullkan*: Procesi i daljes së produkteve vullkanike dhe vendi ku ato dalin në sipërfaqe, quhet vullkan. Një vullkan shpërthen kur forca e magmës në brendësi është më e madhe se rezistenca e kores tokësore që e rrethon atë. Në këtë rast, duke u nisur nga thellësia, magma e shkrirë, nën tryninë e gazeve që përmban, hap me forcë korridore nëntokësore, depërton përmes tyre për të dalë në sipërfaqe dhe shpërthen (fig. 1 dhe fig. 2). Ashtu si tërmetet, edhe vullkanet janë rezultat i dinamikës së pllakave tektonike.

Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 1 dhe së bashku me nxënësit trajton pjesët e një vullkani dhe produktet e tij: Një vullkan është i përbërë nga tri pjesë kryesore (fig. 1): 1. Vatra e vullkanit, e cila ndodhet në thellësi dhe përbën rezervuarin ku grumbullohet magma. 2. Oxhaku, që është korridori përgjatë të cilit lëviz magma (mund të ketë një ose disa oxhakë). 3. Krateri, i cili përbën grykën në formë hinke, nga ku dalin produktet vullkanike...

Nxënësit përshkruajnë...

Fton nxënësit të përshkruajnë hartën e figurës 2 dhe së bashku me ta përcakton shpërndarjen gjeografike të vullkaneve në botë.

Nxënësit përshkruajnë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimit. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 5 dhe 6 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

PROJEKT (ORA E PARË)

Çështjet mjedisore pranë vendbanimit tim

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të ketë pranë vendbanimit të tij/saj dhe rolin e tyre në zhvillimin e komunitetit;
- hulumton mbi një çështje mjedisore në zonën e tij/saj dhe përcakton faktorët e mundshëm që e shkaktojnë atë;
- identifikon disa zgjidhje të mundshme që ofrohen nga pushteti qendror, pushteti lokal apo edhe nga komuniteti;
- vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme;
- ndan me grupin e punës idetë dhe përfundimet individuale;
- u bën thirrje moshatarëve dhe komunitetit për të qenë aktivë në zgjidhjet e problemeve të tilla.

Burimet kryesore të informacionit:

teksti mësimor, materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara nga burime të ndryshme, vëzhgime të nxënësve në terren, biseda me më të rriturit e familjes dhe komunitetin; të dhëna dhe analiza të marra pranë pushtetit lokal; informacione të siguruar nga: interneti, institucione apo organizata mjedisore, media dhe shtypi.

Metodologjia që do të përdoret:

punë në grupe, hulumtim, anketim, analizë, paraqitje, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:

teksti mësimor, materiale të printuara, informacione nga shtypi i shkruar; kompjuter, video-projektor, tabelë paraqitjeje, shënues, fletëpalosje, postera, fotografi të ndryshme, skica/vizatime, makete të ndërtuara nga nxënësit/et.

Udhëzime për realizimin e projektit:

- diskutohet rreth potencialeve turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të ketë vendbanimi dhe rolin e tyre në zhvillimin e komunitetit; këto potenciale paraqiten me anë të albumeve, fletëpalosjeve, eseve, materialeve të përgatitura me *PowerPoint*, apo edhe në formë maketi, videoje;
 - evidentohet raporti shoqëri-mjedis pranë vendbanimit;
 - hulumtohet mbi një çështje mjedisore në zonën ku banon dhe identifikohet problemi;
 - përcaktohen faktorët e mundshëm që kanë shkaktuar problematikën mjedisore;
 - identifikohen disa zgjidhje të mundshme për minimizimin e problemit;
 - vlerësohen përfitimet dhe rreziqet që vijnë prej zgjidhjeve të mundshme;
 - përgatiten fletëpalosje ose postera, në të cilat paraqiten: problematika mjedisore, shkalla e ndërhyrjes së shtetit dhe komunitetit për përmirësimin e gjendjes, si dhe rrugët e zgjidhjes.
- Këto fletëpalosje mund të shërbejnë në veprimtari të ndryshme, të organizuara nga shkolla për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së parë të projektit

Nxënësit/et:

- ndahen në grupe, me nga katër anëtarë secili;
- njihen me përmbajtjen e projektit, burimet e informacionit dhe me mënyrat si punohet me to dhe japin idetë e tyre;
- marrin nga mësuesi/ja sugjerime mbi shpërndarjen e punës në grup;
- ndajnë rolet brenda grupit.

Shënim

Në përfundim të projektit (në orën e tretë të planifikuar) do të bëhet paraqitja e punës së kryer. Deri në fazën e paraqitjes, gjatë orës së dytë të projektit nxënësit/et mund t'i referohen rubrikës “Udhëzime për realizimin e projektit”, të paraqitur vetëm në planifikimin e orës së parë të tij.

Njësia mësimore 2.7: Tjetërsimi. Veprimtaria karstike

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan shkaqet e tjetërsimit (alterimit), kushtet në cilat zhvillohet procesi i karstit dhe format sipërfaqësore dhe nëntokësore të krijuara nga veprimtaria karstike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.6; I.8; II 6; II.8; III.4; III.5; III.5; IV.4; IV.5; VI.1; VI.8;			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I.2; I.4; I.5; I.6; II; III.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.7: Tjetërsimi. Veprimtaria karstike			
Fjalët kyçe: tjetërsim, veprimtari karstike, format e krijuara nga veprimtaria karstike			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja evidenton format e krijuara nga veprimtaria karstike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.7 (në tekst) – Diskutojmë: Shkëmbinjtë e paraqitur në fotografitë e mëposhtme kanë një sërë plasaritjesh dhe çarjesh në sipërfaqen e tyre. Si mendoni, pse janë shkaktuar ato? Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...			
b) Ndërtimi i njohurive të reja			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja trajton konceptin tjetërsim: Shkëmbinjtë e sipërfaqes së Tokës janë në kontakt të përhershëm me elementet klimatike. Këto elemente, ku dallojnë sidomos temperatura dhe reshjet, ndikojnë mbi kompaktësinë e shkëmbinjve. Kjo prishje e kompaktësisë së tyre quhet <i>tjetërsim</i> . Gjatë tij ndodh shpërbërja e shkëmbinjve dhe e mineraleve të tyre në jone të tretshme dhe në copëza ose grimca. Ato mund të mbeten në vendin e shkatërrimit ose mund të transportohen dhe të depozitohen në mjedise të tjera. Pra, tjetërsimi sjell ndryshime mekanike dhe kimike në materialin shkëmbor. Ai shfaqet në formën e tjetërsimit <i>fizik, biologjik dhe kimik</i> . Mësuesi/ja orienton nxënësit të përqendrohen në figurat 1, 2 dhe 3. Së bashku me nxënësit evidenton faktorët që ndikojnë në procesin e tjetërsimit. Tjetërsimi fizik dhe kimik ndodhin në të njëjtën kohë, sepse shkaktohen nga të njëjtët faktorë klimatikë (kryesisht veprimi i temperaturës dhe i reshjeve). Ndërsa në tjetërsimin biologjik, ndikon prania e botës së gjallë. Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë figurat 1, 2, 3.			
Mësuesi/ja trajton konceptin karst: Veprimtaria tretëse e ujit në shkëmbinjtë gëlqerorë quhet <i>karst</i> . Aktiviteti karstik zhvillohet vetëm në territoret e përbëra nga shkëmbinjtë lehtësisht të tretshëm nga uji. Aftësia tretëse e ujit në këta shkëmbinjtë rritet nëse ai përmban dioksid karboni. Relievat e formuara në shkëmbinjtë të tillë quhen <i>relieve karstike</i> . Të tillë janë gëlqerorët, dolomitët, gipset, kripa e gurit etj., të cilët quhen ndryshe edhe shkëmbinjtë karstikë.			

Nxënësit përshkruajnë...

Fton nxënësit të lexojnë në mënyrë të struktura format e krijuara nga procesi karstik. Në vazhdim, nxënësit së bashku me mësuesin/en, përshkruajnë figurën 4 dhe evidentojnë format e krijuara prej tjetërsimit dhe karstit. Nxënësit sjellin shembuj nga vendbanimi i tyre.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 dhe 5 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.8: Veprimtaria e erës

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënësve të temës: Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, eolik dhe abraziv.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.8: Veprimtaria e erës			
Fjalët kyçe: veprimtaria gërryese e erës, veprimtaria transportuese dhe depozituese e erës			
Rezultati/et e të nxënësve për orë mësimore: Nxënësi/ja evidenton format e krijuara nga veprimtaria eolike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtarisë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit			
Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimi 2.8 (në tekst) – Diskutojmë: Shihni me kujdes pamjet e paraqitura në figurat e mëposhtme. Cili faktor i jashtëm e ka modeluar relievin? Sillni shembuj që tregojnë për rolin e kësaj veprimtarie në relievin e vendit tonë ose të zonës ku banoni. Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...			

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja trajton se si vepron era në reliev: Era është një faktor i rëndësishëm në modelimin e relievit. Gjatë lëvizjes, ajo *gërryen, transporton dhe depoziton* material në sipërfaqen e tokës. Në rajonet shkretinore, në ato bregdetare, si dhe atje ku mungon bimësia, era është faktori modelues më aktiv. Veprimtaria që ajo ushtron mbi relievin quhet *veprimtaria eolike* dhe mjedisi i modeluar prej saj quhet *mjedis eolik*.

Mësuesi/ja orienton nxënësit të përqendrohen në figurat 1 dhe 2. Së bashku me nxënësit, mësuesi/ja trajton veprimtarinë gërryese të erës.

Veprimtaria gërryese e erës mbi sipërfaqen tokësore realizohet përmes *korazonit* dhe *deflacionit*. Forca gërryese e erës arrin vlerat maksimale kur erërat kanë shpejtësi të madhe dhe mbartin gjatë lëvizjes së tyre copëza e grimca ranore, të cilat përplasen me shkëmbinj lehtësisht të gërryeshëm.

Veprimtaria gërryese e erës nëpërmjet materialit që transporton quhet *korazon*. Duke qenë se përqendrimi më i madh i grimcave të rërës është pranë sipërfaqes së tokës, edhe korrozioni është më i fuqishëm aty sesa në pjesët e sipërme të shkëmbit që goditet (pra, gërryerja vjen duke u zvogëluar nga rrëza e shkëmbit në drejtim të lartësisë). Ky veprim i erës i modelon shkëmbinjtë në formë kërpu dhe (*kërpudhat shkëmbore*) ose kolone (*kolonat shkëmbore*).

Në vazhdim trajtohet veprimtaria transportuese dhe depozituese e erës: Gjatë lëvizjes, era transporton materialet që merr me vete, duke i shoshitur mirë për nga përmasat që kanë. Grimcat më të rënda të materialit bien të parat. Ato më të voglat (të rërës) transportohen më tej, duke u depozituar në një distancë më të largët sesa burimi i tyre, ndërsa materiali më i imët në trajtë pluhuri, ngjitet sipër me anë të rrymave të ajrit, duke qëndruar atje pezull dhe depozitohet në tokë vetëm gjatë reshjeve të shiut. Lloji më i përhapur i depozitimeve të erës janë *dunat ranore*, të cilat gjenden në zonat shkretinore dhe gjysmëshkretinore, si dhe përgjatë brigjeve ku rëra është e shumtë.

Në vazhdim, mësuesi/ja orienton nxënësit të përshkruajnë figurën 3 dhe tabelën 4.

Nxënësit përshkruajnë...

Nxënësit sjellin shembuj nga vendbanimi i tyre.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 dhe 5 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.9: Veprimtaria e gravitetit

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, eolik dhe abraziv.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.9: Veprimtaria e gravitetit			
Fjalët kyçe: graviteti dhe ndikimi i tij në relievet me pjerrësi, rrëshqitje, rrëzime dhe shembje			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja evidenton format e krijuara nga veprimtaria e gravitetit.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<p>a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit</p> <p>Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.9 (në tekst) – Diskutojmë: Kemi dëgjuar shpesh për shkarje të masiveve të mëdha të tokave në zona të ndryshme të vendit tonë apo edhe në botë. Sipas njohurive që keni, pse ndodhin këto rrëzime dhe shkarje të relievit? Sillni shembuj. Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...</p>			
<p>b) <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i></p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto</p> <p>Mësuesi/ja trajton se si vepron graviteti në reliev: <i>Graviteti</i> është një forcë që vepron kudo në sipërfaqen e Tokës, duke tërhequr çdo gjë në drejtim të qendrës së saj. Veprimi i gravitetit bën të mundur rënien e materialit të shpërbërë nëpër sipërfaqet e pjerrëta dhe grumbullimin e tij në fund të tyre. Për shkak të veprimit të tij në terrenet e pjerrëta, ndodhin rrëshqitje, rrëzime dhe shembje, të cilat bëhen edhe më të shpeshta nëse në to vepron edhe erozioni lumor apo mungon ose pritet bimësia. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përqendrohen në figurat 1, 2 dhe 3. Së bashku me nxënësit, mësuesi/ja trajton veprimin e gravitetit në reliev.</p> <p>Me <i>rrëshqitje</i> kuptojmë zhvendosjen e materialit nga lart-poshtë sipas një sipërfaqeje ose plani të caktuar, që quhet <i>pasqyra ose plani i rrëshqitjes</i>. Plan i rrëshqitjes është pak a shumë i vazhdueshëm dhe mund të ketë formë të sheshtë ose të lakuar.</p> <p>Në vazhdim, nxënësit krahasojnë dhe gjejnë ngjashmëritë e ndryshimet midis rrëshqitjeve, shembjeve dhe rrëzimeve.</p> <p>Nxënësit krahasojnë, diskutojnë...</p> <p>Nxënësit sjellin shembuj nga vendbanimi i tyre.</p>			
Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup			
Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.			

Vlerësimi i nxënësve
Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret: <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë - Vlerësim i punës në grup - Vlerësim i detyrës së shtëpisë - Vlerësim i lojës me role - Vetëvlerësim
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 4 te rubrika “Radha jote”.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.10: Veprimtaria e lumenjve. Veprimtaria e akullnajave

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxëniet të temës: Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, eolik dhe abraziv.	
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.6; I.8; II 6; II.8; III.4; III.5; III.5; IV.4; IV.5; VI.1; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.10: Veprimtaria e lumenjve. Veprimtaria e akullnajave			
Fjalët kyçe: veprimtari lumore, veprimtaria e akullnajave			
Rezultati/et e të nxëniet për orën mësimore: Nxënësi/ja bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshme, identifikon, format e krijuara në reliev prej veprimtarisë lumore dhe akullnajore.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësitve</i>			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja mësuesi/ja përdor situatën (rubrikën “diskutojmë”) e vendosur në fillim të mësimi 2.10: Përgjatë rrugës që përshkon, lumi krijon relievin e tij. Përshkruajmë së bashku veçoritë e këtij relievi. A e dini si krijohen format karakteristike të relievit lumor? Nxënësit të diskutojnë, përshkruajnë...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Gjatë rrjedhjes së tyre, lumenjtë modelojnë shtratin nëpër të cilin kalojnë, përmes erozionit (gërryerjes), transportimit dhe depozitimit të materialeve të ngurta.			

Ftohen nxënësit të shohin figurën 1 dhe bazuar në të, të përcaktojnë elementet përbërëse të lumit dhe të përshkruajnë format e luginave që formohen në pjesë të ndryshme të tij.

Mësuesi/ja vazhdon: Forca gërryese e lumit varet nga shpejtësia me të cilën rrjedh, nga vëllimi i ujit dhe i materialeve të ngurta që merr me vete, si dhe nga fortësia e shkëmbinjve të shtratit të tij. Përgjatë rrugës që përshkon, lumi gërryen në thellësi dhe në pjesën anësore të shtratit të tij. Kur procesi i gërryerjes ndodh më tepër në thellësi, quhet erozion vertikal. Për shkak të këtij erozioni, luginat mund të marrin formën e germës V ose të kanioneve, si dhe mund të thellohen vazhdimisht duke formuar disa nivele tarracash lumore dhe pragje. Kur procesi i gërryerjes së lumit ndodh në pjesët anësore të shtratit të tij, duke e zgjeruar atë, quhet erozion anësor. Si rezultat i këtij erozioni, luginat mund të marrin formën e germës U, ose mund të jenë me fund të sheshtë.

Ftohen nxënësit të shohin figurën 2 dhe të përshkruajnë llojet e tarracave lumore.

Mësuesi/ja vazhdon: Bashkë me ujin, lumi merr me vete edhe materialet e ngurta që gërryen nga shtrati. Këto materiale, që mund të jenë të madhësive të ndryshme, quhen sedimente. Në varësi të madhësisë së sedimenteve ndryshon dhe distanca e transportimit të tyre. Sedimentet më të imëta e më të lehta qëndrojnë në sipërfaqen e ujit dhe shkojnë më larg, deri në grykëderdhje. Sedimentet më të rënda depozitohen më afër pjesës ku ndodh gërryerja. Në zonat e sheshta, ku pjerrësia e lumit është më e vogël, lumenjtë mund të gjarpërojnë (meandrojnë) si në figurën 36, pjesa 3. Duke iu afruar grykëderdhjes, lumi e ngadalëson shpejtësinë e tij dhe depoziton aty të gjitha materialet që ka marrë me vete, duke formuar delta lumore të formave të ndryshme (fig. 3).

Në vazhdim, mësuesi/ja së bashku me nxënësit trajtojnë veprimtarinë akullnajore duke u bazuar edhe në figurat 4 dhe 5. Ftohen nxënësit të përshkruajnë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihen detyrë klase ushtrimet 1-5 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Nxënësit sjellin shembuj të formave të krijuara prej veprimtarisë lumore dhe akullnajore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.11: Veprimtaria bregdetare. Llojet e bregdeteve

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan format erozive dhe akumulative të relievit fluvial (lumor) glacial, eolik dhe abraziv. Identifikon format kryesore të zhvillueshmërisë horizontale të bregdetit duke veçuar veçoritë kryesore të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.6; I.8; II 6; II.8; III.4; III.5; III.5; IV.4; IV.5; VI.1; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.11: Veprimtaria bregdetare. Llojet e bregdeteve			
Fjalët kyçe: veprimtaria detare, klasifikimi i bregdeteve			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi, evidenton format e krijuara në reliev prej veprimtarisë bregdetare. Klasifikon llojet e bregdeteve			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën (rubrikën “diskutojmë”) e vendosur në fillim të mësimi 2.11: Vija bregdetare e Shqipërisë është dinamike dhe me forma të larmishme. Duke filluar nga pjesa veriore e bregdetit e deri në skajin më jugor të tij dallohen peizazhe të larmishme dhe mahnitëse. Bazuar në njohuritë që keni, a mund të përshkruani si modelohet bregdeti? Nxënësit të diskutojnë, përshkruajnë...			
b) Ndërtimi i njohurive të reja Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë në mënyrë të strukturuar tekstin dhe së bashku me ta trajtohen format e krijuara nga veprimtaria bregdetare. Bazuar edhe në figurën 1 trajtohet veprimtaria bregdetare: Veprimtaria gërryese detare quhet <i>abrazion</i> . Abrazioni detar realizohet nëpërmjet valëve, dallgëve, baticave, rrymave nënujore, e në disa raste edhe prej cunameve. Vala, duke gërryer në mënyrë të vazhdueshme pjesën e poshtme të shtresës shkëmbore (në nivel me ujin), formon fillimisht zgavra që përparojnë drejt tokës. Më pas, shkëputja e tavanit të këtyre zgavrave shkakton zmbropsje të bregut, duke formuar rrëpira (faleza) detare. Falezat janë format kryesore të abrazionit detar. Dallohen faleza “të gjalla”, të cilat gërryen vazhdimisht nga deti, dhe faleza “të vdekura”, që janë ndarë nga deti prej një zone depozitimi... Analizohet figura 2. Mësuesi/ja vazhdon: Veprimtaria transportuese dhe depozituese detare është karakteristikë për bregdetet e ulëta ranore, ku depozitimi mbizotëron ndaj abrazionit detar. Sedimentet e transportuara nga lumenjtë depozitohen në bregdet në mënyrë të vazhdueshme. Përveç sedimenteve terrigjene (rërë, zhavorr, argjila etj.), në brigje depozitohen edhe sedimente me origjinë organike, si alga, guaska, iriqë deti etj. Në këto brigje, kur forca gërryese e valëve dhe e baticave është e vogël, sedimentet formojnë <i>bregdet grumbullues, ranor</i> dhe me plazhe. Nxënësit komentojnë figurat 1 dhe 3.			

Në vazhdim trajtohen llojet e bregdetit: Në varësi të lartësisë, formave që krijohen dhe proceseve që mbizotërojnë në to, bregdetet ndahen në: bregdete të ulëta dhe bregdete të larta. Bregdeti që karakterizohet nga forma të krijuara prej veprimtarisë grumbulluese detare quhet *bregdet i ulët*, ndërsa bregdeti që dallohet prej formave të krijuara nga veprimtaria abrazive detare quhet *bregdet i lartë*. Ftohen nxënësit të krahasojnë dhe përshkruajnë figurat 1- a, b, c dhe d...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimet 1-3 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Provo kompetencat

(Përsëritja II – Litosfera)

1. E vërtetë apo e gabuar? V G
 - Ne mund t'i shohim me sy të lirë të gjitha llojet e shkëmbinjve të planetit. V G
 - Bërthama e Tokës përbëhet nga nikeli dhe hekuri. V G
 - Në planetin tonë gjenden tri lloje shkëmbinjsh: sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë. V G
 - Gjeologët e ndajnë kohën gjeologjike të Tokës, në era dhe në periudha. V G
 - Pasojat e drejtpërdrejta të lëvizjeve të pllakave tektonike janë: tërmetet, vullkanet dhe formimi i maleve. V G
 - Tërmetet që ndodhin në zonat ku riaktivizohen thyerjet e vjetra tektonike, quhen tërmete tektonike. V G
 - Shkëputja e pjesëve të Pangeas zë fill rreth 250 milionë vite më parë. V G
 - Korja oqeanike është më pak e dendur se korja kontinentale. V G
 - Në kufijtë e pllakave ndërtuese ndodh largimi i pllakave nga njëra-tjetra. V G
 - Krateri përbën rezervuarin ku grumbullohet magma. V G
 - Veprimtaria e elementeve klimatike dhe ajo e ujërave rrjedhëse, janë faktorë të jashtëm që veprojnë mbi relievin. V G
2. Në figurën 1: a) **emërto** shtresat e Tokës;
b) **evidento** disa prej veçorive të secilës prej tyre.
3. **Plotëso**: a) pjesët e një tërmeti (në figurën 2a) dhe **përcakto** zonat më aktive sizmike në botë;
b) pjesët e një vullkani dhe produktet vullkanike të tij (në figurën 2b) dhe **përcakto** zonat vullkanike më aktive në botë.
4. Bazuar në hartën e pllakave tektonike në botë:
a) **Përcakto** tipat e kufijve të pllakave tektonike në rastet 1, 2 dhe 3.
b) **Përshkruaj** se çfarë ndodh në secilin prej tyre.
5. **Diskuto** mbi pyetjet:
a) Çfarë është pllaka tektonike?
b) Pse korja kontinentale është më e vjetër se ajo oqeanike?
c) Si formohen tërmetet dhe sa lloje janë ato sipas origjinës së formimit?
d) Cilët janë faktorët e formimit të relievit dhe nga ç'forma kryesore përbëhet ai?
6. **Analizo** si vepron në reliev:
a) tjetërsimi; e) veprimtaria lumore;
b) veprimtaria karstike; f) veprimtaria e akullnajave;
c) veprimtaria eolike; g) veprimtaria bregdetare.
d) veprimtaria e gravitetit;
7. **Përshkruaj** llojet e bregdeteve.
8. **Lidh me shigjetë** alternativat e duhura.
 1. Pllakë tektonike a) quhet një fragment i litosferës, i kufizuar nga tre tipa kufijsh.
 2. Fushat b) janë forma më të ulëta se malet që nuk e kalojnë lartësinë 1000 m.
 3. Kodrat c) janë forma kryesisht të sheshta e të ulëta, të krijuara nga ulje tektonike të tokës ose nga grumbullime sedimentare.

Njësia mësimore 2.12: Atmosfera dhe përbërja e saj

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Tregon përbërjen e atmosferës, shtresat dhe karakteristikat kryesore të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.12: Atmosfera dhe përbërja e saj			
Fjalët kyçe: atmosferë, përbërja e atmosferës, struktura vertikale e atmosferës			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja përcakton kuptimin mbi atmosferën; analizon përbërjen dhe strukturën vertikale të atmosferës.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.12 në tekst - Diskutojmë: “Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi shkaktuesin e atmosferës qëndron gjithmonë e lidhur me Tokën. Çfarë kuptoni me konceptin atmosferë? A është ajo e domosdoshme për jetën në Tokë?” Nxënësit diskutojnë, tregojnë...			
b) <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Atmosferë quhet shtresa e ajrit që mbështjell Tokën. Prania e saj është mjaft e rëndësishme për planetin tonë, sepse lejon të mbërrijë në sipërfaqen e tij atë pjesë rrezatimi diellor aq të domosdoshme për jetën dhe pengon depërtimin e rrezeve të dëmshme. Përveç kësaj, lëvizjet e përhershme të rrymave të ajrit që ndodhin në atmosferë, zbutin diferencat midis temperaturave të ditës dhe të natës, si dhe realizojnë shpërndarjen e dritës në Tokë. Mësuesi/ja fton nxënësit të vërejnë figurën 1 dhe të diskutojnë mbi pyetjen: Përshkruaj rëndësinë që ka prania e atmosferës për jetën tënde dhe për gjithë botën e gjallë. Mësuesi/ja vazhdon: Atmosfera e Tokës përbëhet nga elemente të gazta, të ngurta dhe të lëngëta. Elementet e gazta janë: azoti, që zë 78% të atmosferës, oksigjeni, i cili zë 21%, si dhe gaze të tjera, që zënë 1% të saj. Pjesën më të madhe të gazeve që përbëjnë 1% të atmosferës e zë dioksidi i karbonit... Në vazhdim, mësuesi/ja fton nxënësit të vërejnë figurën 2 dhe të diskutojnë mbi pyetjen: Trego përmes disa shembujve, rëndësinë që ka oksigjeni për botën e gjallë në planetin tonë. Nxënësit përshkruajnë... Mësuesi/ja vazhdon: Atmosfera e planetit tonë është e përbërë nga disa shtresa, ku secila prej tyre ka veçoritë dalluese. Nisur nga sipërfaqja e Tokës drejt lartësisë, atmosfera përbëhet nga këto shtresa: troposfera, stratosfera, mezosfera, termosfera dhe ekzosfera...			

Nxënësit përshkruajnë...

Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë në tekst mbi shtresat e atmosferës. Në vazhdim i fton ata që duke pasur si referencë figurat 3 dhe 4 të tekstit të diskutojnë mbi veçoritë e secilës shtresë të atmosferës.

Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1-5 te rubrika “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimet. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 6 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.13: Rrezatimi diellor dhe shpërndarja e nxehtësisë në Tokë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan rëndësinë e rrezatimit diellor, temperaturat dhe ndryshimet ne planin horizontal dhe vertikal.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.6; I.8; II 6; II.8; III.4; III.5; III.5; IV.4; IV.5; VI.1; VI.8			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.13: Rrezatimi diellor dhe shpërndarja e nxehtësisë në Tokë			
Fjalët kyçe: rrezatimi diellor, rrezatimi tokësor, zonat e nxehtësisë, faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e nxehtësisë në planet, pasojat e shpërndarjes, së pabarabartë të nxehtësisë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja dallon brezat e nxehtësisë dhe rëndësinë e rrezatimit diellor, si rrezatimi bazë për planetin tonë. Përshkruan shkaqet dhe pasojat e shpërndarjes së pabarabartë të nxehtësisë, ndikimin e saj në qarkullimin e rrymave oqeanike dhe erërave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.13 në tekst - Diskutojmë: “Çfarë roli luan energjia diellore për jetën në planetin tonë?”

Nxënësit diskutojnë...

a) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon: Dielli i dërgon Tokës në mënyrë të vazhdueshme sasi të mëdha energjie dhe drite, të cilat përbëjnë rrezatimin diellor. Ky rrezatim nuk mbërrin i gjithi në sipërfaqen e planetit tonë, sepse një pjesë e tij përthithet nga gazet e shtresave të atmosferës... Ftohen nxënësit që bazuar në figurën 1 dhe 2, të përshkruaj se çfarë ndodh me rrezatimin diellor që mbërrin në sipërfaqen e Tokës. Nxënësit tregojnë...

Mësuesi/ja vazhdon: Siç e dimë, për shkak të formës sferike të Tokës, pjesë të ndryshme të sipërfaqes së saj marrin sasi jo të njëjta rrezatimi diellor, çka do të thotë që vende të ndryshme në planetin tonë ngrohen në mënyrë të pabarabartë. Për rrjedhojë, në Tokë formohen këto zona ose breza nxehtësie:...

Ftohen nxënësit që bazuar në figurën 2, të tregojnë ndikimin e formës së Tokës në sasinë e rrezatimit diellor që marrin zona të ndryshme të saj, në gjerësi të ndryshme gjeografike.

Nxënësit përshkruajnë....

Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 3 dhe trajton së bashku me ta se si ndikon pozita gjeografike mbi shpërndarjen e pabarabartë të nxehtësisë.

Nxënësit përshkruajnë figurën.

Më tej, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë faktorët e tjerë: Kushtet e motit dhe gjendja atmosferike. Kur moti është i kthjellët dhe pa re, në sipërfaqen e Tokës mbërrin një sasi më e madhe e rrezatimit diellor. Ndërsa në kushtet e një moti të vranët, me ajër të ndotur dhe të lagësht, sasia e rrezeve diellore është më e vogël, pasi një pjesë e tyre thithet nga avujt e ujit, gazet e ndryshme dhe pluhurat.

• Lloji i sipërfaqes. Sasia e rrezatimit që përthithet dhe shpërndahet më pas nga Toka, lidhet ngushtë me karakteristikat e sipërfaqes së saj. Sipërfaqet më të errëta të Tokës (toka të errëta, asfalti etj.) thithin më shpejt e më tepër energji diellore sesa ato më të çelëta, ndërsa sipërfaqet ujore ngrohen dhe ftohen më ngadalë...

Ftohen nxënësit të lexojnë pasojat që rrjedhin prej ndryshimit të sasisë së rrezatimit duke e ilustruar me shembullin e figurës 4.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Në vazhdim orientohen nxënësit të diskutojnë në grup mbi rolin rrezatimit diellor për planetin tonë. Sjellin shembuj.

Diskutojnë gjithashtu edhe ushtrimet 1-5 te rubrika “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimit. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 6 dhe 7 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.14: Moti

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Formulon konceptet mot dhe klimë, dhe të bën dallimin midis tyre. Përshkruan konceptet: shtypje atmosferike, lagështi e ajrit, reshje atmosferike.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6; I.7; II 7; II 8; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.14: Moti			
Fjalët kyçe: mot, elementet e motit			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja shpjegon marrëdhënien ndërmjet të dhënave të temperaturës ditore, shtypjes atmosferike dhe lagështirës relative për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.14 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.14 në tekst – “Pothuajse çdo ditë interesohemi të dimë si është dhe si do të jetë moti ditën tjetër në vendin ku jetojmë. Ne mund ta marrim informacionin nga televizioni, radioja, interneti ose nga telefonat celularë. Bazuar në të dhënat e mëposhtme, përshkruajmë ndryshimet e motit gjatë 24 orëve të datës 3 janar.” Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë, sjellin shembuj të tjerë...			
<i>b. Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 1 dhe trajton së bashku me ta se si ndryshojnë elementet e motit: Trysnia atmosferike, temperatura, drejtimi i erës dhe lagështira relative janë elemente të motit, të cilat lidhen ngushtë ndërmjet tyre (fig. 1). Ndryshimi i njërit prej këtyre elementeve reflektohet te të gjitha të tjerat, duke shkaktuar kështu ndryshime të motit në një vend të caktuar. Për shembull, nëse temperaturat e ajrit rriten, ai bëmehet e ngjitet lart duke u bërë më i lehtë dhe për pasojë, trysnia atmosferike ulet. Ndryshimet e vlerave të trysnisë atmosferike midis vendeve të ndryshme shkaktojnë lëvizje të masave ajrore ndërmjet tyre, pra erën. Gjatë lëvizjes, era ndikon më pas në ndryshimin e temperaturës dhe të lagështirës së ajrit. Kjo tregon se elementet e motit ndikojnë zinxhir te njëri-tjetri.			

Më tej, mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë motin e paraqitur në hartën e figurës 2.
Më tej, nxënësit trajtojnë rëndësinë e parashikimit të motit...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1, 2, 3 te rubrika “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë praktike 2.1 Ndërtimi i instrumenteve të thjeshta nga nxënësit, për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- ndërtton instrumente për matjen e temperaturës së ajrit, të trysnisë atmosferike, të lagështirës së ajrit, të reshjeve, si dhe për përcaktimin e drejtimit e të shpejtësisë së erës;
- përdor këto instrumente për të mbledhur të dhëna që lidhen me motin;
- shpjegon raportin ndërmjet temperaturës ditore, trysnisë atmosferike, lagështirës relative dhe drejtimit e shpejtësisë së erës, për të kuptuar motin si ndryshim afatshkurtër i këtyre treguesve;
- bashkëpunon në grup dhe ndan me të tjerët njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike: 45 minuta; në klasë.

Materialet burimore: teksti mësimor, interneti.

Disa njohuri paraprake mbi aparaturat që përdoren për matjen e elementeve të motit:

Për të qenë sa më të saktë në parashikimet e tyre, meteorologëve u duhet të mbledhin të dhëna atmosferike deri në lartësinë 30 000 m. Këtë e arrijnë nëpërmjet përdorimit të teknologjive dhe të aparaturave të ndryshme, si: radarët dhe satelitët e motit, imazhet infra të kuqe, aparaturat digjitale. Për të matur vlerat e elementeve të motit ***pranë sipërfaqes***, ata përdorin aparatura më të thjeshta si: termometër, barometër, higrometër, pluviometër etj. Këto gjenden në qendrat sinoptike. Edhe ju mund të ndërtoni aparatura të ngjashme, por më të thjeshta, të cilat do t'ju shërbejnë për të mbledhur të dhëna në lidhje me motin.

Mjetet e punës:

Për ndërtimin e termometrit: një vazo qelqi, ujë, alkool për përdorim të zakonshëm, ngjyrosës ushqimi (si p.sh. ngjyrosës vezësh), pipëz plastike, plastelinë, letër e bardhë dhe vizore.

Për ndërtimin e barometrit: një vazo qelqi, një tullumbace e madhe, një llastik, një gjilpërë, ngjitës, pipëz plastike, letër e bardhë.

Për ndërtimin e flugerit: pipëz plastike, pjatë; letër e bardhë, laps me gomë, gjilpëra me kokë, ngjitës, shenjues, plastelinë.

Për ndërtimin e anemometrit: pesë gota plastike, dy pipëza plastike, një laps (me gomë të papërdorur), kapëse letrash, gërrshërë, ngjitës, gjilpëra me kokë, shenjues.

Për ndërtimin e higrometrit: Një copë dërrasë me përmasa 27.5 cm x 5 cm x 5 cm, një copë kartoni të hollë me përmasa 15 cm x 4 cm, një copë kartoni të fortë me përmasa 21 cm x 27.5 cm, laps, vizore, gërrshërë, ngjitës, disa fije floku rreth 20 cm të gjata, gjilpëra me kokë, lapsa me ngjyra.

Për ndërtimin e pluviometrit: Një shishe plastike dylitërshe, gërrshërë, ngjitës shirit, vizore, shenjues.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

A. Për ndërtimin e termometrit (instrumenti që mat temperaturën e ajrit), veproni si më poshtë (fig. A/1):

1. Në kapakun e vazos prej qelqi bëni një brimë sa diametri i pipëzës plastike që keni zgjedhur.
2. Përzieni në pjesë të barabarta ujin me alkoolin dhe hidheni këtë përzierje në vazo, duke e mbushur deri në $\frac{1}{4}$ -ën e saj.
3. Shtoni disa pika të ngjyrosësit të ushqimit të përzierja e ujit me alkoolin. Kjo ju bën të mundur të shihni ndryshimin e temperaturës kur lëngu i ngjyrosur të kalojë nëpër pipëzën plastike.
4. Futeni pipëzën plastike përmes brimës së bërë në kapak, aq sa të mos e prekë fundin e vazos (fig. A/2).
5. Mbështilleni me plastelinë pipëzën plastike në pjesën ku ajo hyn në vazo, për të siguruar kështu një mbyllje hermetike, dhe termometri juaj është gati për t'u përdorur.
6. Ngjitni në pjesën e jashtme të vazos një letër të bardhë, të vijëzuar, ose një vizore, për të parë sa ndryshon niveli i lëngut gjatë ndryshimit të temperaturës.

Për nxënësit më kureshtarë

Për të parë se si mund të ndërtohet një termometër në kushtet e shtëpisë, mund ndiqni *link*-un e mëposhtëm:

<https://www.youtube.com/watch?v=1LOk1XzbPsg>

Prova Provoni ta vendosni termometrin tuaj në ambiente të ndryshme (vendoseni atë një herë në një enë me ujë të ngrohtë dhe më pas, në një enë me ujë të ftohtë).

B. Për ndërtimin e barometrit (instrumenti që mat trysininë atmosferike) veproni në këtë mënyrë:

1. Priteni tullumbacen në dy pjesë me madhësi të ndryshme (fig. B/1). Pjesën më të madhe të saj tendoseni mbi buzët e vazos së qelqit, duke e puthitur (si kapak) me anë të një llastiku (fig. B/2).
2. Ngjitni pipëzën plastike mbi tullumbace me ngjitësin shirit (fig. B/3).
3. Në fund të pipëzës ngjitni një gjilpërë po me ngjitës shirit.
4. Shënoni mbi një copë letër të ngjitur në mur, disa vija të ndara me hapësira të barabarta midis tyre. Tashmë, barometri juaj është gati (fig. B/4).

Për nxënësit më kureshtarë Në linkun e mëposhtëm mund të shihni se si ndërtohet një barometër me mjetet përkatëse: <https://www.youtube.com/watch?v=ah8F-xmvB2k>

C. Për ndërtimin e flugerit (instrumenti që mat drejtimin e erës), veproni si më poshtë (fig. C/1):

1. Priteni pipëzën në mënyrë të tërthortë në të dyja anët, deri në 2 cm gjatësi.
2. Vizatoni në një letër të bardhë dy forma si në figurë dhe pritini ato. Ngjitini format nëpër prerjet e pjesëve anësore të pipëzës plastike.
3. Me anë të një gjilpëre me kokë, bashkoni mesin e pipëzës plastike me gomën e lapsit. Sigurohuni që pipëza plastike të rrotullohet lirshëm (fig. C/2).
4. Ngjitni me plastelinë pjesën tjetër të lapsit, të vendosur vertikalisht me pjatën.
5. Shkruani mbi pjatë anët e horizontit: V (veriu), J (jugu), L (lindja), P (perëndimi).
6. Vendoseni flugerin në një mjedis të hapur, për të parë se nga cili drejtim fryn era (nëse flugeri tregon veriu, atëherë era vjen nga veriu).

D. Për ndërtimin e anemometrit (instrumenti që mat shpejtësinë e erës) veproni si më poshtë:

1. Merrni katër gota plastike dhe në secilën prej tyre hapni nga një brimë. Brima duhet të bëhet rreth 1.5 cm poshtë buzëve të gotës.
2. Merrni edhe një gotë tjetër dhe hapni në të dy brima (rreth 1.5 cm poshtë buzëve të saj) përballë njëra-tjetrës.

Më pas, bëni edhe dy brima të tjera përballë njëra-tjetrës (secila 1 cm poshtë buzëve të gotës). Hapni edhe një brimë në fundin e gotës (në qendër), nëpër të cilën lapsi të kalojë lirisht (fig. D/1 dhe D/2).

3. Futini pipëzat plastike nëpër brimat e bëra, ashtu si në figurat D/2 dhe D/3.
4. Sigurohuni që gryka e secilës gotë të ndjekë fundin e gotës përbri. Çdonjëra nga katër gotat duhet të qëndrojnë në pozicion anësor, si në figurën D/3.
5. Futeni lapsin nga pjesa e gomës përmes fundit të gotës së pestë. Në vazhdim, vendoseni gjilpërën me kokë në mënyrë të tillë që të bashkojë dy pipëza plastike (diagonale me njëra-tjetrën) me gomën e lapsit.
6. Përdorim shënjesin për të vënë një shenjë (p.sh. një X të madh) në fundin e njëres prej gotave anësore (fig. D/3).
7. Anemometri juaj është gati për t'u përdorur. Vendoseni në një vend të hapur, ku fryn erë.
8. Shikoni gotën e shënuar me X në fund të saj teksa rrotullohet. Numëroni sa herë rrotullohet kjo gotë brenda 10 sekondave dhe përdorni tabelën e mëposhtme për të vlerësuar shpejtësinë e erës.

Rrotullimet në 10 sekonda	2-4	5-7	8-9	10-12	13-15	16-18	19-21	22-23	24-26	27-29	30-32	33-35	36-37	38-40	41-43	44-46	47-49	50-51	52-54	55-57
Shpejtësia e erës në kilometra për orë (km/h)	2	3	5	6	8	10	11	13	14	16	18	19	21	23	24	26	27	29	31	32

E. Për ndërtimin e higrometrit (instrumenti që mat lagështirën e ajrit) veproni në këtë mënyrë:

1. Vizatoni në një karton të hollë një shigjetë me përmasa 12.5 cm x 2.5 cm dhe priteni më pas me gërshërë.
2. Ngjitni copën e kartonit të trashë mbi sipërfaqen e dërrasës.
3. Fiksoni me një gjilpërë me kokë shigjetën mbi kartonin e trashë.
4. Njëerën anë të fijeve të flokut (të bashkuara si tufë) ngjitni me qendrën e shigjetës, ndërsa anën tjetër, me kartonin e trashë si në fig. E.
5. Vendoseni higrometrin jashtë. Shënoni në karton pozicionet e shigjetës dhe shkruani sipas rastit: “mot i lagësht” ose “mot i thatë” (me anë të shenjave konvencionale).

Prova Në ditë me ajër të lagësht, fija e flokut e thith lagështinë, si rrjedhojë, ajo zgjatet dhe shigjeta do të shkojë më poshtë. Ndërsa në

ditë të thata, kur fija e flokut thahet dhe bëhet më e shkurtër, shigjeta do të shkojë më sipër.

F. Për ndërtimin e pluviometrit (instrumenti që mat sasinë e reshjeve), veproni si më poshtë (fig. F):

1. Priteni grykën e shishes plastike dylitërshe dhe kthejeni përmbys brenda pjesës tjetër, që të shërbejë si hinkë.
2. Ngjitini bashkë të dyja pjesët në vendin ku takohen.
3. Duke përdorur vizoren dhe shënjesin, në anë të shishes, në të gjithë gjatësinë e saj ndërtoni një vijë të ndarë në centimetra.
4. Në ditët me shi, vendoseni jashtë pluviometrin që ndërtuat. Pas shiut do të shikoni se sa ujë është mbledhur aty. Që shishja të mos bjerë gjatë matjes së sasisë së reshjeve në një mjedis të hapur, hidhni disa gurë ose rërë në fund të saj.
5. Ndërtoni një tabelë, ku të shënoni sasinë e reshjeve të rëna gjatë një jave.

Punë Praktike 2.2

Tema: Parashikimi i motit përmes leximit të hartave sinoptike dhe përdorimit të instrumenteve të thjeshta

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përdor dhe lexon harta të ndryshme sinoptike;
- parashikon dinamikën e motit përmes krahasimit të hartave sinoptike;
- përdor instrumentet që ka përgatitur vetë, për të matur elementet e motit;
- vëzhgon dhe interpreton të dhënat e regjistruara prej këtyre instrumenteve;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:

45 minuta; në klasë.

Materialet burimore:

Harta të ndryshme sinoptike, teksti mësimor i Gjeografisë 7, rubrika e parashikimit të motit në stacione të ndryshme televizive, interneti.

Mjetet e punës:


Harta të ndryshme sinoptike, të siguruara përmes internetit ose prej mësueses, teksti mësimor, laps/ stilolaps, fletore/fletë formati A-4, tabak kartoni, lapsa me ngjyra/lapustila, instrumentet e matjeve të elementeve të motit, të përgatitura prej nxënësit/es (termometri, barometri, higrometri, pluviometri, anemometri dhe flugeri).

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike

- A. Lexoni hartën sinoptike të Evropës, të paraqitur në faqen pasuese (ose harta të tjera sinoptike, të siguruara nga interneti), duke përshkruar:
 - **Vlerat e trysnisë atmosferike** në kontinentin tonë, në momentin e matjes së tyre (duhet të keni parasysh që vlerat e trysnisë atmosferike ndryshojnë në varësi të temperaturës së ajrit).
 - **Numrin e qendrave atmosferike** me trysni më të lartë dhe atyre me trysni më të ulët, **llojin e masave ajrore** dhe të **fronteve atmosferike** që janë formuar (shënim: kur një masë ajrore e ngrohtë lëviz drejt një mase ajrore të ftohtë, formon frontin e ngrohtë, dhe anasjelltas).
 - **Drejtimin e erës** (duke pasur parasysh që era lëviz nga një vend me trysni të lartë drejt një vendi me trysni të ulët);
 - **Llojet e reshjeve** që sjellin këto masa ajrore të paraqitura në hartë.
- B. Nxirrni përfundimet mbi veçoritë që paraqet moti në këtë moment fotografimi në hartë, duke i shënuar ato në fletore/fletë formati A-4. Diskutoni me të tjerët mbi punën e përgatitur.
- C. Nëse keni siguruar nga interneti harta sinoptike që paraqesin motin për disa ditë rresht, vëzhgoni se si ndryshojnë elementet e tij nga njëra hartë në tjetrën. Mbi bazën e ndryshimeve që dalloni, mund të bëni parashikimin e motit për ditët në vazhdim.



D. Për të paraqitur dhe parashikuar motin në vendbanimin tuaj, shfrytëzoni të dhënat e regjistruara prej instrumenteve që keni përgatitur mbi temperaturën, trysninë atmosferike, lagështinë e ajrit, sasinë e reshjeve, shpejtësinë dhe drejtimin e erës. Mbi bazën e këtyre të dhënave, vizatoni me lapsa me ngjyra gjendjen e elementeve të motit (duke përdorur shenjat konvencionale) për ditët që keni përzgjedhur të analizoni dhe më pas prezantoheni punën tuaj (si në figurën përbri).

Diskutoni me njëri-tjetrin mbi përfundimet e arritura.

Njësia mësimore 2.15: Klima

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Formulon konceptet mot dhe klimë, dhe të bën dallimin midis tyre. Identifikon faktorët që ndikojnë në formimin e klimës dhe zonat klimatike nga ekuatori në pole.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6; I.7; II 7; II 8; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.15: Klima			
Fjalët kyçe: klimë, faktorët që ndikojnë mbi klimën			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja përshkruan klimën si rezultat i modeleve afatgjatë të temperaturës, reshjeve; Identifikon: - faktorët që ndikojnë në formimin e klimës			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<i>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.15 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.15 në tekst – “Klima e vendit tonë ka tipare të ndryshme nga ajo e shumë vendeve të tjera, që ndodhen pranë apo larg nesh (kujtojmë se çfarë veçorish ka klima e Kosovës dhe e vendbanimit tonë). Si mendoni, cilët mund të jenë faktorët që ndikojnë në klimën e një vendi? Klima e vendit tonë ka tipare të ndryshme nga ajo e shumë vendeve të tjera, që ndodhen pranë apo larg nesh (kujtojmë se çfarë veçorish ka klima e Kosovës dhe e vendbanimit tonë). Si mendoni, cilët mund të jenë faktorët që ndikojnë në klimën e një vendi? Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë, sjellin shembuj të tjerë...			
<i>b. Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Mesatarja e të gjitha kushteve të motit të një vendi (temperaturës, trysnisë atmosferike, lagështirës, ditëve me diell etj.) për një periudhë afatgjatë (30-vjeçare) quhet klimë. Ajo, në dallim nga moti, është më e qëndrueshme. Nëse elementet e motit në një vend të caktuar të globit mund të ndryshojnë në çdo kohë, klima atje ka pothuajse të njëjtat tipare për periudha të gjata kohore. Ai/ajo fton nxënësit të shohin figurën 1 dhe të përshkruajnë se si ndryshojnë elementët e klimës sipas gjerësisë gjeografike. Në vazhdim fton nxënësit të përshkruajnë përmbajtjen e figurave 2 dhe 3. Në vazhdim nxit përgjigjet e nxënësve: Përshkruaj se si ndikon relievi në klimën e vendit ku ti jeton.			

Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë me radhë faktorët e tjerë që ndikojnë mbi klimë. Më pas, ai/ajo orienton nxënësit që bazuar në hartën e zonave klimatike të: a) evidentojnë llojet e klimave në brigjet e kontinenteve dhe në brendësi të tyre, në Ekuator, në gjerësitë mesatare, në gjerësitë polare, si dhe në zonat malore dhe të vrojtojnë gjithashtu klimat në Gadishullin Skandinav.

b) të rendisin faktorët që ndikojnë në shumëllojshmërinë e klimave në botë.

Ai/ajo fton nxënësit të lexojnë në tekst rëndësinë e klimës dhe të sjellin shembuj të tyre për ilustrim.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit punojnë dhe diskutojnë në grup ushtrimet 1, 2, 3 te rubrika “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimet. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 4 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.16: Zonat klimatike

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet):		Rezultati i të nxënit të temës: Formulon konceptet mot dhe klimë, dhe të bën dallimin midis tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.16: Zonat klimatike			
Fjalët kyçe: klima e zonës së nxehtë, klima e zonave mesatare klima e zonave të ftohta			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja identifikon zonat kryesore klimatike në hartë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<i>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit			
Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimet 2.16 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.16 në tekst – “Siç e dimë, rrezatimi diellor shpërndahet në mënyrë të pabarabartë mbi sipërfaqen e Tokës. Kjo bën që në planetin tonë të formohen brezat (zonat) e nxehtësisë. Cilët janë ata? Sipas jush, çfarë klime kanë?” Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë, sjellin shembuj të tjerë...”

b. Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë zonat klimatike që formohen në planetin tonë. Kështu, mësuesi/ja sqaron: Secila prej zonave të nxehtësisë ka veçoritë e veta klimatike. Kështu, duke shkuar nga Ekuatori në pole, dallojmë llojet e klimave të mëposhtme. **Klima e zonës së nxehtë**, e cila shtrihet midis Tropikut të Veriut dhe Tropikut të Jugut, përfshin klimën ekuatoriale dhe klimën tropikale. Vendet që ndodhen në të dyja anët e Ekuatorit kanë klimë ekuatoriale. Për shkak të sasisë së njëjtë të rrezatimit diellor që marrin gjatë gjithë vitit, ato kanë vetëm një stinë, e cila karakterizohet nga temperatura të larta deri në mesditë dhe reshje të shumta çdo pasdite. Duke u larguar nga Ekuatori drejt tropikëve, të gjitha vendet kanë klimë tropikale, në të cilën dallohen dy stinë. Pranë tropikëve, për shkak të masave ajrore të thata dhe mungesës së reshjeve, në brendësi të kontinenteve janë formuar sipërfaqe të mëdha shkretinore.

Fton nxënësit të shohin figurat 1 dhe 2, dhe të përshkruajnë mjediset që krijohen në kushtet e klimës ekuatoriale dhe asaj tropikale.

Në vazhdim, mësuesi/ja trajton veçoritë e zonës klimatike mesatare: **Klima e zonave mesatare**, të cilat shtrihen midis tropikëve dhe rrethëve polarë në të dyja hemisferat, përfshin: klimën mesatare oqeanike, klimën mesatare kontinentale dhe klimën subtropikale (ku bën pjesë klima mesdhetare). Në këtë zonë dallohen të katërta stinët e vitit. Vendet me klimë mesatare oqeanike kanë verë të ngrohtë e të thatë dhe dimër të ftohtë e të lagësht. Vendet me klimë mesatare kontinentale karakterizohen nga diferenca të mëdha të temperaturës dhe sasi jo të mëdha. **Klima e zonave të ftohta ose polare**, që shtrihen midis rrethëve polarë dhe poleve në të dyja hemisferat, karakterizohet nga

temperatura shumë të ulëta (temperatura mesatare është gjithmonë nën 0°), reshje në formë bore, akuj të përhershëm dhe erëra të forta. Në këto zona dallohen dy stinë.

Në vazhdim fton nxënësit të përshkruajnë figurat 3 dhe 4 të përshkruajnë mjedisin që krijohet në kushtet e klimës mesatare mesdhetare dhe klimës polare.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Në vazhdim plotësojnë ushtrimin 1 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimit. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 2 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë Praktike 2.3 Përcaktimi i disa veçorive që kanë klimat sipas zonave të nxehtësisë

Rezultatet e të nxënës

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- përdor dhe plotëson harta të ndryshme, ku paraqiten zonat klimatike të botës;
- ndërton dhe krahason grafikë klimatikë për zona të ndryshme;
- interpreton ndryshimet e temperaturës dhe reshjeve në grafikët që prezantojnë klimën e zonave të ndryshme, duke i parë të lidhura me faktorët që ndikojnë;
- ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale;
- demonstroi bashkëpunim gjatë punës në grup.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:

45 minuta; në klasë.

Materialet burimore:

Harta klimatike e botës, teksti mësimor i Gjeografisë 7, enciklopedi, atlasit gjeografik, interneti.

Mjetet e punës:

Harta klimatike e botës, teksti mësimor, laps/stilolaps, fletore/fletë formati A-4, lapsa me ngjyra/lapustila.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë individuale.

Puna përgatitore:

Për realizimin e kësaj pune praktike, mbështetuni në të dhënat e tabelave 1, 2 dhe në hartën që paraqet zonat e nxehtësisë.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

- Ndërtoni grafikët me të dhënat e tabelave 1 dhe 2, që paraqesin vlerat mesatare të temperaturave dhe sasinë mesatare të reshjeve të çdo muaji, për vende që ndodhen në breza klimatikë të ndryshëm. Ndërtoni në të njëjtin grafik kurbat e vlerave të temperaturës dhe të reshjeve të një vendi në gjithë muajt e vitit. Përsëriteni këtë për të gjitha vendet e treguara në tabelë.

Temperaturat mesatare sipas muajve (në 0°C) për disa stacione												
Vendet/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Durrës (Shqipëri)	7.9	8.9	11.2	14.5	18.3	22	24.5	24.2	22.2	17.6	13.5	10.1
Irkutsk (Rusi)	-26	-20	-13	1	8	15	20	15	6	-8	-30	-40
Vostok (Antarktidë)	-35	-45	-55	-63	-63	-69	-69	-72	-69	-59	-45	-34
Londër (Angli)	5	5	6	9	13	16	18	17	15	11	6	5
Xhakartë (ishulli Java)	25.8	25.8	26.4	26.8	26.9	29.6	26.4	26.6	26.9	26.9	26.6	26.2
Grin-Harbor (Spitsbergen)	-18	-19	-20	-15	-5	2	6	6	0	-7	-21	-15
Mongalla (Sudan)	28	28	29	27.5	26.5	25.5	24.3	24.5	25.2	25.8	25.8	26.5

Sasia mesatare e reshjeve sipas muajve (në mm) për disa stacione												
Vendet/Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Londër	70	90	110	85	50	40	45	78	80	107	113	65
Republika e Kongos	154	140	162	201	174	77	29	129	226	253	195	128
Algjeria	116	76	57	65	36	14	2	4	27	84	93	117
Irkutsk (Rusi)	12.4	8.5	10.8	18.9	32.9	61.9	120.1	82.6	50.2	29.9	18.3	19.2
Antarktida	50	40	70	50	8	7	15	20	18	110	100	50
Shqipëria	132	120	100	87	99	60	28	39	73	157	152	142
Sudan	15	30	70	100	150	170	110	70	15	710	0	0

- Vëzhgoni dhe mbani shënime për secilin stacion meteorologjik, duke evidentuar se në cilët muaj paraqiten vlerat më të larta dhe më të ulëta të temperaturës, si dhe sasi të mëdha dhe më të vogla të reshjeve përgjatë vitit.
- Gjeni në hartën e botës, të ekspozuar në klasë, pozitën gjeografike të secilit vend që ndodhet në tabelat 1 dhe 2. Përmes një shenje dalluese, përcaktoni vendndodhjen e secilit prej këtyre vendeve në hartën klimatike (skicë) të tekstit;
- Përcaktoni se çfarë klime ka secili prej këtyre vendeve (bazuar në vlerat e temperaturave, sasinë e reshjeve dhe në ecurinë e tyre përgjatë vitit).
- Interpretoni ndryshimet që vihen re në vlerat e temperaturave dhe në sasinë e reshjeve në secilin prej grafikëve, duke i lidhur ato me faktorët që ndikojnë.
- Plotësoni në hartën skicë tipat e klimave dhe evidentoni në hapësirat e lëna bosh veçoritë që ka secila prej tyre. Vendosni në hartë edhe vlerat e gjerësive gjeografike të kufijve ndarës midis brezave të nxehtësisë.
- Ndani me të tjerët përfundimet dhe njohuritë e përfuara nga vëzhgimet individuale.

Përsëritje III - Atmosfera

1. E vërtetë apo e gabuar?

- | | | |
|--|---|---|
| - Mbështjellja ujore e Tokës quhet atmosferë. | V | G |
| - Rrezatimi diellor është burimi i jetës në Tokë. | V | G |
| - Grimcat e pluhurit në atmosferë janë elemente të gazta. | V | G |
| - Ajri pranë sipërfaqes së Tokës ngrohet nga rrezatimi tokësor. | V | G |
| - Kur moti është i kthjellët dhe pa re, sasia e rrezatimit diellor që vjen në Tokë është më e madhe. | V | G |

2. Përcakto:

- në grafikun 1, sa për qind zë secili element në përbërjen e atmosferës dhe përshkruaj rolin e tij;
- në figurën 2, se cilat janë shtresat që përbëjnë atmosferën dhe përshkruaj veçoritë e tyre.

3. Diskuto mbi pyetjet:

- Pse ka rëndësi prania e atmosferës?
- Cilët janë faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e nxehtësisë në planet?
- Ku ndryshon rrezatimi diellor nga rrezatimi tokësor?
- Përse është i rëndësishëm rrezatimi diellor?
- Cilat janë pasojat që vijnë nga shpërndarja e pabarabartë e nxehtësisë?
- Pse ka rëndësi shqyrtimi i elementeve të motit dhe parashikimi i tij?
- Si ndryshojnë elementet e motit?
- Ku qëndron dallimi midis motit dhe klimës?
- Çfarë pasojash sjellin në jetën tonë dhe në planet ndryshimet klimatike?

4. Analizo përmes shembujve:

- faktorët që ndikojnë mbi klimën;
- lidhjen midis elementeve të motit.

5. a) Përcakto në hartën klimatike të botës (të paraqitur në klasë), brezat e nxehtësisë dhe klimat e tyre.

b) Përshkruaj veçoritë që kanë klimat që formohen në secilin prej këtyre brezave.


6. Lidh me shigjetë alternativat e duhura.

- | | |
|----------------------------------|--|
| 1. Shtimi i gazeve serrë | a) është gjendja e atmosferës në një çast të dhënë, në një vend të caktuar. |
| 2. Klima | b) krijon brezat e nxehtësisë. |
| 3. Ngrohja e pabarabartë e Tokës | c) është mesatarja e vlerave të temperaturës, trysnisë atmosferike, lagështirës, ditëve me diell etj., për një periudhë afatgjatë. |
| 4. Moti | d) sjell ngrohjen globale. |

Njësia mësimore 2.17: Cikli i ujit. Veçoritë e ujit të deteve dhe të oqeanëve

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënësit të temës: Përshkruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetit fizike e kimike të ujit të Detit botëror.	
Rezultatet e të nxënësit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6; I.7; II 7; II 8; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.17: Cikli i ujit			
Fjalët kyçe: hidrosferë, cikli i ujit, veçoritë e ujit të deteve dhe të oqeanëve			
Rezultati/et e të nxënësit për orë mësimore: Nxënësi/ja interpreton lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën si dhe ciklin e ujit në planet. Identifikon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeanëve (temperatura, kripësia, dendësia).			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.17 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.17 në tekst – “Dimë që në planetin tonë, uji është i pranishëm në të gjitha format e tij, për shkak të atmosferës dhe të distancës Tokë-Diell. Si mendoni, a mund të shterojë uji ndonjëherë? Jepni disa shembuj.			
b) <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon të trajtojë kuptimin mbi hidrosferën. Kështu mësuesi/ja sqaron: Mbështjellja ujore e planetit tonë quhet hidrosferë . 97% e saj është ujë i kripur dhe gjendet në formën e deteve dhe oqeanëve, ndërsa 3% është ujë i ëmbël dhe gjendet në liqene, lumenj, përrenj, ujëra nëntokësore, burime, si dhe në formën e borës e të akullnajave.			
Në vazhdim, mësuesi/ja fillon të trajtojë ciklin e ujit: Në planetin tonë, uji është gjithmonë në lëvizje, duke ndryshuar si rrjedhje edhe gjendjet e tij (të lëngët, të gaztë dhe të ngurtë). Ai lëviz nga hidrosfera në atmosferë, litosferë dhe në biosferë, duke krijuar edhe lidhje midis këtyre mbështjelljeve.			
Në vazhdim, bazuar në figurat 1 dhe 2 mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë me fjalët e tyre, format në të cilat gjendet uji në secilën prej mbështjelljeve gjeografike të planetit dhe ciklin e ujit në planet.			
Mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë informacionin e tekstit. Më pas së bashku me ta, bazuar edhe në figurat 3 dhe 4 vazhdon të trajtojë veçoritë e			

Continents and Oceans



Name: _____

Continents and Oceans



Name: _____

ujërave oqeanikë e detarë... Planeti ynë quhet ndryshe edhe “planeti blu”, sepse rreth 71% të sipërfaqes së tij e përbëjnë oqeanet, pjesë e së cilave janë detet. Sipërfaqja ujore është më e madhe në Hemisferën Jugore, ku shkon deri në 81%, krahasuar me Hemisferën Veriore, në të cilën oqeanet dhe detet zënë 61% të sipërfaqes. Thellësia mesatare e oqeanëve shkon në 3800 m...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Në vazhdim, nxënësit plotësojnë ushtrimin 1, 3, 4 të rubrikës “Radha jote”.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 2 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.18: Lëvizjet e ujërave oqeanike. Valët detare


Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të Detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.18: Lëvizjet e ujërave oqeanike. Valët detare			
Fjalët kyçe: valë detare, cunam, kreshtë, bazë, gjatësi e valës, lartësi e valës, tallaz			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeanëve dhe deteve dhe faktorëve që ndikojnë mbi valët detare, rrymat oqeanike, baticat dhe zbaticat. Evidenton llojet dhe elementet e valëve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore**a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve****Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.18 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).


Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.18 në tekst – Gjatë pushimeve në bregdet, kemi vënë re se deti herë është i qetë e herë me dallgëzime, të vogla ose të mëdha. Në figurën e mëposhtme, deti paraqitet i dallgëzuar. Si mendoni, nga se formohen këto dallgëzime?

**b) Ndërtimi i njohurive të reja****Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**

Mësuesi/ja vazhdon: Ujërat e oqeanëve dhe të deteve janë gjithmonë në lëvizje. Në sipërfaqe, lëvizjet janë në formën e valëve, ndërsa më në brendësi, në formën e rrymave detare ose oqeanike. Po kështu, çdo 24 orë uji i deteve dhe oqeanëve përparon dhe tërhiqet nga toka në mënyrë periodike, në formën e baticës dhe zbatitës. Të gjitha këto lëvizje të ujërave shkaktohen nga veprimi i disa faktorëve, të cilët do t'i trajtojmë në vazhdimësi.

Ftohen nxënësit të shohin figurat 1 e 2 dhe ndërkohë mësuesi/ja trajton së bashku me nxënësit llojet e valëve dhe elementët e tyre: **Vala** është një nga lëvizjet e dukshme të ujërave oqeanike ose detare. Shkak i zakonshëm i formimit të saj është era, që fryn mbi sipërfaqen e ujit. Në varësi të forcës së erës ndryshon edhe madhësia e valës, e cila varion që nga valëzimet e ulëta e deri tek ato më të larta (12 m lartësi). Pika më e lartë e një vale është **kreshta**, ndërsa pika më e ulët e saj është **baza**. Distanca vertikale ndërmjet kreshtës dhe bazës quhet **lartësi e valës**, kurse largësia horizontale nga njëra kreshtë në tjetrën ose nga njëra bazë në tjetrën, quhet **gjatësi e valës**...

**Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup**

Në vazhdim, nxënësit plotësojnë ushtrimin 1, 2, 3, 5 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimin. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.19: Baticat dhe zbaticat

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të Detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.19: Baticat dhe zbaticat			
Fjalët kyçe: baticë, zbaticë, shkaqet e formimit të baticë-zbaticës			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja bën dallimin ndërmjet valëve dhe baticë-zbaticave, si dhe faktorëve që ndikojnë në formimin e tyre. Evidenton llojet e baticave.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.19 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën e paraqitur në rubrikën “Diskutojmë” të mësimin 2.19: “Nëse jemi të vëmendshëm, në ditët e pushimeve mund të vëmë re që gjatë 24 orëve, niveli i ujit në bregun e detit ndryshon. Kjo mund të dallohet qartë, sidomos kur ndodhemi pranë ndonjë moli apo trampoline. Në mëngjes herët dhe pasdite, kolonat e molit e të trampolinës dallohen lehtësisht, ndërsa në mesditë uji mbulon një pjesë të madhe të tyre. Këtë ndryshim mund ta vëmë re edhe nëse kemi zgjedhur të qëndrojmë nën një çadër pranë bregut. Në mesditë, uji mund të na vijë deri te çadra. A e dini se pse ndodh ky ndryshim i nivelit të ujit në bregdet?” Mësuesi/ja tregon edhe shembuj me anë teknologjisë (kompjuter dhe videoprojektor). Nxënësit të diskutojnë, sjellin shembuj...			
b) Ndërtimi i njohurive të reja			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Ftohen nxënësit të shohin pamjet (a) e (b) të figurës 1 dhe ndërkohë mësuesi/ja trajton së bashku me nxënësit formimin e baticë-zbaticave. Në vazhdim, mësuesi/ja i drejtohet nxënësve: Bazuar në këtë figurë (1): a) përshkruaj me fjalët e tua ndryshimin që vë re në nivelin e ujit në bregdet gjatë një dite; b): kujto dhe trego nëse e ke vënë re këtë ndryshim të nivelit të ujit në bregdet gjatë pushimeve. Nxënësit diskutojnë, përshkruajnë... Në vazhdim, mësuesi/ja thotë: Siç e po e diskutojmë së bashku, baticë-zbaticat është ndryshimi ciklik i nivelit të ujit në bregdet gjatë 24 orëve. Ajo formohet si rezultat i forcës tërheqëse të Hënës ndaj Tokës, forcës tërheqëse të Diellit ndaj Tokës dhe i forcës centrifugale të Tokës (ose kundërveprueses të Tokës ndaj forcës tërheqëse të Hënës). Baticat dhe zbaticat hënore janë dy herë më të mëdha se ato të shkaktuara nga forca			

tërheqëse e Diellit. Megjithëse Hëna ka përmasa shumë të vogla (krahasuar me Diellin), për shkak të afërsisë së saj me Tokën, forca tërheqëse që ushtron mbi të është tepër e ndjeshme. Disa prej baticave mund të jenë më të mëdha apo më të vogla se ato që ndodhin zakonisht...

Frohen nxënësit të përshkruajnë paraqitjen skematike të baticave më të larta dhe atyre më të ulëta në figurën 2.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimin. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.20: Rrymat oqeanike

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veçoritë e formave të lëvizjeve të ujërave të Detit botëror (valët, rrymat detare dhe baticën dhe zbaticën).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6; I.7; II 7; II 8; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.20: Rrymat oqeanike			
Fjalët kyçe: rrymë oqeanike e ngrohtë, rrymë oqeanike e ftohtë, faktorët që ndikojnë në rrymat oqeanike			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja, përcakton faktorët që ndikojnë mbi rrymat oqeanike. Evidenton llojet e rrymave oqeanike/detare.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore*a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***Situata e të vepruarit**

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.20 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë rreth përmbajtjes së rubrikës “Diskutojmë”: “Risjellim në vëmendje informacionet mbi rrugën që përshkon rryma e Golfstrimit dhe për ndikimet e saj në klimën e vendeve pranë të cilave kalon. Përveç kësaj rryme ka edhe shumë të tjera që ndikojnë ndjeshëm në klimën e vendeve të ndryshme. Një pjesë e tyre sjell rritje të temperaturave, ndërsa disa të tjera i ulin ato. Por, pse formohen dhe lëvizin rrymat oqeanike?”

Mësuesi/ja tregon edhe pamje me anë teknologjisë (kompjuter dhe videoprojektor), si dhe tregon hartën e shpërndarjes së rrymave oqeanike.

Nxënësit të diskutojnë, përshkruajnë...

*b) Ndërtimi i njohurive të reja***Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**

Mësuesi/ja vazhdon: Masat e mëdha ujore, që lëvizin për mijëra kilometra në formën e lumenjve të nënujshëm, nga një gjerësi gjeografike në tjetrën, quhen **rryma oqeanike**. Në varësi të gjerësisë gjeografike ku formohen dhe prej nga nisen, ato mund të jenë **rryma të ngrohta** dhe **rryma të ftohta**. Këto rryma lëvizin me një shpejtësi prej 4-5 km në orë dhe mund të përshkojnë deri në 100 km në ditë. Duke qenë se formohen në një gjerësi gjeografike dhe depërtojnë në gjerësi të tjera gjeografike, veçoritë e rrymave (kripësia, dendësia dhe temperatura) ndryshojnë nga ato të ujërave përreth tyre.

Ftohen nxënësit të shohin figurat 1 dhe 2 dhe ndërkohë mësuesi/ja trajton së bashku me nxënësit formimin e rrymave oqeanike të lidhura ngushtë me faktorët që ndikojnë mbi to (në formim dhe në shmangie). Mësuesi/ja u drejtohet edhe njëherë nxënësve me pyetjen: “Çfarë është një rrymë oqeanike dhe pse formohet ajo?”. I fton të plotësojnë tabelën e ushtrimit 2.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimet 1, 3 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimit. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.21: Lumenjtë dhe elementet përbërëse të tyre

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon llojet e ujërave nëntokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.21: Lumenjtë dhe elementet përbërëse të tyre			
Fjalët kyçe: lumenjtë fushorë, lumenjtë malorë, elementet, përbërëse të lumit			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja identifikon, bazuar në vëzhgimet dhe në modele të ndryshme, elementet përbërëse të lumit dhe llojet e lumenjve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve			
Situata e të vepruarit			
Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 2.21 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit			
Mësuesi/ja fton nxënësit të diskutojnë së bashku përmbajtjen e rubrikës “Diskutojmë”: Dikush mund të banojë pranë një lumi, një tjetër e ka parë gjatë udhëtimeve, në emisione televizive apo filma; dikush mund të ketë pushuar pranë tij; një tjetër mund të ketë parë se nga buron apo ku derdhet një lumë. Gjithashtu, në harta kemi parë shtrirjen e lumenjve të ndryshëm. Bazuar në këto njohuri dhe me ndihmën e hartës fizike, përshkruajmë së bashku se çfarë është lumi dhe nga se përbëhet ai.” Nxënësit të diskutojnë, përshkruajnë...			
b) Ndërtimi i njohurive të reja			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto			
Mësuesi/ja vazhdon: Kujtoni se çfarë keni mësuar më parë: Ujërat sipërfaqësore që kanë rrjedhje të vazhdueshme nëpër një shtrat të krijuar prej tyre, quhen lumenj.			
Më pas vazhdon: Lumenjtë në botë janë të shumtë dhe kanë veçori të ndryshme nga njëri-tjetri. Këto veçori varen nga llojet e klimës e të relievit, nga përshkueshmëria e shtresave të tokës, nga prania ose jo e bimësisë, si dhe nga veprimtaria njerëzore. Sipas relievit nëpër të cilin kalojnë, lumenjtë janë: fushorë dhe malorë.			
Lumenjtë fushorë, për shkak të pjerrësisë shumë të vogël ose mungesës së pjerrësisë së relievit, kanë shpejtësi të vogël rrjedhëse, shtrat të gjerë dhe formojnë gjarpërime përgjatë rrugës së tyre. Lumenjtë malorë, për shkak të pjerrësisë së luginës që përshkojnë, kanë shpejtësi dhe forcë gërryese të madhe përgjatë rrjedhës së tyre. Si rrjedhojë, ata dallohen për shtretër të ngushtë e të thellë (deri në kanione), me pragje e ujëvara.			

Ftohen nxënësit të shohin figurën 1 dhe të përshkruajnë veçoritë e secilit prej lumenjve të paraqitur. Më pas shohin materialin e trajtuar mbi elementet përbërëse të një lumi. Në vazhdim, së bashku me nxënësit, mësuesi/ja trajton: Lumi përbëhet nga një rrjet degësh ujore, ku secila prej tyre ndahet në degë më të vogla. Ky rrjet i gjerë degësh quhet sistem ujëmbledhës. Vendi ku fillon rrjedha e lumit quhet burim (i përhershëm), ndërsa pjesa ku derdhet, quhet grykëderdhje. Lumi mund të derdhet në një tjetër lumë, në liqen, në det ose oqean. Sipërfaqja ku ujërat rrjedhëse bashkohen në një lumë kryesor, quhet pellg ujëmbledhës. Pellgjet ujëmbledhëse ndahen prej njëri-tjetrit nga pjesë të ngritura, të quajtura vija ujëndarëse. Përgjatë rrjedhës së tij, nga burimi në grykëderdhje, lumi gërryen, transporton dhe depoziton materiale, duke modeluar kështu shtratin e tij. Lartësia e ujit nga baza e shtratisit deri në sipërfaqe quhet **nivel**. Niveli i lumit ndryshon në varësi të sasisë së reshjeve, shkrirjes së borës dhe të ndryshimit të temperaturave. Nxënësit ilustronë përgjigjet bazuar në figurën 2 (përshkruajnë elementet e lumit të paraqitur).

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1-4 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 5 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.22: Liqenet dhe llojet e tyre

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxëniet të temës: Diferencon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre.	
Rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.6; I.7; II 7; II 8; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.22: Liqenet dhe llojet e tyre			
Fjalët kyçe: liqene natyrore (tektonike, vullkanike, akullnajore, karstike, bregdetare), liqene artificiale			
Rezultati/et e të nxëniet për orë mësimore: Nxënësi/ja krahason liqenet me origjinë të ndryshme, duke sjellë shembuj dhe përcaktuar vendndodhjen e tyre në hartë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna

Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.22 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja, bazuar në rubrikën “Diskutojmë” fton nxënësit të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj: “Vendi ynë ka dalje të gjerë në det, si dhe liqene mjaft të thella, me sipërfaqe të mëdha. Kështu, kushdo prej nesh mund të pushojë në bregdet apo pranë një liqeni. Ashtu si detet, edhe liqenet e zbutin klimën dhe na ofrojnë peskë shumë të mirë. Kur jemi pranë një liqeni, natyrshëm mund të na lindë pyetja: si është formuar ai?” Nxënësit të diskutojnë, përshkruajnë...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon: Liqenet janë gropa të mëdha e të mbyllura, të mbushura me ujë prej një kohe të gjatë (fig. 1/a). Ato mund të furnizohen prej: reshjeve, ujërave rrjedhëse, burimeve nëntokësore, ujërave të përfutuara nga shkiritja e borës dhe akujve etj. Liqenet mund të jenë me rrjedhje, kur prej tyre buron ndonjë lumë apo përrua, ose pa rrjedhje, kur nuk ka asnjë të tillë. Kur sasia e ujit që hyn në liqen është më e vogël se ajo që del prej tij, liqeni mund të kthehet në një kënetë (fig. 1/b).

Ftohen nxënësit të shohin figurën 1 dhe bazuar në të, të përshkruajnë mënyrën e formimit të një liqeni...

Në vazhdim, mësuesi/ja fton nxënësit të njohin informacionin e tekstit mbi llojet e liqeneve dhe së bashku me ta trajton llojet e liqeneve: Liqenet ndryshojnë nga njëri-tjetri në bazë të mënyrës së formimit të tyre. Për këtë arsye, ato ndahen në liqene natyrore dhe liqene artificiale. Sipas origjinës së formimit, liqenet natyrore janë: tektonike, vullkanike, akullnajore, karstike dhe bregdetare...

Nxënësit ilustronë përgjigjet e tyre me figurat e paraqitura në tekst si dhe me shembuj të njohur për ta.

Tregojnë në hartën e botës liqenet që përmendin.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimin. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.23: Ujërat nëntokësore dhe burimet

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Identifikon llojet e ujërave nëntokësore, mënyrën e formimit të tyre dhe karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.23: Ujërat nëntokësore dhe burimet			
Fjalët kyçe: ujërat nëntokësore, llojet e ujërave nëntokësore, burimet, faktorët që ndikojnë në formimin e ujërave nëntokësore. Vëzhgon në zonën (qytetin/fshatin) e tij praninë e burimeve dhe diskuton për llojin dhe përdorimin e tyre.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja shpjegon kuptimin mbi ujërat nëntokësor dhe faktorët që ndikojnë në formimin e tyre.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.23 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj): Trualli i Shqipërisë dhe i Kosovës është i pasur me ujëra nëntokësore dhe me burime ujore. Sipas mendimit tuaj, si janë formuar ato dhe ku qëndron rëndësia e tyre? Nxënësit japin mendimin e tyre, sjellin shembuj...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja orienton nxënësit të përqendrohen te figurat 1 e 2 (por mund të paraqitë edhe foto të tjera ose video ilustruese) dhe vazhdon: Ujërat që ndodhen në sipërfaqen e tokës quhen <i>ujëra nëntokësore</i> . Sipas mënyrës së formimit dhe të thellësisë në të cilat ndodhen, ujërat nëntokësore ndahen në: ujëra <i>freatike</i> dhe <i>arteziane</i> . Ujërat nëntokësore janë një pjesë e rëndësishme e ciklit të ujit, sepse rreth 2,5 mm nga 762 mm reshje shiu që bien mesatarisht çdo vit mbi Tokë, kthehen në ujëra nëntokësore. Ujërat që gjenden në sipërfaqe apo reshjet që bien, lëvizin përmes të çarave, poreve dhe hapësirave të shkëmbinjve me drejtimin poshtë, nën veprimin e forcës së gravitetit. Lëvizja e këtyre ujërave nëpër hapësirat nëntokësore është e vazhdueshme, por me një shpejtësi më të vogël se ujërat sipërfaqësorë, për shkak të forcës së fërkimit që krijohet nëpër këto zona. Fton nxënësit të ndërtojnë në fletore dhe në tabelën e zezë një skemë përmbledhëse (hamer) me faktorët që ndikojnë në formimin e tyre. Pas ndërtimit të tabelës, nxënësit analizojnë secilin prej faktorëve. Mësuesi/ja vazhdon: Ujërat nëntokësore që dalin në mënyrë natyrale mbi sipërfaqen e tokës, formojnë një burim . Këto ujëra mund të burojnë që nga një rrjedhë e vogël deri në sasi shumë të			

mëdha. Burimet ujore formohen përgjatë thyerjeve të shtresave shkëmbore, çarjeve karstike, ose përgjatë luginave lumore. Burimet ndryshojnë nga njëri-tjetri për nga temperatura, kripërat minerale dhe gazet e tretura në to. Burimet e mëdha janë kryesisht burime karstike. Nisur nga temperatura e ajrit në vendin ku dalin, ujërat e burimeve mund të jenë **të ftohta** (kur temperatura e tyre është më e ulët se temperatura e ajrit), dhe **të ngrohta** ose termale (kur temperatura e tyre është më e lartë se 200C). Disa burime përmbajnë ujëra minerale, në të cilat gjenden sasi të konsiderueshme kripërash minerale dhe gaze të tretura. Në vende të ndryshme të botës ka edhe burime me ujëra të nxehta, që quhen *gejzera*. Ujërat e këtyre burimeve dalin me forcë pranë zonave vullkanike, në intervale të caktuara kohore.

Ftohen nxënësit të sjellin shembuj nga vendbanimi i tyre...

Në vazhdim, mësuesi/ja fton nxënësit të vlerësojnë rëndësinë e ujërave nëntokësore dhe të burimeve ujore. Udhëzohen që të ilustrojnë me shembuj nga vendbanimi i tyre.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i lojës me role
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 4 dhe 5 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.24: Bora dhe akujt

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën qarkullimin e ujit në natyrë dhe vetit fizike e kimike të ujit të Detit botëror.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.24: Bora dhe akujt			
Fjalët kyçe: borë e përhershme, kufiri i borës së përhershme, akullnajë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja përshkruan formimin e borës dhe akujve si pjesë e hidrosferës dhe dallon ndikimin e tyre me sistemet e tjera fizike.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna

Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.24 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja, bazuar në rubrikën “Diskutojmë” fton nxënësit të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj: “Gjatë stinës së dimrit, një pjesë e popullsisë që jeton në zonat malore të vendit tonë, përballet me vështirësi të mëdha qarkullimi, për shkak të reshjeve të mëdha të dëborës dhe ngricave. Në lartësi më të mëdha, disa maja malesh zbardhin nga bora e akujt edhe gjatë verës, pra në mënyrë të përhershme. A e dini pse ndodh kështu? Si formohen akujt dhe bora e përhershme?”

Nxënësit të diskutojnë, përshkruajnë...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon: Në majat e maleve dhe pranë poleve, temperaturat e ajrit janë shumë të ulëta dhe reshjet bien në formë bore. Kur këto reshje janë të mëdha dhe temperaturat shumë të ulëta, aq sa bora mbetet përgjatë gjatë gjithë vitit, formohet **bora e përhershme**. Lartësia mbi të cilën bora asnjëherë nuk arrin të shkrijë, quhet **kufiri i borës së përhershme**. Kufiri i borës së përhershme ndryshon në varësi të sasisë së reshjeve që bien dhe të vlerave të temperaturave të ajrit. Kur temperaturat rriten dhe sasia e reshjeve zvogëlohet, kufiri i borës së përhershme ngrihet më sipër në lartësi, dhe anasjelltas.

Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 1 e bazuar në të, të përshkruajnë se si ndryshon lartësia e kufirit të borës së përhershme nga Ekuatori deri në pole, dhe pse ndryshon.

Nxënësit të diskutojnë, përshkruajnë...

Në vazhdim, mësuesi/ja vazhdon: Rënia e vazhdueshme e borës bën që shtresat e reja të saj të mbivendosen mbi borën e mëparshme. Për shkak të ngritjeve dhe uljeve të temperaturës, ajo shkrin dhe ngrin disa herë, duke u kthyer në kokrriza akulli. Kur trashësia e borës shkon rreth 20-30 m, pesha e saj ushtron një tryzni më të madhe ndaj kokrrizave të borës së poshtme dhe e bën atë më të ngjeshur. Gjatë ngjeshjes, kokrrizat e shtresave të poshtme të akullit shkrijnë dhe kur temperatura bie përsëri, ringurtësohen, por në përmasa më të mëdha, të cilat përbëjnë masën e akullnajës. Në rast se relievi është i pjerrët dhe pjesa fundore e akullit bëhet e rrëshqitshme, akulli i krijuar fillon të lëvizë dhe formon një **akullnajë**. Nëse reliev nuk ka pjerrësi, akullnaja shpërndahet në të gjitha drejtimet. Gjatë lëvizjes së tyre, akullnajat gërryejnë, transportojnë dhe depozitojnë në reliev...

Fton nxënësit të përshkruajnë pjesët e akullnajës të paraqitura në figurën 2.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3, 4 të rubrikës “Radha jote”. Lihet si detyrë shtëpie ushtrimi 6.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim miniprojekti (ndërtim maketi)
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 5 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.25: Biosfera

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet)		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan veçoritë themelore të biosferës dhe lidhjen e saj me sistemet e tjera fizike (litosferën, atmosferën, hidrosferën).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.25: Biosfera			
Fjalët kyçe: biosfera, shpërndarja e botës së gjallë në zonat (brezat) e nxehtësisë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja evidenton kuptimin mbi biosferën dhe shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 2.25 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimi 2.25 (në tekst) – Diskutojmë: Risjellim në vëmendje njohuritë e marra mbi brezat e nxehtësisë, duke përshkruar veçoritë e klimës në këta breza dhe si ndikon ajo në zhvillimin dhe shpërndarjen e botës bimore.			

Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja fton nxënësit të shohin figurën 1 dhe thekson kuptimin mbi biosferën.

Në vazhdim, së bashku me nxënësit trajtohet shpërndarja e bimësisë në zonat (brezat) e nxehtësisë:

Shpërndarja jo e njëjtë e nxehtësisë dhe e lagështirës nga Ekuatori në pole, bën që në sipërfaqen e rruzullit tokësor të kemi zona të ndryshme bimore. Duke u nisur nga Ekuatori në drejtim të poleve, dallohen këto lloje bimësh: **Bimësia e zonës së nxehtë**, që ndeshet në pyjet e dendura ekuatoriale, në savana dhe shkretëtira.

Bimësia e zonave mesatare, e cila shtrihet në pyjet e këtyre zonave, preritë, shkretëtirat dhe zonat mesdhetare.

Bimësia e zonave të ftohta ose ajo e tundrës. Hapësira e shtrirjes së bimësisë së zonave mesatare dhe të zonave të ftohta është më e madhe në Hemisferën Veriore sesa në Hemisferën Jugore (për shkak të shtrirjes shumë më të madhe të kontinenteve).

Fton nxënësit të përshkruajnë figurat 2-6 dhe të evidentojnë veçoritë e secilës zonë bimësie.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Në vazhdim, mësuesi/ja trajton formimin e dherave duke renditur veçoritë dhe faktorët kryesorë që ndikojnë në to.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2, 3 të rubrikës “Radha jote”. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/ rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim miniprojekti (ndërtim maketi)
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 2.26: Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet fizike (Gjeosistemet):		Rezultati i të nxënës të temës: Identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë.	
Rezultatet e të nxënës për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 2.26: Faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore			
Fjalët kyçe: faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e bimësisë, faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës shtazore			
Rezultati/et e të nxënës për orën mësimore: Nxënësi identifikon faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore sipas brezave të nxehtësisë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënëseve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.26 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 2.26 (në tekst) – Diskutojmë: Bazuar në njohuritë që kemi, ne mund të evidentojmë disa nga faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e botës bimore dhe në shumëllojshmërinë e saj. Cilët janë ata? Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja trajton faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e bimësisë në zonat (brezat) e nxehtësisë: Shpërndarja e botës bimore varet nga një sërë faktorësh. Midis tyre veçojmë: klimën, cilësinë e ajrit, relievin, llojet e tokave dhe veprimtarinë e njeriut. Nga Ekuatori drejt poleve, klima ndryshon, duke ndikuar mbi bimësinë me të gjitha elementet e saj. Drita është një nga elementet e klimës, për të cilin bima ka shumë nevojë për të kryer procesin e fotosintezës. Disa bimë janë dritëdashëse, ndërsa disa të tjera, hijedashëse. Lagështira është një element tepër i domosdoshëm për jetën e bimëve, pasi nëpërmjet saj treten kripërat e ndryshme, që ato i thithin me anë të rrënjëve. Disa bimë kanë nevojë për më tepër lagështirë sesa të tjerat. Era i ndihmon gjithashtu bimët në avullimin e ujit që kanë thithur nëpërmjet rrënjëve, si dhe ndikon në pjalmimin e tyre dhe shpërndarjen e farërave. Erërat e forta e rrezikojnë shumë zhvillimin e bimësisë... Fton nxënësit të përshkruajnë figurat 1, 2, 3 dhe të evidentojnë faktorët kryesorë që ndikojnë mbi shpërndarjen e bimësisë.			

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Mësuesi/ja trajton shpërndarjen e botës shtazore në zonat (brezat) e nxehtësisë: Bota shtazore ose fauna e planetit tonë është e shumëllojshme. Ajo jeton në sipërfaqen e Tokës, në tokë, në ujë dhe në ajër. Bota shtazore ndryshon nga njëra gjerësi gjeografike në tjetrën, por edhe midis vendeve të së njëjtës gjerësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm. Ndër ta, më kryesorët janë: evolucioni i Tokës, klima, relievi, bimësia dhe njeriu. **Evolucioni i Tokës** - Ndryshimet që ka pësuar sipërfaqja e Tokës përgjatë kohës së saj gjeologjike, kanë ndikuar edhe në botën shtazore (fig. 4). Si rezultat i shkëputjes dhe veçimit të kontinenteve nga njëri-tjetri, bota e hershme shtazore u zhvillua në kushtet specifike të secilit prej tyre, duke marrë veçoritë përkatëse. Kjo shpjegon ndryshimet midis botës shtazore të kontinentit të Amerikës së Jugut dhe asaj të kontinentit afrikan, edhe pse kanë kushte klimatike të ngjashme. Pas ndarjes së dy kontinenteve dhjetëra milionë vite më parë, në secilin prej tyre u zhvilluan lloje të reja të botës shtazore.

Fton nxënësit që bazuar në fig. 4, 5, 6 të përshkruajnë ndryshimet që vëren midis llojeve të botës shtazore të zonës së nxehtë dhe atyre të zonës së ftohtë.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim miniprojekti (ndërtim maketi)
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Detyrë shtëpie: Ushtrimet 2 dhe 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Punë praktike 2.4

Tema: Shpërndarja e botës së gjallë sipas zonave të nxehtësisë

Rezultatet e të nxënësve

Në përfundim të kësaj pune praktike, nxënësi/ja:

- identifikon brezat e nxehtësisë dhe zonat klimatike në hartën skicë të botës;
- hulumton dhe grumbullon informacione mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe mbi veçoritë e tyre;
- përshkruan llojet kryesore të botës bimore dhe shtazore sipas brezave të nxehtësisë;
- bashkëpunon në grup dhe ndan me të tjerët njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.

Koha dhe vendi i zhvillimit të punës praktike:

45 minuta; në klasë.

Materialet burimore: harta fiziko-gjeografike e botës, teksti mësimor, atlas, materiale të gjetura në internet mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe mbi veçoritë e tyre.

Mjetet e punës: harta fiziko-gjeografike e botës, laps/stilolaps, lapsa me ngjyrë/lapustila, fletore/fletë formati A-4, laptop, videoprojektor.

Metodologjia që do të përdoret:

Punë në grupe.

Puna përgatitore:

Për realizimin e kësaj pune praktike, nxënësit duhet të bazohen në njohuritë e marra nga teksti mësimor, mbi brezat e nxehtësisë dhe zonat klimatike që shtrihen në secilin prej tyre. Mësuesi/ja i orienton që më parë nxënësit të hulumtojnë dhe grumbullojnë informacione mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe mbi veçoritë e tyre. Me këto informacione, nxënësit do të përgatisin përmbledhjen, e cila do të prezantohet gjatë punës praktike me *PowerPoint*, skema të bëra në tabakë kartoni, postera apo me fletëpalosje. Mësuesi/ja orienton që më parë disa prej nxënësve të përgatitin herbariume me llojet e bimëve që rriten në vendin tonë ose në vendbanimet e tyre.

Hapat që do të ndiqen gjatë zhvillimit të orës së punës praktike:

- Në hartën fiziko-gjeografike të botës, të ekspozuar në klasë, përcaktoni brezat e nxehtësisë dhe llojet e klimave që kanë.
- Përcaktojini dhe emërtojini ato në hartën skicë të botës (në tekst).
- Përcaktoni dhe emërtoni në hartën skicë të botës hapësirën që zënë llojet e bimësisë në secilin brez të nxehtësisë (sipas llojeve të klimave). Shkruani në kuadratet bosh disa prej karakteristikave kryesore të tyre.
- Paraqitni në hartën skicë të mëposhtme, me shkrim ose me një shenjë konvencionale, nga dy ose tri lloje bimësh përfaqësuese për secilën lloj bimësie.
- Paraqitni aty, me shkrim ose me një vizatim të thjeshtë, edhe nga dy ose tre përfaqësues të botës shtazore për secilin brez të nxehtësisë.
- Prezantoni nëpërmjet *PowerPoint*-it, skemave të bëra në fletë kartoni, posterave apo fletëpalosjeve, produktin që keni përgatitur prej hulumtimeve tuaja mbi llojet e botës së gjallë sipas brezave të nxehtësisë dhe për veçoritë e tyre.
- Tregojuni (nëse e keni përgatitur) shokëve tuaj edhe herbariumin, duke veçuar në të ndonjë lloj bime që përdoret si bar mjekësor.

Projekt ora e dytë

Çështjet mjedisore pranë vendbanimit tim

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të ketë pranë vendbanimit të tij/saj dhe rolin e tyre në zhvillimin e komunitetit;
- hulumton mbi një çështje mjedisore në zonën e tij/saj dhe përcakton faktorët e mundshëm që e shkaktojnë atë;
- identifikon disa zgjidhje të mundshme, që ofrohen nga pushteti qendror, nga pushteti lokal, komuniteti, apo ai/ajo si individ;
- vlerëson përfitimet dhe rreziqet e zgjidhjeve të mundshme;
- ndan me grupin e punës idetë dhe përfundimet individuale;
- u bën thirrje moshatarëve dhe komunitetit për të qenë aktivë në zgjidhjet e problemeve të tilla.

Burimet kryesore të informacionit:

teksti mësimor, materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara nga burime të ndryshme, vëzhgime të nxënësve në terren, biseda me më të rriturit e familjes dhe komunitetin përkatës; të dhëna dhe analiza të marra pranë pushtetit lokal; informacione të siguruar nga: interneti, institucione apo organizata mjedisore, media dhe shtypi.

Metodologjia që do të përdoret:

punë në grupe, hulumtim, intervista, anketim, diskutim, analizë, paraqitje, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:

teksti mësimor, materiale me informacione nga shtypi i shkruar; kompjuter, videoprojektor; tabelë prezantimi, shënues, fletëpalosje, postera, fotografi, skica/vizatime; fletë-anketa dhe makete të ndërtuara nga nxënësit/et etj.

Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen gjatë orës së tretë të projektit:

- Nxënësit/et përshkruajnë punën e bërë deri në këtë fazë të projektit. Tashmë ai duhet të jetë në trajtën e një raporti paraprak, ndaj u këshillohet të tregojnë një vëmendje të veçantë për origjinalitetin dhe cilësinë e punimit, për të pasur një produkt sa më të realizuar në fazën përfundimtare.
- Evidentohet kontributi i secilit anëtar të grupit dhe shkalla e bashkëpunimit midis tyre.
- Nxënësit/et përshkruajnë shkallën e përdorimit të burimeve të informacionit, rrugët e sigurimit dhe vlefshmërinë e tyre.
- Raportohen vështirësitë dhe bëhen sugjerime edhe nga nxënës/e të grupeve të tjera, mbi zgjidhje dhe ide të ndryshme.

Shënim

Për udhëzimet e realizimit të projektit referoju rubrikës përkatëse, të paraqitur në orën e parë të tij.

Tema 3 Sistemet humane

Njësia mësimore 3.1: Dinamika e popullsisë së botës

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.1: Dinamika e popullsisë së botës			
Fjalët kyçe: dinamika e popullsisë, shtimi natyror i popullsisë, faktorët që ndikojnë në dinamikën e popullsisë.			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja identifikon dinamikën e popullsisë së Botës që prej periudhave të hershme deri tani. Evidentojnë faktorët që kanë ndikuar në këtë dinamikë.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj). Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.1 (në tekst) – Diskutojmë: Në periudha të ndryshme zhvillimi, numri i popullsisë së botës ka pësuar ndryshime. Si mendoni, cilët janë faktorët që kanë ndikuar në këtë drejtim? Përshkruani si ka ndryshuar me kalimin e viteve numri i banorëve të vendbanimit tuaj dhe tregoni çfarë prirjeje ka (rritje apo zvogëlim të popullsisë). Nxënësit përshkruajnë, sjellin shembuj... <i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i> Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Në vitin 2018, popullsia botërore u vlerësua rreth 7,6 miliardë banorë. Ky numër është rezultat i rritjes së vazhdueshme të saj, por edhe i luhatjeve të herëpashershme që ka pësuar. Në përgjithësi, dinamika e popullsisë është përcaktuar nga ndikimi i një sërë faktorësh si: shtimi natyror (lindshmëria dhe vdekshmëria), migrimet, luftërat, fatkeqësitë natyrore, epidemitë, politikat demografike të shteteve, moshë e martesës etj. Në periudha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, disa prej këtyre faktorëve kanë pasur ndikim më të madh... Fton nxënësit të përqendrohen tek figura 1 dhe përshkruan dinamikën e popullsisë duke u bazuar në këtë grafik.			

Fton nxënësit ta përshkruajnë edhe ata.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Mësuesja ndalet në analizë, në dinamikën e popullsisë në periudhat më të hershme të zhvillimit shoqëror.

Në vazhdim trajtohet dinamika e popullsisë nga periudha moderne deri sot: Fton nxënësit që bazuar në fig. 2, 3, të përshkruajnë këto ndryshime.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Për të ta bërë akoma më të kuptueshëm informacionin, mësuesi/ja nxit një bashkëbisedim me çështjen:

Përshkruaj ndryshimet e numrit të popullsisë së Kosovës në periudha kryesore të historisë së saj.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim një detyrë tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.2: Shpërndarja e popullsisë në botë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan ndikimin e faktorëve fizikë, mjedisorë, ekonomikë dhe politikë në shpërndarjen e popullsisë në botë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.2: Shpërndarja e popullsisë në botë			
Fjalët kyçe: shpërndarje e popullsisë, faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e popullsisë, dendësia e popullsisë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja evidenton shpërndarjen e popullsisë së Botës dhe faktorët që kanë ndikuar.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna

Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore

a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Situata e të vepruarit

Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.2 (në tekst) – Diskutojmë: Në planetin tonë, shpërndarja e popullsisë nuk është e njëjtë. Cilët mendoni se janë faktorët që ndikojnë? Nxënësit sjellin mendimin e tyre...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon: Shpeshherë, njerëzit synojnë të vendosen në territore me kushte natyrore dhe socio-ekonomike sa më të mira për të jetuar. Si rezultat i kësaj, të gjitha pjesët në sipërfaqen e Tokës nuk janë njësoj të banuara. Në planetin tonë ekzistojnë vise të banuara- *ekumena*, vise rrallë të banuara- *semiekumena* dhe vise jo shumë të banuara- *anekumena*. Kjo shpërndarje e pabarabartë e popullsisë ka përcaktuar një përqendrim jo të njëjtë të saj në vende të ndryshme të botës (shih figurën 1). Përgjatë periudhave kohore, dendësia mesatare e popullsisë ka shënuar vazhdimisht rritje. Kjo rritje ka ndodhur paralelisht me rritjen e numrit të përgjithshëm të popullsisë së botës. Nëse në fillim

të shekullit XX dendësia e popullsisë ishte 11 banorë/km², sot ajo shkon në rreth 57 banorë/km².

Fton nxënësit të përqendrohen tek figura 1 dhe përshkruan dinamikën e popullsisë duke u bazuar në hartën e paraqitur.

Fton nxënësit ta përshkruajnë shpërndarjen e popullsisë. Nxit një diskutim me çështjen: përshkruaj shpërndarjen e popullsisë në Kosovë ose në vendbanimin tënd dhe rendit faktorët kryesorë që kanë ndikuar në të.

Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj...

Mësuesi/ja ndalet në shpërndarjen e popullsisë dhe dendësinë e saj duke theksuar se ato ndryshojnë në varësi të ndikimit të disa faktorëve, midis të cilëve janë:- faktorët gjeografikë (klima, relievi, tokat, hidrografia, pasuritë nëntokësore dhe bota e gjallë); - faktorët demografikë (lindshmëria, vdekshmëria, migrimet etj.); - faktorët socio-ekonomikë (niveli i zhvillimit ekonomik, kulturor, arsimor, politikat demografike etj.).

Në vazhdim fton nxënësit të lexojnë në mënyrë të strukturuar informacionin e tekstit dhe së bashku me ta trajtohet dendësia e popullsisë dhe shpërndarja e popullsisë në zona/rajone të ndryshme të botës.

Nxënësit përshkruajnë, diskutojnë...

Për ta bërë akoma më të kuptueshëm informacionin, mësuesi/ja nxit një bashkëbisedim me çështjen:

Përshkruaj ndryshimet e numrit të popullsisë së Kosovës në periudha kryesore të historisë së saj.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve
Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret: <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë - Vlerësim i punës në grup - Vlerësim i detyrës së shtëpisë - Vlerësim i një detyre tematike - Vetëvlerësim
Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 3 te rubrika “Radha jote”.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.3: Strukturat kryesore të popullsisë në botë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënësve të temës: Diferencon strukturat themelore të popullsisë në botë.	
Rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.3: Strukturat kryesore të popullsisë në botë			
Fjalët kyçe: përbërja strukturore e popullsisë (sipas moshës, gjinisë, arsimit, veprimtarisë ekonomike, racës, besimit fetar dhe etnisë)			
Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore: Nxënësi analizon përbërjen strukturore të popullsisë (sipas moshës, gjinisë, arsimit, veprimtarisë ekonomike, racës, besimit fetar dhe etnisë). Sjell shembuj nga vendi ose nga vendbanimi.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit			
Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 3.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit			
Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimi 3.3 (në tekst) – Diskutojmë: Bazuar në fotografinë e mëposhtme, përshkruaj se çfarë veçorish i dallojnë nga njëri-tjetri individët e paraqitur në të. A dallon veçori të ndryshme në komunitetin ku banon dhe mëson? Cili është qëndrimi yt lidhur me veçoritë e ndryshme që mund të kenë shokët dhe shoqet e tua.			

Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Mësuesi/ja vazhdon: Një element i rëndësishëm që ndikon në dinamikën e popullsisë në botë është përbërja strukturore e saj. Struktura e popullsisë nënkupton ndarjen e popullsisë në kategori të ndryshme sipas një veçorie të caktuar. Individët që përbëjnë popullsinë e botës dallohen ndërmjet tyre nga shumë veçori si: mosha, gjinia, statusi civil, profesioni dhe veprimtaria e tij, niveli arsimor, përkatësia etnike (kombëtare), besimi fetar, raca etj. Gjeografia studion, strukturën e popullsisë sipas gjinisë, moshës, racës etj.). Fton nxënësit ta njihen me materialin e trajtuar në njësinë mësimore dhe së bashku me ta trajton strukturën e popullsisë sipas moshës, gjinisë, arsimore, sipas racës etj.

Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj...

Gjatë diskutimit si material ilustrues shërbejnë edhe figurat 1-5.

Në mënyrë të vazhdueshme pas çdonjëres prej çështjeve, mësuesi/ja nxit një bashkëbisedim, duke kërkuar që ajo të ilustron me situatën strukturore të popullsisë në Kosovë apo në vendbanimin e tyre.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 2 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.4: Migrimi i popullsisë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare:	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Shoqëria dhe Mjedis			
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon llojet, shkaqet dhe pasojat e migrimeve.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.4: Migrimi i popullsisë			
Fjalët kyçe: migrim, faktorët kryesorë që ndikojnë mbi migrimin, pasojat kryesore të migrimit			

Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore: Nxënësi/ja evidenton migrimin e popullsisë si një fenomen botëror dhe faktorët që ndikojnë në të. Identifikon pasojat e migrimit të popullsisë.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore
<p><i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p> <p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.4 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.4 (në tekst) – Diskutojmë: “Kujtoni çfarë keni mësuar për migrimet dhe përcaktoni se çfarë përfaqëson migrimi i popullsisë. Cilat mendoni se janë shkaqet kryesore të lëvizjeve migratore të popullsisë në periudha të ndryshme?”</p> <p>Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...</p> <p><i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i></p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Lëvizjet migratore janë karakteristikë për shoqërinë njerëzore që nga periudhat e hershme të ekzistencës së saj e deri në ditët e sotme. Ato ndahen në bazë të disa kriterëve: sipas hapësirës dhe distancës që përfshijnë, sipas motivit/faktorit që ndikon, vullnetit dhe mënyrës së organizimit.</p> <p>Fton nxënësit ta njihen me materialin e trajtuar në njësinë mësimore dhe së bashku me ta trajton llojet e migracionit në botë drejtimet kryesore të tyre...</p> <p>Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj...</p> <p>Gjatë diskutimit, si material ilustrues shërbejnë edhe figurat 1, 2 dhe 3.</p> <p>Në mënyrë të vazhdueshme pas çdonjërit prej çështjeve, mësuesi/ja nxit një bashkëbisedim, duke kërkuar që ajo të ilustrohet me situatën migratore në Kosovë apo në vendbanimin e tyre (faktorët, drejtimet dhe përmasat e migrameve).</p> <p>Në vazhdim, nxënësit evidentojnë pasojat e lëvizjeve migratore.</p> <p>Nxënësit theksojnë: Çdo formë e migrimit të popullsisë ka pasojat pozitive dhe negative, si për vendet e origjinës, ashtu edhe për vendet pritëse.</p> <p>Disa prej <i>pasojave pozitive</i> të emigrimit janë: rritja ekonomike e vendit prej dërgesave monetare të emigrantëve (remitancat); ngritja profesionale e individëve që punësohen në sipërmarrjet e vendeve pritëse; zbutja e nivelit të papunësisë në vend; rritja e përqindjes së popullsisë së re në vendet pritëse; shkëmbimi i kulturave etj.</p> <p>Ndër <i>pasojat</i> negative të emigracionit dallojnë: ulja e numrit të popullsisë në vendet e origjinës; largimi i moshës së re (fertil); humbja e jetës; trafikimi i qenieve njerëzore; punësimi i emigrantëve në frontet më të vështira dhe në punë të zezë (pa sigurime shëndetësore), për shkak të mos pajisjes së tyre me leje qëndrimi (sidomos gjatë viteve të para të emigrimit) etj.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Lihet detyrë klase ushtrimi 1 të rubrikës “Radha jote”. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 2 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.5: Vendbanimet.

Elementet e shtetit dhe roli i organizatave ndërkombëtare

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon faktorët që kanë ndikuar dhe ndikojnë në krijimin e vendbanimeve, funksionet dhe kriterit kryesore të tyre. Identifikon elementet e shtetit, grupimet e ndryshme ekonomike, politike, ushtarake si dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.5: Vendbanimet. Elementet e shtetit dhe roli i organizatave ndërkombëtare			
Fjalët kyçe: llojet e vendbanimeve, elementet e shtetit, organizata ndërkombëtar			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja evidenton llojet e vendbanimeve dhe elementet e shtetit. Identifikon disa prej organizatave kryesore ndërkombëtare.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media; Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit			
Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 3.5 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			

Hapi I: Rrjeti i diskutimit

Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimit 3.5 (në tekst) – Diskutojmë:

- Cilat janë llojet e vendbanimeve që ndeshim në Shqipëri dhe në Kosovë?
- Cilat janë mënyrat e organizimit shtetëror të Kosovës dhe të Shqipërisë?
- Çfarë raportesh kanë këto vende me organizatat ndërkombëtare, si OKB, BE, NATO, UNICEF etj.?”

Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...

b) Ndërtimi i njohurive të reja**Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto**

Mësuesi/ja vazhdon: Vendbanimet janë njësi territoriale të organizimit të popullsisë. Veçoritë kryesore të vendbanimeve janë: madhësia (e cila shpreh numrin e banorëve që jetojnë në të); forma (që tregon shpërndarjen e banesave dhe mënyrën e ndërtimit të tyre); aktiviteti ekonomik mbizotërues.

Sipas madhësisë, ato ndahen në vendbanime të vogla dhe vendbanime të dendura. *Sipas formës*, vendbanimet janë të rregullta, të parregullta, vendbanime gjatësore, vendbanime fushore, kodrinore, malore etj. *Sipas aktivitetit ekonomik mbizotërues*, ato ndahen në vendbanime rurale, urbane dhe mikse (të përziera).

Vendbanim rural quhet njësi territoriale, në të cilën popullsia aktive në pjesën më të madhe të saj merret me ekonomi bujqësore (shih figurat 1, 2 dhe 3)...

Mësuesi/ja fton nxënësit ta njihen me materialin e trajtuar në njësinë mësimore dhe së bashku me ta trajton llojet e vendbanimeve urbane dhe rurale. I udhëzon nxënësit të ndërtojnë një skemë përmblledhëse me llojet e vendbanimeve.

Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj dhe prezantojnë skemën përmblledhëse (hamer)...

Gjatë diskutimit si material ilustrues shërbejnë edhe figurat 1-6.

Në mënyrë të vazhdueshme pas çdonjëres prej çështjeve, mësuesi/ja nxit një bashkëbisedim, duke kërkuar që ajo të ilustrohet me llojet e vendbanimeve në Kosovë apo me veçoritë e vendbanimit të tyre.

Në vazhdim mësuesi/ja trajton elementët e shtetit dhe së bashku me nxënësit organizatat kryesore botërore sot. Vlerësohet roli i tyre.

Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimit. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.6:

Veçoritë e zhvillimit ekonomik në botë dhe faktorët kryesorë që ndikojnë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan veçoritë themelore ekonomike- gjeografike në botë si faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.6: Veçoritë e zhvillimit ekonomik në botë dhe faktorët kryesorë që ndikojnë			
Fjalët kyçe: ekonomi; faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja përshkruan veçoritë themelore ekonomike- gjeografike në botë si dhe faktorët kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendeve.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.6 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.6 (në tekst) – Diskutojmë: “Bazuar në njohuritë tuaja, shpjegoni kuptimin e konceptit ekonomi. Renditni disa degë të saj dhe evidentoni faktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të një vendi.”			
Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Ekonomia është veprimtaria më e rëndësishme e shoqërisë njerëzore, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetesën e saj. Ajo përfshin tërësinë e proceseve që nevojiten për përfundimin e produkteve të ndryshme. Ndër proceset kryesore përmendim: prodhimin, marketingun (reklamimin) dhe shpërndarjen e produktit në treg. Elementet bazë të veprimtarisë ekonomike janë prodhimi i të mirave materiale dhe shërbimet. Nëpërmjet këtyre elementeve plotësohen nevojat kryesore të shoqërisë. Dy format e ekonomisë janë: <i>ekonomia prodhuese</i> dhe <i>ekonomia joprodhuese</i> . Në ekonominë prodhuese bëjnë pjesë ato degë që prodhojnë të mira materiale. Të tilla janë: bujqësia, industria, ndërtimtaria, energjetika dhe artizanati. Në ekonominë joprodhuese përfshihen degët që ofrojnë shërbime dhe ndihmojnë ekonominë prodhuese. Ndër to përmendim: turizmin, transportin, tregtinë, shërbimet bankare.			

Sipas llojit të produktit apo shërbimit që ofron, ekonomia ndahet në tri sektorë kryesorë, të cilët janë paraqitur në skemën e mëposhtme...

Mësuesi/ja fton nxënësit të përshkruajnë skemën e paraqitur në tekst dhe të sjellin shembuj ilustrues për çdo sektor.

Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj dhe prezantojnë sektorët e ekonomisë në një skemë përmblledhëse (hamer)...

Në vazhdim, mësuesi/ja trajton faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë. Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figura 2.

Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.

Në vazhdim, mësuesi/ja trajton konceptet *vende në zhvillim* dhe *vende të zhvilluara*. Përmes shembujve dhe hartës së vendosur në tekst, por edhe hartës së botës të paraqitur në klasë, analizohet niveli i zhvillimit ekonomik të vendeve sot në botë. Theksohen instrumentet mbi bazën e të cilëve bëhet kategorizimi i vendeve:

Ato ndryshojnë midis tyre nga:

- punësimi sipas sektorëve (në vendet e zhvilluara, sektori i prodhimit të mallrave të gatshme dhe ai i shërbimeve kanë numrin më të madh të të punësuarve);
- konsumi i energjisë për frymë (në vendet e zhvilluara është i lartë, ndërsa në vendet në zhvillim ky tregues është në shifra të ulëta);
- zhvillimi teknologjik (në vendet e zhvilluara është mjaft i lartë);
- shkalla e përdorimit të pajisjeve elektroshtëpiake dhe të automjeteve (në vendet e zhvilluara, përdorimi i tyre është më i gjerë sesa në vendet në zhvillim);
- të ardhurat për frymë të popullsisë dhe niveli i jetëgjatësisë së saj (vendet e zhvilluara kanë nivel të lartë jetese, ritëm të ulët të shtimit të popullsisë dhe rritje të jetëgjatësisë së saj);
- niveli arsimor dhe kulturor i popullsisë (në vendet e zhvilluara është më i lartë se ai në vendet në zhvillim).

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimi 1, 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.7: Sektori parësor i ekonomisë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjediti	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor). Shpjegon llojet dhe rendësin e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë etj.) Identifikon degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.7: Sektori parësor i ekonomisë			
Fjalët kyçe: bujqësia, blegtoaria, pylltaria			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja shpjegon llojet dhe rëndësinë e sektorit bujqësor. Identifikon degët kryesore të bujqësisë dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i> Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.7 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.7 (në tekst) – Diskutojmë: “Renditni disa nga kulturat bujqësore kryesore dhe llojet e gjësë së gjallë që rriten në vende të ndryshme të botës. Evidentoni disa prej faktorëve që ndikojnë në rritjen e tyre” Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...			
b) <i>Ndërtimi i njohurive të reja</i> Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja vazhdon: Bujqësia, dega më e vjetër e ekonomisë, është një veprimtari ekonomike që përfshin punimin e tokës, kultivimin e bimëve dhe shfrytëzimin e tyre për nevojat e popullsisë. <i>Faktorët kryesorë</i> që ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë janë: pozita gjeografike, kushtet natyrore (kryesisht relievi, klima, tokat dhe hidrografia), faktorët historiko-shoqërorë, kualifikimi i krahut të punës, faktorët demografikë, pronësia mbi tokën dhe mjetet e punës, mekanika bujqësore, menaxhimi etj. Bujqësia është sektori ekonomik që preket në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përhershme nga ndryshimet klimatike.			

Në vazhdim, mësuesi/ja bën krahasimin midis modelit të zhvillimit të ekonomisë bujqësore midis vendeve në zhvillim dhe të vendeve të zhvilluara. Mësuesi/ja thekson: Vendet në zhvillim karakterizohen nga një *bujqësi ekstensive* (shih figurën 1a). Ajo është më e përhapur në zonat tropikale të Afrikës, Amerikës Jugore dhe Azisë. Karakteristikë e bujqësisë ekstensive është mbjellja e kulturave bujqësore në sipërfaqe të mëdha, por me rendimente të ulëta për hektar, për shkak të investimeve të pamjaftueshme. Në këto vende ka mungesa të mekanikës bujqësore dhe të mjeteve financiare për sigurimin e pesticideve, për plehërimin dhe ujitjen e tokave; mungojnë tregjet

e sigurta për shitjen e prodhimit; organizimi i sipërfaqeve bujqësore bëhet kryesisht në prona të vogla individuale; krahu i punës ka një nivel të ulët të arsimit profesional...

Mësuesi/ja fton nxënësit të njihen me materialin teorik të trajtuar në tekst mbi zhvillimin e blegtorisë dhe të pylltarisë dhe të diskutojnë mbi veçoritë e zhvillimit të tyre.

Nxënësit evidentojnë zhvillimin e blegtorisë dhe të pylltarisë, nëndegët që i përbëjnë secilën prej tyre si dhe disa veçori kryesore që i karakterizojnë.

Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj dhe prezantojnë veçoritë e këtyre degëve të ekonomisë bujqësore... Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figurat 1-5.

Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.8: Sektori dytësor i ekonomisë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor). Shpjegon llojet dhe rendësin e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë, etj.) Përshkruan procesin e industrializimit.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.8: Sektori dytësor i ekonomisë			
Fjalët kyçe: industria; industria nxjerrëse e mineraleve, metalurgjia, industria e prodhimit të makinave			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja shpjegon llojet dhe rëndësinë e sektorit industrial. Identifikon degët kryesore të sektorit industrial dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore; Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.8 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.8 (në tekst) – Diskutojmë: “Evidentoni pasuritë minerale kryesore të nëntokës së Kosovës. Vlerësoni rëndësinë e tyre dhe tregoni shkallën e shfrytëzimit.” Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Bazuar në këtë diskutim në nivel vendi, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë në nivel botëror. Si fillim, mësuesi/ja bën një përshkrim të shkurtër mbi historikun e zhvillimit industrial në botë. Mësuesi/ja vazhdon: Industria është dega më dinamike dhe komplekse e ekonomisë, e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të një vendi. Industria realizon përpunimin e lëndës së parë (e cila mund të jetë me prejardhje organike ose inorganike) deri në përftimin e produktit final, i cili më pas shkon në tregun e gjerë. Zhvillimi i industrisë ka sjellë përherë ndryshime në nivelin e jetesës së shoqërisë, si dhe ka ndikuar në transformimin e mjedisit. Gjithashtu, ai ka qenë përherë i lidhur me zbulimin dhe përdorimin e burimeve të energjisë dhe me evolucionin e teknologjisë; edhe lindja e zgjerimi i qendrave më të mëdha industriale në botë janë rezultat i tij...			

Fton nxënësit të njihen me materialin teorik të trajtuar në këtë njësi mësimore dhe së bashku me ta diskutojnë nivelin e zhvillimit dhe përhapjen gjeografike të industrisë nxjerrëse të mineraleve; metalurgjisë dhe të industrisë së prodhimit të makinave botë.

Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj dhe prezantojnë veçoritë e këtyre degëve të ekonomisë... Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figurat 1-3.

Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimet. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.9: Sektori dytësor i ekonomisë (vazhdim)

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor). Shpjegon llojet dhe rendësin e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë etj.) Identifikon degët kryesore të industrisë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.9: Sektori dytësor i ekonomisë (vazhdim)			
Fjalët kyçe: industria e lehtë, industria ushqimore, industria e drurit dhe e letrës, industria kimike. Industria farmaceutike, energjetika, ndërtimtaria			

<p>Rezultati/et e të nxënësve për orën mësimore: Nxënësi/ja shpjegon llojet dhe rëndësinë e sektorit industrial. Identifikon degët kryesore të sektorit industrial dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij.</p>
<p>Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK</p>
<p>Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm</p>
<p>Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore</p>
<p><i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësit</i></p> <p>Situata e të vëpruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.9 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.9 (në tekst) – Diskutojmë: “Evidentoni burimet kryesore energjetike që përdoren në botë dhe ato që përdoren në Kosovë. Vlerësoni rolin e tyre në zhvillimin ekonomik të vendeve dhe ndikimet në mjedis.”</p> <p>Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...</p> <p><i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i></p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Bazuar në këtë diskutim në nivel vendi, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë në nivel botëror. Mësuesi/ja vazhdon: <i>Industria e lehtë</i> është një prej industrive në rritje, për shkak të rritjes së kërkesës së konsumatorëve për prodhimet e saj. Ajo prodhon kryesisht tekstile, veshmbathje dhe prodhime të ripërtëritshme lëkure, artikuj shtëpiakë etj. Vendet me fuqinë më të madhe prodhuese në botë të kësaj industrie janë: ShBA-ja, Kina, India, Gjermania, Japonia, Britania e Madhe, Kanadaja, Brazili, Rusia, Italia, Turqia etj. <i>Industria ushqimore</i>. Ushqimi është produkti bazë i shoqërisë dhe, si i tillë, industria ushqimore zë vendin më të rëndësishëm në ekonominë botërore. Megjithatë, pavarësisht kërkesave të konsumatorëve për produkte të ndryshme ushqimore, shumë vende të botës nuk kanë mundësi t’i mbulojnë ato njësoj si vendet e tjera...</p> <p>Fton nxënësit të njihen me pjesën tjetër të materialit teorik të trajtuar në këtë njësi mësimore dhe së bashku me ta diskutojnë nivelin e zhvillimit dhe përhapjen gjeografike të industrisë së drurit dhe të letrës, industrisë kimike, industrisë farmaceutike, energjetikës dhe ndërtimtarisë në botë.</p> <p>Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj dhe prezantojnë veçoritë e këtyre degëve të ekonomisë... Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figurat 1-4.</p> <p>Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshë/Praktikë e pavarur/Punë në grup Lihet detyrë klase ushtrimi 1 të rubrikës “Radha jote”. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
<p>Vlerësimi i nxënësit</p> <p>Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimin. Përdoret:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësim me gojë - Vlerësim i punës në grup - Vlerësim i detyrës së shtëpisë - Vlerësim i një detyre tematike - Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur
Ushtrimi 2 te rubrika “Radha jote”.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.10: Sektori i tretë i ekonomisë

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor). Shpjegon llojet dhe rendësinë e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë etj.). Përshkruan rëndësinë e tregtisë për zhvillimin ekonomik. Shpjegon rolin e turizmit dhe veprimtarive tjera (të sipër përmendura) në zhvillimin ekonomik. Vlerëson rolin e turizmit në shoqërinë bashkëkohore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 3.10: Sektori i tretë i ekonomisë			
Fjalët kyçe: turizmi, tregtia			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja shpjegon llojet dhe rëndësinë e sektorit të tretë të ekonomisë. Identifikon degët kryesore të këtij sektori dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
a) <i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.10 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 3.10 (në tekst) – Diskutojmë: “Evidentoni degët e sektorit të tretë të Kosovës dhe ilustroni me shembuj natyrën e zhvillimit të tyre.”			

Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...

b) Ndërtimi i njohurive të reja

Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto

Bazuar në këtë diskutim në nivel vendi, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë në nivel botëror. Si fillim, mësuesi/ja bën një përshkrim të shkurtër mbi konceptin e këtij koncepti ekonomik.

Mësuesi/ja vazhdon: Turizmi renditet si një ndër degët ekonomike më të rëndësishme në botë, që ka njohur vazhdimisht rritje. Në botë, turizmi paraqitet kryesisht në formën e turizmit blu, të bardhë (malor) dhe kulturor. Ai mund të jetë *brenda vendit* ose *ndërkombëtar*. Vendet që investojnë më tepër në fushën e turizmit dhe e kanë atë një sektor me peshë në ekonominë e tyre janë: ShBA-ja, Kina, Japonia, Britania e Madhe, Franca, Italia, Spanja etj. (shih figurën 1).

Fton nxënësit të njihen me materialin teorik të trajtuar në këtë njësi mësimore dhe së bashku me ta diskutojnë nivelin e zhvillimit dhe përhapjen gjeografike të turizmit dhe të tregtisë në botë.

Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj dhe prezantojnë veçoritë e këtyre degëve të ekonomisë... Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figurat 1-5.

Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 3.11: Sektori i tretë i ekonomisë (vazhdim)

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Sistemet humane		Rezultati i të nxënit të temës: Dallon veprimtaritë ekonomike sipas sektorëve përkatës (parësor, dytësor dhe tretësor). Shpjegon llojet dhe rendësin e secilës veprimtari ekonomike (bujqësinë, xehetarinë, industrinë, turizmin, transportin, tregtinë etj.) Identifikon degët kryesore të industrisë, faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj. Shpjegon veçoritë e transportit (automobilistik, hekurudhor, ujor, ajror) dhe rolin e tij në zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe vet ekonomisë.	

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III
Aspektet specifike të planit të orës mësimore
Njësia mësimore 3.11: Sektori tretësor i ekonomisë
Fjalët kyçe: transporti, shërbimet, artizanati
Rezultati/et e të nxënimit për orë mësimore: Nxënësi/ja shpjegon llojet dhe rëndësinë e sektorit të tretë të ekonomisë. Identifikon degët kryesore të këtij sektori dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tij.
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore
<p><i>A)Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p> <p>Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 3.11 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).</p> <p>Hapi I : Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimi 3.11 (në tekst) – Diskutojmë: “Evidentoni degët e sektorit të tretë të Kosovës dhe ilustroni me shembuj natyrën e zhvillimit të tyre.” Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...</p> <p><i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i></p> <p>Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Bazuar në këtë diskutim në nivel vendi, mësuesi/ja vazhdon të trajtojë në nivel botëror. Mësuesi/ja vazhdon: Transporti është veprimtaria ekonomike që realizon qarkullimin e njerëzve, mallrave dhe informacioneve. Transporti i njerëzve dhe i mallrave bëhet me anë të rrugëve tokësore (transporti automobilistik dhe ai hekurudhor), ajrore dhe ujore (transporti detar dhe ai lumor), ndërsa informacioni përcillet përmes telefonisë fikse dhe telefonisë së lëvizshme (mobile). Sot, përdorimi i internetit ka lehtësuar dhe shpejtuar komunikimin midis njerëzve, pavarësisht distancave ndërmjet tyre. <i>Transporti automobilistik</i> mbulon vëllimin më të madh të transportit në botë dhe nënkupton përdorimin e automjeteve për transportimin e njerëzve e të mallrave. Rrjeti automobilistik botëror përfshin rrugë fshati, rrugë urbane, rrugë periferike, rrugë ndërqytetëse të kategorive të ndryshme, deri edhe në autostrada. Për rrjetin e dendur të autostradave, përmes të cilave mundësohet një lëvizje më e shpejtë e mallrave dhe e udhëtarëve (shih figurën 1), dallohen kryesisht vendet e zhvilluara, si: ShBA-ja, Japonia, Kanadaja, vendet e BE-së etj.). <i>Transporti hekurudhor</i> realizon lëvizjen me tren të njerëzve dhe të mallrave (shih figurën 2)... Fton nxënësit të njihen me materialin teorik të trajtuar në këtë njësi mësimore dhe së bashku me ta diskutojnë nivelin e zhvillimit dhe përhapjen gjeografike të transportit, shërbimeve dhe artizanatit në botë. Nxënësit diskutojnë, sjellin shembuj dhe prezantojnë veçoritë e këtyre degëve të ekonomisë... Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figurat 1-7. Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.</p> <p>Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup Lihet detyrë klase ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha jote”. Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.</p>
Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 te rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Tema IV Bashkëveprimi njeri-natyrë

Njësia mësimore 4.1: Mjedisi gjeografik dhe veprimtaria njerëzore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Bashkëveprimi njeri-natyrë		Rezultati i të nxënit të temës: Përshkruan ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas. Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 4.1: Mjedisi gjeografik dhe veprimtaria njerëzore			
Fjalët kyçe: mjedisi gjeografik dhe ndikimi i tij mbi shoqërinë njerëzore, ndikimi i shoqërisë njerëzore mbi mjedisin gjeografik			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja përshkruan ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, Jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimt 4.1 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimt 4.1 (në tekst) – Diskutojmë: “Fotografitë e mëposhtme tregojnë disa ndikime të mjedisit gjeografik mbi shoqërinë njerëzore. Bazuar në këto pamje dhe në njohuritë tuaja, përshkruani si ndikon mjedisi gjeografik në jetën tonë. Po ne mbi mjedisin?” Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të bëjnë lexim të strukturuar dhe së bashku me mësuesin/en të evidentojnë ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas.			

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit trajtojnë materialin teorik. Si fillim trajtohet koncepti mjedis dhe elementët përbërës të tij: *Mjedis gjeografik* quhet bashkësia e të gjitha elementeve jetësore dhe jojetësore të një vendi të caktuar, të cilat bashkëveprojnë midis tyre (shih figurën 1). Në grupin e elementeve jetësore bën pjesë bota organike, ndërsa në atë të elementeve jo-jetësore përfshihen: ajri, uji, atmosfera, shkëmbinjtë dhe tokat. Mjedis gjeografik përfaqëson një sistem dinamik që zhvillohet, transformohet dhe drejtohet nga ligje natyrore të përhershme. Ai përbën një bazë të domosdoshme dhe të pazëvendësueshme për jetën dhe veprimtarinë e njeriut (shih figurat 2a dhe 2b). Kështu, njeriu ndodhet në mënyrë të përhershme nën ndikimin e rrezatimit diellor, të kushteve atmosferike dhe të dukurive natyrore që e karakterizojnë planetin tonë. Ai është i kushtëzuar nga klima dhe shkalla e pjellorisë së tokës për të kultivuar llojet e ndryshme të kulturave bujqësore, si dhe nga dinamika e lumenjve për të siguruar ujin e pijshëm, energjinë elektrike dhe sasinë e nevojshme të ujit për vaditjen e bimëve... Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figurat 1-4.

Për ta bërë më konkret informacionin për nxënësit, mësuesja e kalon diskutimin në shembuj në nivel lokalë. Për shembull, ai/ajo nxit diskutimin me çështjen: Përshkruaj veçoritë e mjedisit gjeografik të vendbanimit tënd.

Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimet 1, 2 dhe 3 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimet 4 dhe 5 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 4.2: Njeriu dhe ndryshimet klimatike

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Bashkëveprimi njeri-natyrë		Rezultati i të nxënit të temës: Shpjegon marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe mjedisit si: pasojat e ndryshimeve klimatike në mjedis dhe në shëndet, të rreziqeve natyrore dhe atyre të krijuara nga njeriu dhe mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.5; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 4.2: Njeriu dhe ndryshimet klimatike			
Fjalët kyçe: efekti serrë, ngrohja globale, pasojat e tyre			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: Nxënësi/ja argumenton rëndësinë e proceseve dhe modeleve të klimës për jetën dhe proceset në Tokë (p.sh., thatësira, turizmi) dhe rolin e veprimtarisë njerëzore (p.sh. shtimi i gazeve serë). Evidenton pasojat që rrjedhin prej ndryshimeve klimatike.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna			
Çështje ndërrkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimi 4.2 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimi 4.2 (në tekst) – Diskutojmë: “Kujtojmë çfarë kemi mësuar mbi rëndësinë e atmosferës. Në Tokë do të kishte diferenca të mëdha midis temperaturave të ditës dhe të natës, nëse nuk do të ishte atmosfera. Ajo e mban nxehtësinë të qëndrueshme, duke e qarkulluar atë nga njëri vend te tjetri. Disa shtresa të saj veprojnë si një filtër për rrezet diellore. Cilat janë këto shtresa? Si dhe sa ndikon rrezatimi diellor mbi klimën? Po klima, si ndikon mbi jetën tonë?” Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të bëjnë një lexim të strukturuar të materialit teorik në tekst dhe së bashku trajtojnë hap pas hapi çështjen e ndryshimeve klimatike në planet.			

Si fillim analizohet ndryshimi midis efektit serë natyral dhe efektit serë të shtuar, si rezultat i veprimtarisë njerëzore.

Trajtohet materiali: Elemente përbërëse si **dioksidi i karbonit, avujt e ujit e disa gaze të tjerë**, edhe pse zënë përqindje shumë të vogël në atmosferë, luajnë rol shumë të rëndësishëm për temperaturat e ajrit, pra për klimën e planetit tonë. Ata lejojnë të mbërrijë në Tokë rrezatimi diellor dhe mbajnë në atmosferën pranë sipërfaqes së saj rrezatimin tokësor. Ky proces quhet **efekti serë** dhe është një proces vetërregullues i atmosferës. Nëse nuk do të ndodhte, temperatura mesatare vjetore e ajrit do të ishte me vlera negative. Gjatë shekullit të fundit, përmes aktivitetit të tij, njeriu e ka rritur ndjeshëm efektin serrë, sepse ka shtuar përqindjen e dioksidit të karbonit, pluhurave, avujve të ujit dhe të gazeve të dëmshme në atmosferë. Kjo ka ndodhur prej rritjes së përdorimit të lëndëve djegëse (nafta, gaz, qymyr), pakësimit të sipërfaqeve pyjore, shtimit të erozionit të tokave, përdorimit pa kriter të kimikateve në bujqësi etj. Çlirimi me shumicë i gazeve serrë ka rritur përqendrimin e tyre në atmosferë dhe për rrjedhojë, përherë e më shumë po ndikon në rritjen e vazhdueshme të temperaturës mesatare globale të ajrit, pra në **ngrohjen globale**.

Mësuesja fton nxënësit të përshkruajnë figurën 1.

Në vazhdim, fton nxënësit të përshkruajnë figurën 2 a/b/c/d/e dhe së bashku me ta, mësuesi/ja trajton pasojat e ndryshimeve klimatike.

Fton nxënësit të sjellin shembuj nga e përditshmja e tyre.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Nxënësit sjellin shembuj të ndryshimeve klimatike që vënë re në të përditshmen e tyre. Në vazhdim punojnë me ushtrimet 1, 2, 3 të rubrika “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 4 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Njësia mësimore 4.3: Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i burimeve natyrore

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Shoqëria dhe Mjedis	Lënda: Gjeografi	Shkalla e kurrikulës: 3	Klasa: 6 (e gjashtë)
Tema: Bashkëveprimi njeri-natyrë		Rezultati i të nxënit të temës: Ofron alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore. Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3; I.4; I.6; I.8; II 6; III.7; III.8; IV.6; IV.8; V.2; VI.4; VI.6			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1; I.3; I.4; I.5; I.6; II; III			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore 4.3: Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i burimeve natyrore			
Fjalët kyçe: koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm, përdorimi i burimeve miqësore me mjedisin			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore: Nxënësi/ja shpjegon konceptin zhvillim i qëndrueshëm, evidenton përdorimin e burimeve miqësore me mjedisin. Hulumton për raste të keqmenaxhimit të burimeve natyrore duke parashikuar rrugë dhe mundësi të parandalimit ose trajtimit të tyre.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuhët dhe komunikimi, shkencat e natyrës, TIK			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Fusha: Shkencat natyrore, jeta dhe puna			
Çështje ndërkurrikulare: Edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënësit gjatë orës mësimore			
<i>a) Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i>			
Situata e të vepruarit Për të realizuar këtë temë, mësuesi/ja përdor situatën e vendosur në fillim të mësimin 4.3 (ose situata të tjera të përzgjedhura prej tij/saj).			
Hapi I: Rrjeti i diskutimit Mësuesi/ja shtron për diskutim situatën e vendosur në fillim të mësimin 4.3 (në tekst) – Diskutojmë: “Në jetën e përditshme dëgjojmë të diskutohet shpesh koncepti “zhvillim i qëndrueshëm”. Si do ta përkufizonit ju këtë koncept? Sillni disa shembuj” Nxënësit sjellin mendimin e tyre, sjellin shembuj...			
<i>b) Ndërtimi i njohurive të reja</i>			
Hapi II: Vëzhgo – Analizo – Diskuto Mësuesi/ja fton nxënësit të bëjnë lexim të strukturuar dhe së bashku me mësuesin/en të evidentojnë konceptin zhvillim i qëndrueshëm, si dhe përdorimin e burimeve miqësore me mjedisin. Mësuesi/ja së bashku me nxënësit trajtojnë materialin teorik. Si fillim trajtohet koncepti zhvillim i qëndrueshëm.			

Në vazhdim trajtohen modele të aplikimit të zhvillimit të qëndrueshëm: “Ruajtja e burimeve natyrore nga shkatërrimi (shpyllëzimet, mbishfrytëzimi i pasurive të pa-ripërtëritshme etj.) apo nga ndotja (e ujërave, e tokës, e ajrit), ka një rëndësi themelore jo vetëm për ne sot, por edhe për brezat e ardhshëm, pasi do t’u siguronte atyre kushtet e nevojshme për të jetuar. Aktualisht, zhvillimi i qëndrueshëm është përfshirë në objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit, si në vendin tonë, ashtu dhe për të gjitha shtetet anëtare të OKB-së. Domosdoshmëria e gjetjes së politikave efikase për të rregulluar këto raporte midis së tashmes dhe së ardhmes, si dhe midis interesave të një individi apo grupi njerëzish me pjesën tjetër të shoqërisë, përbën një sfidë të rëndësishme për të gjithë ne...”

Gjatë trajtimit përdoret si material ilustrues edhe figurat 1-4.

Për ta bërë më konkret informacionin për nxënësit, mësuesi/ja e kalon diskutimin në shembuj në nivel lokalë.

Për shembull, ai/ajo nxit diskutimin me çështjen: Bazuar në figurat 4a, 4b, 4c, evidento burimet natyrore që përdoren për përfitim të energjisë në Shqipëri dhe në Kosovë. Vlerëso ndikimin e tyre në mjedis

Nxënësit sjellin shembuj ilustrues.

Hapi III: Punë në dyshe/Praktikë e pavarur/Punë në grup

Lihet detyrë klase ushtrimet 1 dhe 2 të rubrikës “Radha jote”.

Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë zgjidhje/rezultatet/gjetjet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve

Nxënësit vlerësohen gjatë të gjitha fazave të orës së mësimi. Përdoret:

- Vlerësim me gojë
- Vlerësim i punës në grup
- Vlerësim i detyrës së shtëpisë
- Vlerësim i një detyre tematike
- Vetëvlerësim

Detyrat dhe puna e pavarur

Ushtrimi 3 të rubrika “Radha jote”.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Reflektohet mbi rezultatet e arritura gjatë orës mësimore dhe mbi pritshmëritë. Ndërtohet puna për të rritur rezultatet e nxënësve.

Provo kompetencat

(Përsëritja V - Sistemet humane dhe Bashkëveprimi njeri-natyrë)

1. E vërtetë apo e gabuar?

- Numri i lindjeve ndikon në rritjen e popullsisë. V G
- Popullsia më e madhe është përqendruar në kontinentin evropian. V G
- Kina dhe India dallohen për dendësinë më të vogël të popullsisë në botë. V G
- Prodhuesit më të mëdhenj të naftës janë: Rusia, Arabia Saudite, ShBA-ja, Iraku, Irani, V G
- Kina, Kanadaja, Emiratet e Bashkuara, Kuvajti etj. V G
- Në rang botëror, transporti automobilistik mbulon vëllimin më të madh të transportit të njerëzve dhe të mallrave. V G

2. Bazuar në njohuritë e marra gjatë kësaj teme, si dhe në figurat 1, 2, 3:

- a) **përshkruaj** ecurinë e numrit të popullsisë botërore nga periudhat më të hershme e në vazhdimësi;
- b) **analizo** faktorët që ndikojnë në ecurinë e numrit të popullsisë.

3. Bazuar në hartën e figurës 4:

- a) **përshkruaj** shpërndarjen e popullsisë në botë;
- b) **rendit** faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e popullsisë në botë.

4. Diskuto mbi pyetjet e mëposhtme.

- Si paraqitet struktura e popullsisë sipas: **a)** moshës; **b)** gjinisë; **c)** arsimit; **d)** veprimtarisë ekonomike; **e)** racës;
- f) besimit fetar; **g)** etnisë?
 - Çfarë kuptojmë me migrim? Sa lloje është ai?
 - Cilat janë motivet/faktorët që ndikojnë në lëvizjen migratore të popullsisë?
 - Cilat janë pasojat e migrimeve?

5. Analizo llojet e vendbanimeve në botë.

6. Shpjego kuptimin e konceptit shtet dhe rendit elementet e tij.

7. Evidento disa prej organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare dhe vlerëso rolin e tyre.

8. Evidento përmes shembujve, faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendeve në botë.

9. Bëj dallimin midis koncepteve *vende të zhvilluara* dhe *vende në zhvillim*. Sill shembuj nga bota dhe rajoni.

10. Rendit faktorët që ndikojnë në zhvillimin e tre sektorëve të ekonomisë.

11. Analizo përmes shembujve zhvillimin e: **a)** ekonomisë bujqësore në botë; **b)** sektorit industrial, energjetikës dhe ndërtimtarisë; **c)** turizmit, transportit, tregtisë, shërbimeve dhe artizanatit.

12. Përshkruaj përmes shembujve, ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik.

13. Argumento se ku ndryshon efekti serrë vetërregullues i atmosferës së Tokës, nga ajo që po ndodh gjatë këtij shekulli për shkak të rritjes së veprimtarisë njerëzore.

14. Shpjego përmes shembujve, kuptimin e konceptit *zhvillim i qëndrueshëm*.

15. Identifiko disa mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në Kosovë apo në vendbanimin tënd.

Projekt Ora e tretë

Çështjet mjedisore pranë vendbanimit tim

Rezultatet e të nxënit

Në përfundim të këtij projekti, nxënësi/ja:

- diskuton mbi potencialet turistike, ekonomike dhe mjedisore që mund të ketë pranë vendbanimit të tij/saj dhe rolin e tyre në zhvillimin e komunitetit;
- hulumton mbi një çështje mjedisore në zonën e tij/saj dhe përcakton faktorët e mundshëm që e shkaktojnë atë;
- identifikon disa zgjidhje të mundshme, që ofrohen nga pushteti qendror, nga pushteti lokal, komuniteti, apo ai/ajo si individ;
- vlerëson përfitimet dhe rreziqet që mund të vijnë prej rrugëzgjidhjeve të mundshme;
- ndan me grupin e punës idetë dhe përfundimet individuale;
- u bën thirrje moshatarëve dhe komunitetit për të qenë aktivë në zgjidhjet e problemeve të tilla.

Burimet kryesore të informacionit:

teksti mësimor, materiale të hulumtuara dhe të grumbulluara nga burime të ndryshme, vëzhgime të nxënësve në terren, biseda me më të rriturit e familjes dhe komunitetin përkatës; të dhëna dhe analiza të marra pranë pushtetit lokal; informacione të siguruar nga: interneti, institucione apo organizata mjedisore, media dhe shtypi.

Metodologjia që do të përdoret:

punë në grupe, hulumtim, intervista, anketim, diskutim, analizë, paraqitje, shkëmbim opinionesh.

Mjetet që do të përdoren deri në realizimin përfundimtar të projektit:

teksti mësimor, materiale të përgatitura me informacione nga shtypi, interneti apo burime të tjera; kompjuter, videoprojektor, tabelë paraqitjeje, shënues; fletëpalosje, postera, fotografi, skica/vizatime, fletë-anketa dhe makete të ndërtuara nga nxënësit/et etj.

Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore që do të zhvillohen

gjatë orës së katërt të projektit:

- Paraqitja e punës së secilit grup, që mund të bëhet në mënyrë elektronike (me *PowerPoint* apo me forma të tjera) ose me anë të posterave, skemave etj., sipas vendimmarrjes së grupit.
- Dorëzohet produkti i printuar.
- Diskutohet në klasë për përfundimet e arritura.
- Bëhet vlerësimi i nxënësve.
- Shpërndahen në klasë (më pas edhe te bashkëmoshatarët dhe komuniteti) posterat e përgatitur.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37.016:911.2(4/9)(072)(075.2)

Ziu, Majlinda

Libër për mësuesin : gjeografia 6 / Majlinda Ziu. -
Prishtinë : Pegi, 2019. - 148 f. : ilustr. ; 20.7x28 cm.

ISBN 978-9951-786-18-8

Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 315/01-B, të datës 16.07.2019.